# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 27

**Tiranë – E premte, 19 shkurt 2021**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 151/2020 datë 17.12.2020 | Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar........ | 3597 |
| Ligj nr. 168/2020 datë 23.12.2020 | Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar........ | 3597 |
| Vendim i Kuvendit nr. 14/2021, datë 15.2.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 11 912, datë 11.1.2021, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 151/2020, 'Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, 'Për taksat kombëtare', të ndryshuar'"........ | 3597 |
| Vendim i Kuvendit nr. 15/2021, datë 15.2.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 11 915, datë 14.1.2021, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 168/2020, 'Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, 'Për miratimin e niveleve të tarifës doganore', të ndryshuar'"........ | 3598 |
| Vendim i Kuvendit nr. 16/2021, datë 15.2.2021 | Për miratimin e fondit, për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet, për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021........ | 3598 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1185, datë 24.12.2020 | Për përcaktimin e metodologjisë dhe të procedurave të monitorimit të qarkullimit në fushën e hidrokarbureve........ | 3598 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 17.2.2021 | Për një ndryshim në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës", të ndryshuar........ | 3605 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 17.2.2021 | Për transferimin në pronësi të Bashkisë Lezhë, për Njësinë Administrative Blinisht, të pasurive 176 dhe 182/3, me vendndodhje në zonën kadastrale 1220................................................. | 3605 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 17.2.2021 | Për disa shtesa në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar........................................................................ | 3609 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 17.2.2021 | Për miratimin e marrëveshjes shtesë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga një Fond i Posaçëm i Aksionarëve të BERZH-it, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar, të marrëveshjes së grantit, ratifikuar me ligjin nr. 63/2015................................................................................................ | 3610 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 17.2.2021 | Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi punimet e ndërtimit................................. | 3613 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 95, datë 17.2.2021 | Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë.......................................... | 3615 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 17.2.2021 | Për disa shtesa në vendimin nr. 299, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar......................................................................... | 3618 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 97, datë 17.2.2021 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 729, datë 16.9.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për deklarimin pasuri kulturore ‘Qendër historike’ të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj, dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”...................................... | 3619 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 17.2.2021 | Për përdorimin e Fondit të Rindërtimit, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit, në Bashkinë Durrës...................................... | 3623 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 17.2.2021 | Për miratimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes për programin dypalësh të ndihmës e të bashkëpunimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë........................................................................................................ | 3623 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 17.2.2021 | Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, për portin në Triport, Vlorë | 3625 |

| | | |
|---|---|---|
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 7, datë 17.2.2021 | Mbi mënyrën e organizimit dhe realizimit të procedurave të përqendruara të prokurimit publik për autoritetin kontraktor Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.................................... | 3625 |
| Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 47, datë 11.2.2021 | Për miratimin e "Udhëzuesi 'Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave'"........................................ | 3626 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 20.1.2021 | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Gerti" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Vardari", me kapacitet të instaluar 1972 kw....................................... | 3698 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 20.1.2021 | Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., nr. 115/309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 6, datë 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015................................................................................ | 3699 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 20.1.2021 | Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., nr. 115/310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin nr. 123, datë 14.10.2015........................................................... | 3701 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 20.1.2021 | Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit nr. 140, datë 24.9.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Irarba Energji' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Shëngjun', me kapacitet të instaluar 2040 kw"................................................................................ | 3703 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 20.1.2021 | Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021............................... | 3705 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 19, datë 20.1.2021 | Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 225, datë 15.12.2020 "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC Treska" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 27.4.2013......................................................................................... | 3706 |
| Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 1/3, datë 15.1.2021 | Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.................... | 3707 |
| Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 7, datë 29.1.2021 | Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.................... | 3708 |
| Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 12, datë 5.2.2021 | Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.................... | 3710 |

**LIGJ**
**Nr. 151/2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në paragrafët e parë dhe të tretë, të pikës 4, të nenit 4, "Niveli i taksave kombëtare", të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, fjalët "dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim" zëvendësohen me fjalët "në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 17.12.2020.

**LIGJ**
**Nr. 168/2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008, "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar, në lidhjen nr. 1, tarifa doganore për kodin tarifor të NKM 8903 10, "mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz", nga 15 për qind bëhet 2 për qind.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.12.2020.

**VENDIM**
**Nr. 14/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 912, DATË 11.1.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 151/2020, 'PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, 'PËR TAKSAT KOMBËTARE', TË NDRYSHUAR'"**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 912, datë 11.1.2021, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 151/2020, 'Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, 'Për taksat kombëtare', të ndryshuar'".
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 15.2.2021.

**VENDIM**
**Nr. 15/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 915, DATË 14.1.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 168/2020, 'PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008, 'PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE', TË NDRYSHUAR'"**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 915, datë 14.1.2021, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 168/2020, 'Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, 'Për miratimin e niveleve të tarifës doganore', të ndryshuar'".
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 15.2.2021.

**VENDIM**
**Nr. 16/2021**

**PËR MIRATIMIN E FONDIT, PËR FINANCIMIN E PARTIVE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET, PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT 2021**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 88, pika 1, dhe 180, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të vendimit të Kuvendit nr. 51, datë 27.4.2017,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit, për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet, për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021, do të jetë në vlerën 130 milionë lekë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 15.2.2021.

**VENDIM**
**Nr. 1185, datë 24.12.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË DHE TË PROCEDURAVE TË MONITORIMIT TË QARKULLIMIT NË FUSHËN E HIDROKARBUREVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
1. Ky vendim përcakton:
a) metodologjinë e sistemit të fiskalizimit të transaksioneve tregtare në sektorin e hidrokarbureve;
b)procedurën e ofrimit të instalimit dhe të mirëmbajtjes së sistemit të monitorimit nëpërmjet operatorëve privatë, të autorizuar nga autoritetet përgjegjëse, sipas kërkesave dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim;
c) detyrimin ligjor që të gjithë tatimpaguesit, që tregtojnë me shumicë dhe/ose pakicë naftë dhe produkte të saj dhe gaz natyror të lëngshëm (GNL) në format e tregtimit, përfshirë skemat e vogla të GNL-së (SLNG) dhe impiantet e gazit natyror të komprimuar (CNG), të pajisen me mjete dhe sistem elektronik të kompjuterizuar për regjistrimin dhe qarkullimin e produkteve të tregtuara prej tyre;

ç) mënyrën e funksionimit të sistemit të monitorimit dhe të komunikimit me administratën tatimore;

d) kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive që ofrojnë sisteme të tilla nga autoritetet përgjegjëse, afatet dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë operatorët e autorizuar, nivelin maksimal të tarifave të instalimit, të mirëmbajtjes dhe shërbimit të sistemit të monitorimit të hidrokarbureve.

II. METODOLOGJIA E SISTEMIT TË FISKALIZIMIT DHE MONITORIMIT

**2. Lëshimi dhe fiskalizimi i dokumentit tatimor në sektorin e hidrokarbureve**

Dokumentimi i shitjes së sasisë së naftës bruto, produkteve të naftës dhe GNL-së bëhet me faturë, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit dhe qarkullimit.

**2.1 Fiskalizimi i shitjeve për konsumatorët finalë**

Për shitjet me pakicë të kryera për një konsumator final, një faturë duhet të lëshohet e të fiskalizohet dhe të përmbajë elementet e përcaktuara në ligjin nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar (më tej "ligji"). Shlyerja e kësaj fature bëhet me një nga mënyrat e pagesës, të përcaktuara në ligj.

Të gjitha pikat e shitjes me pakicë të karburanteve duhet të pajisen me dispensera që operojnë vetëm nën regjimin automatik dhe nën kontrollin e sistemit fiskal (i përbërë nga kontrollori i dispenserit elektronik dhe pajisja fiskale) të lidhur detyrimisht me një zgjidhje *software*-ike të certifikuar.

Dispenseri është një pompë apo një kolonë furnizimi me karburant në të cilin janë instaluar disa pistoleta furnizimi për lloje të ndryshme karburantesh dhe që komandohen me një qark (kokë) elektronik. Në një pikë shitjeje (stacion furnizimi) mund të jenë instaluar 1 (një) apo disa dispensera.

Çdo dispenser i karburantit, përfshirë dhe ata të GNL-së, detyrimisht duhet të jetë i lidhur me sistemin fiskal të sipërpërmendur. Furnizimi me karburant duhet të jetë i lidhur me regjistrimin automatik të shitjeve dhe duhet të punojë nën rregullin e detyrueshëm "Pa faturë, s'ka karburant".

Shkëmbimi i të dhënave bëhet në bazë të një protokolli të programuar, sipas specifikimeve të dispenserit të karburantit.

Në rast se një dispenser nuk është i lidhur me pajisjen elektronike për lëshimin e faturave me një zgjidhje *software*-ike, të certifikuar në datën e fillimit të sistemit të fiskalizimit dhe monitorimit, sipas dispozitave të këtij vendimi, subjekti që operon në stacionin e tregtimit është subjekt i sanksioneve administrative, të parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

**2.2 Lidhja e dispenserave të karburantit me zgjidhjen *software*-ike**

Të dhënat mbi shitjen e karburantit duhet të transferohen automatikisht dhe në kohë reale në sistemin e informacionit të administratës tatimore. Pas regjistrimit në sistemin e informacionit të administratës tatimore, sistemi fiskal i instaluar lëshon automatikisht faturën e fiskalizuar.

Nëse blerësi është një individ ose një tatimpagues që paguan me para në dorë ose me tollon ose me kartën e shoqërisë, atëherë fatura duhet të lëshohet dhe të fiskalizohet në kohë reale.

Nëse blerësi është një tatimpagues që paguan pa para në dorë, rast në të cilin duhet të lëshohet një faturë elektronike, në përputhje me nenet 24 dhe/ose 25, të ligjit, atëherë për monitorimin e qarkullimit të lëngut tatimpaguesi duhet të lëshojë dhe të fiskalizojë dokumentin e transportit menjëherë pas transferimit automatik të të dhënave për karburantin e qarkulluar, dokument i cili duhet të lidhet me NSLF-në e faturës elektronike të lëshuar më parë.

Disa dokumente transporti mund të lidhen me një faturë të vetme elektronike ku totali i të gjitha dokumenteve të transportit duhet të jetë i barabartë me sasinë e karburantit në faturën elektronike me të cilën lidhen.

**2.3 Fiskalizimi i shitjeve ndërmjet tatimpaguesve**

Fatura e çdo transaksioni ndërmjet dy tatimpaguesve, për sa i përket shitjes së hidrokarbureve, qoftë shitje me shumicë ose pakicë, paguhet nëpërmjet llogarisë bankare, pavarësisht shumës, dhe dokumentohet me lëshimin e fiskalizimin e faturës elektronike, në përputhje me ligjin.

Përveç faturës elektronike, në këto raste duhet të lëshohet dhe të fiskalizohet edhe një "Dokument

transporti", i cili lëshohet dhe fiskalizohet duke përdorur pajisje elektronike dhe zgjidhje *software*-ike të certifikuara, në përputhje me ligjin, me qëllim monitorimin e qarkullimit të sasisë së karburantit.

Dokumenti i transportit përdoret, gjithashtu, në rastet kur lëshohet dhe fiskalizohet një faturë shoqëruese për transportimin e hidrokarbureve, në përputhje me ligjin, dhe bashkëshoqëron faturën shoqëruese.

Për çdo rast kur përdoret dokumenti i transportit, lëshohet fillimisht fatura elektronike/shoqëruese dhe më pas nga pajisja elektronike lëshohet dhe fiskalizohet dokumenti i transportit, i cili përmban një referencë në NSLF/SH-në e faturës elektronike/shoqëruese, të lëshuar më parë, me të cilën lidhet dokumenti i transportit.

Me një faturë elektronike/shoqëruese mund të lidhen më shumë se një dokument transporti dhe sasia totale e karburantit e të gjitha dokumenteve të transportit së bashku duhet të jetë gjithmonë e barabartë me sasinë e karburantit në faturën elektronike/shoqëruese me të cilën lidhen.

Formati i dokumentit të transportit është sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

**2.4 Sistemet fiskale për zonat e lira doganore, shoqëritë e prodhimit dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve**

Çdo zonë e lirë doganore apo shoqëri, që ka një licencë të tregtimit me shumicë të hidrokarbureve, është e detyruar të instalojë në pikën e shitjes sisteme fiskale sipas këtij vendimi. Subjekte të monitorimit fiskal janë të gjitha depozitat fikse apo të lëvizshme të lëngjeve dhe ekstremitetet e rrugëve të kalimit të lëngjeve. Sistemet fiskale të instaluara në zonat e lira doganore, të prodhimit apo të tregtimit me shumicë, duhet të përshtaten me sistemet fiskale, të përcaktuara në këtë vendim.

Është e detyrueshme që çdo kalimatës në pikat e shitjes së karburantit me shumicë apo në magazina doganore të jetë i lidhur me sistemin fiskal.

Të gjitha shitjet/lëvrimet e karburantit duhet të deklarohen nëpërmjet zgjidhjes *software*-ike të certifikuar për lëshimin e faturave elektronike, përfshirë faturat shoqëruese dhe duhet t'i dërgohet në kohë reale sistemit të informacionit të administratës tatimore.

Fillimisht, lëshohet një faturë elektronike në përputhje me nenet 24 dhe/ose 25, të ligjit, NSLF-ja e faturës elektronike regjistrohet në sistemin fiskal të instaluar në kalimatës. Fatura shoqëruese duhet të lëshohet dhe të fiskalizohet menjëherë pas transferimit automatik të të dhënave për karburantin e marrë.

**2.5 Procedura e tregtimit të karburantit nga magazina fiskale e prodhuesit te magazina fiskale e blerësit**

Në rastin kur karburanti lëviz nga magazina fiskale e prodhuesit te magazina fiskale e blerësit, atëherë shitësi i jep blerësit një faturë elektronike dhe faturë shoqëruese, të lëshuar nga sistemi fiskal i instaluar në kalimatës. Blerësi shkarkon në magazinën e tij fiskale sasinë e karburantit të blerë dhe regjistron, përmes një fature elektronike dhe fature shoqëruese, çdo shitje ndaj një tatimpaguesi, palë e tretë.

**2.6 Procedura e lëvizjes së karburantit nga magazina doganore e shoqërive të tregtimit me shumicë te magazinat e tyre fiskale**

Karburanti del nga magazina doganore me faturë shoqëruese të lëshuar dhe të fiskalizuar nga sistemi fiskal i kalimatësve, sipas ligjit dhe akteve të tjera të zbatueshme. Pas hyrjes së karburantit në magazinën doganore të shoqërisë, fatura shoqëruese i bashkëngjitet fletëhyrjes së magazinës fiskale të shoqërisë. Lëvizja e karburantit nga magazina doganore te magazina fiskale nuk konsiderohet shitje nga ana e shoqërisë së tregtimit me shumicë pasi është një lëvizje e brendshme.

**2.7 Procedura e importimit të karburantit nga shoqëritë nëpërmjet mjeteve të transportit tokësor (autobote), zhdoganimi i të cilave bëhet nëpërmjet pikave të kalimit kufitar tokësor**

Në rastet e importit të karburantit nga shoqëritë e tregtimit me shumicë ose pakicë me mjete të transportit tokësor, informacioni për sasinë e karburantit të zhdoganuar gjenerohet nga të dhënat që transferohen periodikisht, çdo 24 orë nga administrata doganore. Importuesi fiskalizon faturën e marrë duke u mbështetur në të dhënat e deklaratës doganore dhe, nëse është e nevojshme, shton të dhëna shtesë në platformën qendrore të faturës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 25, të udhëzimit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 3.4.2020, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

Në rastet kur subjekti shkarkon karburantin në magazinën e tij fiskale, çdo dalje në vijim, në rastin

e transaksioneve pa para në dorë, duhet të shoqërohet nga fatura elektronike, si dhe nga fatura shoqëruese nga sistemi fiskal i instaluar në kalimatës ose dispenser të fiskalizuar, ndërkohë që në rastin e daljes nga magazina fiskale, si shitje ndaj një pale të tretë me para në dorë, çdo transaksion shoqërohet nga fatura e fiskalizuar dhe e printuar nga sistemi fiskal i instaluar në dispenser, kur dalja nga magazina fiskale është shitje ndaj një pale të tretë.

Në rastin kur subjekti sasinë e karburantit të dalë nga magazina e tij fiskale e transporton te pika e tij e shitjes me pakicë, atëherë lëshohet dhe fiskalizohet vetëm fatura shoqëruese, e cila specifikon procedurën e "Transferim".

Në rastet kur subjekti importues nuk e shkarkon karburantin e importuar në magazinën e tij fiskale, por e shet drejtpërdrejt te stacionet e shitjes me pakicë, ai lëshon një faturë elektronike për sasinë e shitur, e cila përmban të njëjtën sasi të karburantit të blerë, siç pasqyrohet në dokumentacionin e importit. Në rastet kur kryhen disa shitje, sasitë duhet të korrespondojnë me të dhënat për sasinë e importuar.

Autoriteti tatimor, në bashkëpunim me autoritetin doganor, mbikëqyrin në mënyrë periodike sasitë e deklaruara për shitje nga shoqëritë e shitjes me shumicë në transaksionet me shoqëritë e shitjes me pakicë, duke kryer kontrolle të posaçme të inventarit dhe shitjeve me pakicë të këtyre të fundit.

**2.8 Procedura e tregtimit nëpërmjet rishitjes së karburantit nga magazina fiskale e prodhuesit tek ajo e shoqërisë së tregtimit me pakicë**

Në rast se karburanti blihet nga një shoqëri e tregtimit me shumicë dhe lëviz drejtpërdrejt nga magazina fiskale e prodhuesit (shitësit) te shoqëria e tregtimit me pakicë, por lëvizja fizikisht e karburantit përmes transportit nuk kryhet nëpërmjet magazinave fiskale të tregtuesit me shumicë, por me dërgimin e tij te shoqëria e shitjes me pakicë, shoqëria e tregtimit me shumicë që blen karburantin pajiset me faturë elektronike dhe faturë shoqëruese nga sistemi fiskal i instaluar në kalimatës në magazinën tatimore të prodhuesit për transaksione pa para në dorë dhe/ose vetëm me faturë elektronike nga sistemi fiskal i instaluar në dispenser për transaksione me para në dorë.

Shoqëria e tregtimit me shumicë, për sasinë që i shet shoqërisë së tregtimit me pakicë, lëshon faturë që përmban të njëjtën sasi me karburantin e shitur, siç pasqyrohet në dokumentacionin e lëshuar nga prodhuesi (faturë elektronike dhe faturë shoqëruese nga sistemi fiskal i instaluar në kalimatës për transaksionet pa para në dorë ose vetëm faturë elektronike nga sistemi fiskal i instaluar në dispenser për transaksionet me para në dorë). Në rastet kur kryhen disa shitje, sasitë duhet të korrespondojnë me të dhënat për sasinë që paraqiten në faturën elektronike dhe faturën shoqëruese të lëshuar nga prodhuesi.

Autoriteti tatimor mbikëqyr në mënyrë periodike sasitë e deklaruara për shitje nga prodhuesi i karburantit për shoqëritë e tregtimit me shumicë, si dhe shitjet e këtyre të fundit te shoqëritë e tregtimit me pakicë, duke kryer kontrolle të posaçme të inventarit dhe shitjeve me pakicë nga këto të fundit.

**2.9 Procedura e trajtimit të lëvizjes fizike të karburantit nga një depozitë te një tjetër (pa ndryshim të pronësisë)**

Në rastet e lëvizjes së produkteve të ndryshme të karburantit në pronësi të një tatimpaguesi nga një depozitë te një tjetër brenda shoqërisë ose për qëllime provash, për çdo dalje lëshohet dhe fiskalizohet një faturë shoqërimi nga sistemi fiskal i instaluar në kalimatës, e cila specifikon procedurën "Transferim", por, në asnjë rast, kjo dalje nga depozitat nuk konsiderohet si transaksion.

**3. Fiskalizimi i shitjeve me tollon**

Në rastet kur për shitjet me pakicë të karburantit përdoret tollon, lëshohet dhe fiskalizohet fatura elektronike kur tolloni lëshohet dhe i shitet klientit (tatimpaguesit), e cila përmban numrin serial të tollonit që përdoret në transaksion. Më tej, kur ky tollon përdoret si mjet pagese dhe shkëmbehet për hidrokarburet, siç shënohet në tollon ose në dokumentet shoqëruese, atëherë lëshohet faturë nga sistemi fiskal i dispenserit të furnizuesit të hidrokarbureve te konsumatori (si faturë me para në dorë) dhe ka si mënyrë pagese "Tollon". Në përputhje me përcaktimet e ligjit, fatura me mënyrë pagese "Tollon" nuk merret në konsideratë në llogaritjen e qarkullimit të tatimpaguesit, me kusht që për tollonin e përdorur të jetë lëshuar dhe fiskalizuar më parë një faturë elektronike kur tolloni është lëshuar dhe shitur te konsumatori fundor.

Tatimpaguesi mban regjistra kontabël të veçantë për shitjet me tollona, për çdo tatimpagues, ku të pasqyrohen bilancet dhe lëvizjet e llogarive.

**4. Fiskalizimi i shitjeve me anë të kartave të shoqërisë ose entitetit**

Kur fatura për tregtimin me pakicë të karburantit paguhet me kartën e shoqërisë ose entitetit të blerësit, në momentin e furnizimit shitësi lëshon faturën nga sistemi fiskal i instaluar në dispenser, e cila përmban informacionin identifikues të blerësit (NIPT-i, emri/emri dhe mbiemri). Deri në fund të muajit shitësi lëshon faturën përmbledhëse, e cila duhet të përmbajë një referencë në NSLF-në e faturave individuale të lëshuara gjatë të njëjtit muaj për të njëjtin klient, me mënyrë pagese "Karta e shoqërisë ose entitetit".

Vetëm në këtë rast, fatura përmbledhëse konsiderohet për qarkullimin e muajit të shitësit dhe faturat individuale të lidhura nuk do të llogariten në librat e shitjes/blerjes.

**5. Deklarimi i gjendjes fizike të karburantit**

Çdo tatimpagues, që ushtron veprimtari në tregtimin me shumicë ose pakicë të hidrokarbureve, i jep administratës tatimore, brenda datës së fundit të muajit kalendarik, informacion mbi sasinë fizike totale që disponon në depot e njësive të tij të biznesit në ditën kur jepet një informacion i tillë. Ky informacion dërgohet në Platformën Qendrore të Faturave në llogarinë personale të tatimpaguesit.

Të dhënat për sasinë raportohen veçmas për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe për çdolloj lënde hidrokarbure gjendje.

**6. Gjurmimi dhe ndjekja e nivelit të karburantit**

Çdo tatimpagues, që operon në fushën e tregtimit me shumicë dhe/ose pakicë të hidrokarbureve, përfshirë edhe GNL-në, duhet të garantojë që të ketë të instaluar një sistem të gjurmimit dhe identifikimit të nivelit të hidrokarbureve në të gjitha ambientet e depozitimit në përdorim të tij, që nga hallka fillestare e zinxhirit ekonomik të këtyre produkteve dhe deri tek ajo përfundimtare.

Sistemi i gjurmimit detyrimisht ka pjesë të tij edhe zgjidhjen *software*-ike të certifikuar, nëpërmjet së cilës bëhet deklarimi apo raportimi i shitjeve/lëvizjes së karburantit.

Autoriteti tatimor mbikëqyr dhe kontrollon në mënyrë të vazhdueshme çdo lëvizje të karburanteve dhe saktësinë e veprimeve të kryera sipas këtij vendimi.

**7. Sistemi i monitorimit dhe qarkullimit**

Mbikëqyrja dhe kontrolli i çdo tatimpaguesi në fushën e tregtimit të hidrokarbureve sipas këtij vendimi bëhet nëpërmjet sistemit të monitorimit, i cili ofrohet, instalohet dhe mirëmbahet nga operatorë privatë të autorizuar sipas këtij vendimi.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë autoritetet përgjegjëse për pajisjen me autorizim të të gjitha shoqërive private që ofrojnë shërbimin e monitorimit dhe qarkullimit të transaksioneve në sektorin e hidrokarbureve, sipas këtij vendimi.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përzgjedhin në total jo më shumë se 3 (tre) operatorë privatë që do të ofrojnë shërbimin e monitorimit dhe qarkullimit të transaksioneve në sektorin e hidrokarbureve në tregun e Republikës së Shqipërisë. Operatorët ekonomikë përzgjidhen nëpërmjet proceseve konkurruese, të organizuara për qëllim të autorizimit të tyre.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është autoriteti përgjegjës që firmos autorizimin për subjektin që përzgjidhet fitues, të lëshuar sipas procedurës të përcaktuar në këtë vendim.

Ministri i i Financave dhe Ekonomisë nxjerr udhëzimin mbi metodologjinë e përcaktimit të tarifave tavan të instalimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të monitorimit të hidrokarbureve nga operatorët privatë, të autorizuar sipas këtij vendimi. Tarifat tavan, të miratuara nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, mbështeten në studimin e tregut, që kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Tarifat e instalimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të monitorimit të hidrokarbureve përcaktohen nga operatorët privatë të autorizuar, duke respektuar tarifat tavan.

III. KRITERET DHE APLIKIMI PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM TË SUBJEKTEVE TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E PAJISJEVE QË LIDHEN ME QARKULLIMIN DHE MONITORIMIN NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE

8. Çdo person juridik, shqiptar ose i huaj, që plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 11, të këtij vendimi, mund të jetë një implementues dhe mirëmbajtës i sistemit të monitorimit të sektorit të

hidrokarbureve dhe, si i tillë, duhet të regjistrohet në regjistrin e shoqërive të autorizuara.

9. Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike, përmes portalit *e-Albania*.

10. Nëse aplikuesi është një shoqëri e huaj, që nuk është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar sipas legjislacionit shqiptar.

11. Kriteret për aplikimin në regjistrin e përmendur në pikën 8, të këtij vendimi janë:

a) Të ketë minimumi 20 (njëzet) punonjës të punësuar nga aplikanti për të paktën 1 (një) muaj para paraqitjes së aplikimit të regjistrimit në regjistër, me kualifikimet e mëposhtme:

i. të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje serveri nga prodhuesi;

ii. të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje *network*-u nga prodhuesi;

iii. të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni *web/mobile* nga prodhuesi;

iv.të paktën 6 (gjashtë) punonjës të certifikuar për konfigurim dhe mirëmbajtje pajisjesh matëse të nivelit të hidrokarbureve nga prodhuesi i tyre;

v.të paktën 10 (dhjetë) punonjës të certifikuar për konfigurim dhe mirëmbajtje të pajisjes ndërlidhëse të sensorëve dhe zgjidhjes *software*-ike nga prodhuesi i tyre;

vi. të paktën 10 (dhjetë) punonjës të certifikuar për konfigurim dhe mirëmbajtje të zgjidhjes *sofware*-ike për menaxhimin e sensorëve dhe pajisjeve fiskale;

vii.të paktën 2 (dy) punonjës të diplomuar si inxhinierë nafte.

b) Shoqëria duhet të jetë aktive të paktën 3 (tre) muaj para paraqitjes së aplikimit të regjistrimit në regjistër dhe të dorëzojë dokumentacionin, ku vërteton se ka kryer zhvillime *software*-ike apo aplikacione të ngjashme me objektin e këtij vendimi.

c) Të ketë realizuar mesatarisht jo më pak se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë qarkullim në 3 (tri) vitet e fundit.

ç) Shoqëria ka në fushë veprimi veprimtarinë e zhvillimit, të mirëmbajtjes, të shitjes së zgjidhjeve *software*-ike dhe *hardware*-ike për teknologjinë e informacionit dhe telekomunikacionit.

d) Shoqëria duhet të jetë e pajisur me certifikatat:

i. ISO 9001 për menaxhimin e cilësisë;

ii. ISO 27001 për menaxhimin e sigurisë;

iii. ISO 14001 për menaxhimin e ambientit.

dh)Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili prej tyre duhet të përmbushë kriteret në varësi të shërbimit që do të ofrojë.

12. Për regjistrimin në regjistrin e përmendur në pikën 8, të këtij vendimi, paraqiten informacionet/dokumentet e mëposhtme:

a) numri unik i identifikimit të shoqërisë që aplikon;

b) emri i shoqërisë së instalimit dhe mirëmbajtjes së sistemit;

c) informacioni i kontaktit (emri dhe mbiemri i personit të kontaktit, numri i telefonit, adresa *e-mail*, adresa e postës);

ç) emri, versioni i sistemit të monitorimit;

d) dokumentet që duhen paraqitur janë, si më poshtë vijon:

i. kopje e kontratës së punës me punonjësit e përmendur në pikën 11, shkronja "a", të këtij vendimi, dhe certifikatat përkatëse;

ii. dëshmi që shoqëria nuk është në proces falimentimi;

iii. një dokument që vërteton se subjekti dhe përfaqësuesi i tij ligjor (administratori) nuk janë dënuar për shkelje penale dhe nuk janë dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, në lidhje me aktivitetin profesional;

iv. pasqyrat financiare deri në 3 (tri) vitet e fundit;

v.vërtetim për kryerje shërbimi (sektori publik)/fatura tatimore dhe kontratë (sektori privat) ku vërteton se ka kryer zhvillime *software*-ike apo aplikacione të ngjashme me objektin e këtij vendimi.

13. Shoqëritë, që do të autorizohen për implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të monitorimit, duhet të përmbushin të gjitha kërkesat si më sipër si dhe do të depozitojnë një garanci bankare ose nga shoqëritë e sigurimit në shumën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), e vlefshme përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit, duke filluar nga data e aplikimit për regjistrim në regjistër.

14. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, shoqëria duhet të paraqesë edhe kontratën e noterizuar si bashkim i operatorëve ekonomikë. Në këtë rast, të gjitha shoqëritë, që marrin pjesë në bashkimin e operatorëve ekonomikë, paraqesin

dokumentet e kërkuara në pikën 12, të këtij vendimi dhe vlerësimi i kritereve kryhet për të gjithë pjesëmarrësit në varësi të shërbimit që secili prej tyre do të kryejë.

15. Të gjitha dokumentet e paraqitura duhet të jenë në gjuhën shqipe, kopje të noterizuara ose origjinale (përveç vërtetimit bankar i cili duhet të jetë origjinal).

16. Autorizimi i shoqërisë do të ketë një vlefshmëri 10-vjeçare, me të drejtë rinovimi.

17. Shoqëria (përfshirë dhe punonjësit e angazhuar pranë kësaj shoqërie) nuk duhet të jetë e certifikuar ose e autorizuar, e licencuar ose e kontraktuar nga administrata shtetërore për një hallkë tjetër të procesit të kontrollit të hidrokarbureve.

18. AKSHI dhe DPT-ja, me urdhër të përbashkët, ngrenë një komision të përhershëm, me specialistë sipas fushave të përkatësisë si dhe hartojnë kriteret e vlerësimit dhe procedurën e ankimit. Dokumenti miratohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë. Komisioni do të udhëhiqet nga dy bashkëkryetarë, dhe do të shqyrtojë kërkesat e çdo aplikanti, të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur dhe vetë pajisjet e monitorimit dhe sistemin e monitorimit.

Pas vlerësimit të aplikimit, Komisioni harton një relacion sqarues, ku sugjeron që AKSHI dhe DPT-ja të lëshojnë autorizimin për aplikantin ose të vendosin refuzimin e kërkesës.

Autorizimi lëshohet nëpërmjet portalit *e-Albania*. Autorizimi përmban kodin e shoqërisë së autorizuar dhe kodin e versionit të sistemit të monitorimit.

Autorizimi shoqërohet me marrëveshje që do të përmbajë termat dhe kushtet e operimit të shoqërisë së autorizuar për ofrimin e produkteve/shërbimeve të saj, sipas modelit të miratuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Vendimi i refuzimit të aplikimit shoqërohet me arsyet përkatëse që kanë çuar në këtë vendim.

19. Afati i parashikuar për aplikim do të jetë 5 (pesë) ditë pune, ku dita e parë është e nesërmja e ditës së shpalljes publike.

20. Vetëm pasi shoqëria të pajiset me autorizimin e saj, ajo do të regjistrohet në regjistrin e shoqërive të autorizuara për implementim dhe mirëmbajtje, i cili do të jetë publik dhe mund të fillojë me ofrimin e produkteve/shërbimeve të tij, sipas këtij vendimi në tregun e Republikës së Shqipërisë.

21. Nëse nga DPT-ja apo AKSHI konstatohet se shoqëria e autorizuar ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij vendimi ose të akteve të tjera ligjore në fuqi, informacioni përkatës dhe dokumentacioni provues i përcillen për trajtim Komisionit, të ngritur sipas pikës 18, të këtij vendimi. Pas vlerësimit të praktikës, Komisioni harton një relacion sqarues, ku sugjeron që AKSHI dhe DPT-ja të vendosin ta shfuqizojnë ose jo autorizimin e dhënë. Vendimi për shfuqizimin e autorizimit, i marrë sipas kësaj pike, firmoset nga ministri dhe publikohet në një aneks të veçantë të regjistrit.

IV. DISPOZITA TRANZITORE

**22. Sensorët ekzistues**

Të gjitha subjektet tregtare, që kanë të instaluar pajisje monitorimi përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet t'i përshtatin për t'u ndërlidhur me sistemin e monitorimit të një shoqërie të autorizuar.

**23. Mirëmbajtja e sensorëve ekzistues**

Të gjitha subjektet tregtare, që kanë të instaluar pajisje monitorimi përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të kenë një kontratë mirëmbajtjeje me një shoqëri të autorizuar.

24. Migrimi i të dhënave nga sistemet ekzistuese

Migrimi i të dhënave ekzistuese nga pajisjet ekzistuese të monitorimit, që janë të instaluara në subjektet tregtare në sistemin e një shoqërie të autorizuar, duhet të kryhen nga një shoqëri e autorizuar.

25. Sistemet fiskale ekzistuese

Sistemet fiskale të instaluara në pikat e tregtimit me pakicë përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi duhet të përshtaten me sistemet fiskale, të përcaktuara në këtë vendim.

V. DISPOZITA TË TJERA

26. Sistemet e reja fiskale të parashikuara në këtë vendim janë të detyrueshme për t'u instaluar dhe për t'u përdorur nga tatimpaguesit, subjekt të këtij vendimi, duke filluar nga data 1 shtator 2021.

27. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

ANEKS

***Formati i Dokumentit të Transportit***
**Dokument Transporti**

Emri i tatimpaguesit:
Adresa:
NIPT:
Artikulli:
Sasia:
Data:
Kodi i njësisë së biznesit:
Kodi i pajisjes elektronike:
Dokument Transporti nr.:
NIVF:
NSLF:
NSLF referencë:
Kodi QR:

**VENDIM**
**Nr. 88, datë 17.2.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE TË TJERË ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kreu 2.2, i lidhjes nr. 2, që përmendet në shkronjën "j", të pikës 2, zëvendësohet me kreun 2.2 me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2021.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lidhja 2 (kreu 2.2)**

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PERSONELIN TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE NË QENDRËN KOMBËTARE TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PËR FËMIJËT

| | **EMËRTIMI** | **PAGA MUJORE** | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 1 | Kryeinfermier | | 2% | 0 | 53.200 |
| 2 | Infermier | | 2% | 0 | 45.000 |
| 3 | Kujdestar | | 2% | 0 | 39.550 |

**VENDIM**
**Nr. 89, datë 17.2.2021**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE BLINISHT, TË PASURIVE 176 DHE 182/3, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 1220**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Lezhë, për Njësinë Administrative Blinisht, të pasurive 176 dhe 182/3, me vendndodhje në zonën kadastrale 1220, sipas formularit, gjithsej, 1 (një) fletë, dhe planrilevimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të bujqësisë.

2. Ngarkohen Bashkia Lezhë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Për Inventarizimin e Pronave të Veçanta)

BASHKIA LEZHË, NJ. A. BLINISHT

Identifikoi Ing. Nderim Muça, (Topograf)
(Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)

Supervizoi Gentian Malotaj (Drejtori i Zyrës Juridike & S.M.A.)
(Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)

Fusha e Përdorimit të Pronës : Bujqësi

Aprovoi Pjerin Ndreu (Kryebashkiaku)
(Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar, firma, vula)

| Nr rendor | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastrale & Indeksi i Hartës | Nr i Pasurisë | Lloji i Pronës | Emri i Pronës, Adresa | Sip Totale e Pronës (m²) | Nga Sip Totale sa Ndërtesë (m²) | Funksioni për të cilën Përdoret Prona | Institucioni / Enti me Përgjegjësi Administrative | Institucioni / Enti Përdorues, Statusi Juridik i Përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 1220 K-34-76-(101-B) | 176 | Arë | Arë, Fshati Blinisht | 138'558 | 0 | Zhvillim Bujqësie | Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural | Bashkia Lezhë | |
| 2 | 1220 K-34-76-(101-B) | 182/3 | Arë | Arë, Fshati Blinisht | 75'978 | 0 | Zhvillim Bujqësie | Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural | Bashkia Lezhë | |

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI SHTET** | **DATE 12.02.2021** | **QELLIMI : Inventarizim/Transferim**

VENDNDODHJA

BASHKIA LEZHË | ZVASHK: LEZHË | ZONA KADASTRALE: 1220 | NUMRI PASURISE: 176 | INDEX HARTE: K-34-76-(101-B)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: ARË | SIP.PASURISE=138558m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=______m2 | NUMRI KATEVE_____ | NUMRI PEMEVE______

X=469439.27
Y=4638059.41

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=471386.66
Y=4638059.41




X=469439.27
Y=4636765.75

**SH 1:10 000**

X=471386.66
Y=4636765.75

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | 325 | | |
| 2 | JUG | | | 346 | | |
| 3 | PERËNDIM | | | 325 | | |
| 4 | LINDJE | | | 326 | | |

**REALIZOI PER BASHKINË LEZHË**

EMRI:ING.NDERIM MUCAJ

Specialist

NENSHKRIMI/VULA ________

REPUBLIKA E SHQIPERISË
SEKRETARIA
BASHKIA LEZHË

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE:O**

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

**PERCAKTIMI KUFIRIT:PB**

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

**SHENIME TE VECANTA:**

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**

EMRI SHTET (BASHKIA LEZHË)

NENSHKRIMI _______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI SHTET DATE 10.02.2021 QELLIMI : Inventarizim/Transferim

VENDNDODHJA

BASHKIA LEZHË ZVASHK LEZHË ZONA KADASTRALE: 1220 NUMRI PASURISE: 182/3 INDEX HARTE: K-34-76-(101-B)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: ARË SIP.PASURISE=75978m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=______m2 NUMRI KATEVE_____ NUMRI PEMEVE______

X=469845.20 Y=4637962.39 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X=470818.90 Y=4637962.39




X=469845.20 Y=4637315.56 SH 1:5 000 X=470818.90 Y=4637315.56

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | 325 | | |
| 2 | JUG | | | 182/2 | | |
| 3 | PERËNDIM | | | 326 | | |
| 4 | LINDJE | | | 327 | | |

REALIZOI PER BASHKINË LEZHË

EMRI:ING.NDERIM MUCAJ

Specialist

NENSHKRIMI/VULA

REPUBLIKA E SHQIPERISË SEKRETARIA BASHKIA LEZHË

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:O

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:PB

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI SHTET (BASHKIA LEZHË)

NENSHKRIMI _______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

**VENDIM**
**Nr. 92, datë 17.2.2021**

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 55, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE, UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62, 97 e 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) në pikën 5.3, pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "dh/1", me këtë përmbajtje:

"dh/1) Shenja e krahut e Drejtorisë së Antiterrorit";

b) në lidhjen nr. 4, të albumit, shtohet shenja dalluese për Drejtorinë e Antiterrorit, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga programi buxhetor "Policia e Shtetit".

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LIDHJA 1

| **a) Lidhja 4, pika 5.3, shkronja "dh/1"** |
|---|
| **"Shenjë krahu e Drejtorisë së Antiterrorit"** |
|  |

Mburojë (shqyt) e ndarë në dy pjesë: Shqyta e parë me sfond ngjyrë blu të errët e kornizuar me ngjyrë të artë. Shqyta e dytë me sfond ngjyrë të kuqe, në mes është vendosur Shqiponjë dykrenore me krahë të hapur anash, në gjoksin e saj një mburojë (shqyt), me motive, në qendër dielli. Mbi dy krenoret të Shqiponjës lart, është vendosur Përkrenarja në profil djathtas, Shqiponja në kthetrën e djathtë një shpatë e drejtë me dy tehe dhe në kthetrën e majtë një degë ulliri. Brenda shqytës së parë lart, me sfond blu të errët, ka të shkruar me germa kapitale fjalën "ANTITERRORI", me ngjyrë të artë, ndërsa në pjesën e poshtme ka të shkruar me germa kapitale fjalët "POLICIA E SHTETIT", me ngjyrë të artë.

**VENDIM**
**Nr. 93, datë 17.2.2021**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHTESË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA NJË FOND I POSAÇËM I AKSIONARËVE TË BERZH-it, PËR PROJEKTIN E DETAJUAR TË LINJËS HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS DHE VLERËSIMIN FINANCIAR/ EKONOMIK TË TË GJITHË RRJETIT HEKURUDHOR SHQIPTAR, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 63/2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shtesë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga një fond i posaçëm i aksionarëve të BERZH-it, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar, të marrëveshjes së grantit, ratifikuar me ligjin nr. 63/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**SHTESË E MARRËVESHJES SË GRANTIT nr. 001167**
*e*
**MARRËVESHJES FILLESTARE TË GRANTIT nr. C25990/WBES-2013-03-02**
*për*
**Shqipëri: Për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar – shtesë**
*në*
Shqipëri ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administratore e fondeve të grantit, të siguruara nga Fondi i Veçantë i Aksionerëve të BERZH-it
28 janar 2021

SHTESË E MARRËVESHJES SË GRANTIT

Shtesa e Marrëveshjes së Grantit nr. 001167, datë 28 janar 2021, ndërmjet **Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë** ("**Marrësi**") me adresë: bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri, dhe **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim** ("**BERZH**" ose "**Banka**") me seli në One Exchange Square, London EC2A 2JN, United Kingdom (Mbretëri e Bashkuar), një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar në bazë të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës, të nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, në cilësinë e administratores së fondeve të grantit, të siguruara nga Fondi i Veçantë i Aksionerëve të BERZH-it ("**Donatori**").

**Preambulë**

*Duke pasur parasysh se* Banka dhe Klienti kanë lidhur një Marrëveshje Granti nr. **C25990/WBES-2013-03-02** ("**Marrëveshja Fillestare e Grantit**"), të datës **13 mars 2015** (**e ndryshuar deri tani**) për ofrimin e shërbimeve të konsulencës lidhur me **"Projektimin e detajuar të linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe vlerësimin financiar/ ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar – shtesë",**

*Duke pasur parasysh se* **Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës** e asaj kohe (**aktualisht**

**"Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë"**) ("**Klienti**") dhe **Rail Consulting Joint Venture "JV RAILCON" e asaj kohe**, me adresë: 27 Monemvassias Street, Athens, 15125, Greece (Greqi) e (**aktualisht DROMOS Consulting Ltd** ("**Konsulenti**")) kanë lidhur një kontratë konsulence nr. **C25990/WBES-2013-03-02** ("**Kontrata fillestare e konsulencës**") për ofrimin e shërbimeve,

*Duke pasur parasysh se* Klienti kërkoi bashkëpunim teknik shtesë nga BERZH-i dhe Donatori ka miratuar dhe ka rënë dakord të vendosë në dispozicion fonde deri në shumën e **600,000.00 EURO** mbi bazë granti ("**Granti Shtesë**") që të financojë Shërbimet shtesë të Konsulentit me qëllim përgatitjen e projektimit të detajuar të seksionit hekurudhor midis vendndodhjes së Terminalit të Transportit Publik në Tiranë (TTP) dhe Stacionit të Trenit të Tiranës pranë qendrës së qytetit,

*Duke pasur parasysh se* Klienti synon të lidhë një shtesë të kontratës së konsulencës me Konsulentin për ofrimin e shërbimeve shtesë ("**Shtesa e kontratës së konsulencës**"), për një shumë tavan prej **600,000.00 eurosh**,

*Duke pasur parasysh se* Banka ka rënë dakord që të administrojë grantin shtesë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara,

*Atëherë*, palët bien dakord shprehimisht për sa më poshtë:

Neni 1
**Përkufizime**

1.01 Përkufizime dhe interpretimi

Kudo që përdoren në këtë shtesë të Marrëveshjes së Grantit, nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat me shkronjë kapitale kanë kuptimet që u janë caktuar në marrëveshjen fillestare të Grantit dhe në këtë shtesë të Marrëveshjes së Grantit.

Neni 2
**Granti shtesë**

2.01 Granti

a) Banka bie dakord që t'i vendosë në dispozicion Përfituesit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen Fillestare të Grantit dhe në këtë shtesë të Marrëveshjes së Grantit, Grantin shtesë në një shumë që nuk tejkalon **600,000.00 euro** apo të shumë të barasvlershme me të.

b) Granti shtesë do të zbatohet vetëm për financimin e shërbimeve shtesë gjatë afatit të angazhimit të Konsulentit, siç përcaktohet në këtë shtesë të Marrëveshjessë Grantit.

2.02 Disbursimi

Nëse shërbimet shtesë do të vlerësohen të kënaqshme dhe Klienti konstaton se shumat e faturuara korrespondojnë me shumat e përcaktuara në shtesën e kontratës së konsulencës, fatura, dokumentet mbështetëse dhe një deklaratë (siç përcaktohet në shtojcën A të kësaj shtese të Marrëveshjes së Grantit), e cila vërteton miratimin e shërbimeve, duhet t'i dërgohet Bankës për kryerjen e pagesës në **Zyrën Vendëse të Bankës në Tiranë, në godinën "Torre Drin", kati i 4-t, rruga "Abdi Toptani", Tiranë, Shqipëri.**

2.03 **Efektiviteti**

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Grantit do të hyjë në fuqi pasi BERZH-i të marrë njoftimin me shkrim nga Huamarrësi, që:

i. kjo shtesë e Marrëveshjes së Grantit është miratuar sipas rregullave nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë; dhe

ii. të gjitha procedurat e kërkuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë që kjo shtojcë e Marrëveshjes së Grantit të hyjë në fuqi, kanë përfunduar.

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Grantit do të mbetet në fuqi derisa Marrësi dhe Klienti të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse përfundojnë më herët në përputhje me kushtet e saj.

Në dëshmi sa më sipër, palët, duke vepruar me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë shtesë të Marrëveshjes së Grantit, të hartuar në gjuhën angleze, në datën dhe vitin e shënuar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË MARRËSIT:

**Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
**Anila Denaj**
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
**Datë:** 28.1.2021

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM:
**Matteo Colangeli**
Drejtor i asociuar, drejtues i zyrës në Shqipëri
**Datë:** 21.1.2021

SHTOJCË A
DEKLARATA E MIRATIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

SHTOJCA A PËR SHTESËN E MARRËVESHJES SË GRANTIT
DEKLARATA E MIRATIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS
*Për t'u nënshkruar nga Klienti dhe për t'u dërguar me faturën/at për shërbimet e ofruara nga Konsulenti.*

Nr. i faturës:
Shuma e faturës:
Shtesa e Marrëveshjes së Grantit nr.: **<…>**
OL: **Ilir Basha**

1. Në përputhje me shtesën e kontratës së konsulencës për projektin **"Shqipëri: projektimi i detajuar i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe vlerësimi financiar/ekonomik i të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar – shtesë"** [**"Shërbimet"**], të datës .......**2020**, të lidhur ndërmjet **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë** ["**Klienti**"] dhe **DROMOS Consulting Ltd** ["**Konsulenti**"]; dhe në përputhje me Shtesën e Marrëveshjes së Grantit **Nr.** 001167 për Shërbimet, e datës ..... 2020, të lidhur ndërmjet **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim** ["**Banka**"] dhe **Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë** ["**Marrësi**"], Klienti deklaron se:

i) Klienti ka marrë dhe është i kënaqur me Shërbimet e ofruara nga Konsulenti, të cilat ishin kontraktuar sipas shtesës së kontratës së konsulencës dhe që përcaktohen në faturën/at bashkëlidhur;

ii) Klienti ka kontrolluar faturën/at dhe të gjithë dokumentet mbështetëse që lidhen me kryerjen e shërbimeve kundrejt shumës/ave të përcaktuar/a në skedulin B të shtesës së Marrëveshjes së Konsulencës dhe është i bindur se:

a) fatura/t është/janë të sakta për sa u përket shërbimeve të ofruara nga Konsulenti; dhe

b) shuma/t e faturuar/a korrespondon/jnë me shumën/at e përcaktuar/a në skedulin I të shtesës së kontratës së konsulencës;

iii) fatura/t dhe të gjitha dokumentet mbështetëse, bashkërisht me deklaratën e miratimit, i janë përcjellë **Zyrës Vendëse të Bankës në Tiranë, në godinën "Torre Drin", kati i 4-t, rruga "Abdi Toptani", Tiranë, Shqipëri,** për kryerjen e pagesës; dhe

iv) Klienti i ka paguar Konsulentit taksat indirekte, duke përfshirë TVSH-në, të lidhura me faturat e mëparshme dhe merr përsipër të paguajë taksat indirekte, duke përfshirë TVSH-në, lidhur me faturën/at bashkëngjitur, brenda 30 ditëve nga data e kësaj deklarate miratimi.

2. Klienti deklaron se me nënshkrimin e këtij dokumenti, Klienti autorizon Bankën që të kryejë disbursimin e rakordësuar në shtesën e kontratës së konsulencës ndaj Konsulentit në emër të Klientit.

Data e faturës:

*Në dëshmi sa më sipër,* pala, duke vepruar me anë të përfaqësuesit të saj të autorizuar sipas rregullave, ka nënshkruar këtë deklaratë më .................. [data].

PËR DHE NË EMËR TË:
Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

__________________________

**VENDIM**
**Nr. 94, datë 17.2.2021**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, MBI PUNIMET E NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi punimet e ndërtimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË MBI PUNIMET E NDËRTIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, në vijim-të referuara si "Palët";

Duke shprehur dëshirën për të forcuar marrëdhëniet miqësore dhe partneritetin strategjik midis dy vendeve dhe për të zhvilluar bashkëpunimin në fushën e punimeve të ndërtimit.

Duke ofruar zgjidhje për problemet aktuale dhe potenciale të ndërtimit dhe shpërndarjen e mundësive për zhvillimin e ndërtimeve të qëndrueshme, të sigurta, për mirëqenien e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm,

Duke pranuar rëndësinë e qasjes së zhvillimit të qëndrueshëm për të përmirësuar shërbimet e ndërtimit,

Duke vërejtur se një bashkëpunim i tillë do t'i shërbente interesave të përbashkëta të Palëve dhe do të kontribuonte në zhvillimin e tyre ekonomik dhe shoqëror,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për të vendosur bashkëpunimin e përbashkët dhe shkëmbimin e ekspertizës administrative dhe teknike në fushat e punimeve të ndërtimit dhe legjislacionit të ndërtimit, Palët do të bashkëpunojnë nëpërmjet ndarjes së njohurive, përvojës, praktikave më të mira dhe teknologjisë në bazë të barazisë, përfitimit dhe reciprocitetit.

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

**Punimet e ndërtimit dhe legjislacioni i ndërtimit**

1. Procesi i ndërtimit dhe ndërtesave brenda kuadrit të legjislacionit për zonimin;
2. Inspektimi i ndërtesës;
3. Përgatitja e legjislacionit të Sistemit Elektronik të Monitorimit të Betonit në Republikën e Shqipërisë dhe instalimi i sistemit.

Neni 3

Palët do të bashkëpunojnë për fushat e përcaktuara në nenin 2, nëpërmjet:

1. Organizimit të programeve trajnuese, takimeve, konferencave dhe simpoziumeve;
2. Organizimit të programeve shkencore dhe teknike të vizitave;
3. Organizimit të vizitave të ndërsjella të studiuesve, konsulentëve, ekspertëve dhe anëtarëve dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare;
4. Shkëmbimit të informacionit, ekspertizës dhe dokumenteve për aktivitetet kërkimore, zhvillimore dhe zbatuese;
5. Zhvillimit të projekteve.

Neni 4

Palët do të bashkëpunojnë brenda kuadrit të legjislacionit përkatës të zbatueshëm për secilën, Palë dhe fondeve të alokuara për këtë qëllim.

Palët do të shkëmbejnë ekspertin në fushat e rëna dakord dhe shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe akomodimit do të mbulohen nga Pala dërguese.

Financimi i softuerit dhe harduerit që do të përdoret brenda objektit të Sistemit Elektronik të Monitorimit të Betonit (EMCS) që do të vendoset në Republikën e Shqipërisë, do të përcaktohet nga protokolli që do të nënshkruhet si rezultat i negociatave midis palëve në vijim të hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 5

Nëse palët bien dakord reciprokisht, ato mund të ftojnë institucionet qeveritare, institucionet akademike, sektorin privat dhe organizatat joqeveritare që të marrin pjesë në aktivitetet e bashkëpunimit brenda kontekstit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 6

Palët caktojnë institucionet e përmendura më poshtë si autoritete kompetente, me qëllim zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi,

1. Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
2. Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë: Ministria e Mjedisit dhe Urbanizimit.

Neni 7

Pas hyrjes së tij në fuqi, një Palë e Komitetit të Përbashkët do të krijohet për të garantuar zbatimin efikas të aktiviteteve të bashkëpunimit brenda kuadrit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe do të veprohet si më poshtë:

1. Secila palë do të caktojë një Koordinator Kombëtar për të qenë përgjegjës për menaxhimin e fushave të bashkëpunimit të renditura këtu, brenda 3 (tre) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Koordinatorët Kombëtarë do të jenë të paktën në nivelin e zëvendës menaxherit të përgjithshëm. Secila palë do të njoftojë palën tjetër në lidhje me emrin e Koordinatorit Kombëtar që ata kanë caktuar.

2. Koordinatorët Kombëtarë do të bashkëpunojnë për hartimin e programeve të përbashkëta të punës në fushat e bashkëpunimit të renditura në nenin 2 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
3. Koordinatorët Kombëtarë caktojnë datat për të diskutuar fushat e bashkëpunimit, bashkëkryesuar takimet e Komitetit të Përbashkët që mund të organizohen në datat e rëna dakord për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Komiteti i Përbashkët.
4. Takimet e Komitetit të Përbashkët do të zhvillohen një herë në vit në Turqi dhe Shqipëri, në mënyrë alternative.

Neni 8

Palët mund të bien dakord që të ndajnë rezultatet e bashkëpunimit të tyre me Palët e treta në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim.

Neni 9

Çdo dispozitë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do të interpretohet në një mënyrë që të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet aktuale të Palëve brenda objektit të Marrëveshjeve të tjera Ndërkombëtare në të cilat janë palë.

Neni 10

Palët do të garantojnë mbrojtje efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale të transferuara ose të krijuara brenda kuadrit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në përputhje me legjislacionet e tyre përkatëse kombëtare dhe traktatet ndërkombëtare në të cilat janë palë. Për qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pronësia intelektuale kuptohet që ka kuptimin e dhënë në nenin 2 të Konventës, Themelimi i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, bërë në Stokholm, më 14 korrik 1967.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet negociatave midis Palëve.

Neni 12

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet nëpërmjet miratimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve në çdo kohë. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 13 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 13

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit përfundimtar me shkrim me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 1 (një) viti dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme 1-vjeçare (njëvjeçare), përveç nëse njëra nga Palët njofton tjetrën me shkrim me anë të kanaleve diplomatike për qëllimin e saj për të përfunduar Memorandumin e Mirëkuptimit.

Secila palë mund të përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi në çdo kohë, duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim për këtë qëllim me anë të kanaleve diplomatike. Në këtë rast, ky Memorandum Mirëkuptimi do të përfundojë 3 (tre) muaj pas datës së marrjes së njoftimit. Përfundimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të rëna dakord në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit dhe të iniciuara para përfundimit/zgjidhjes së tillë deri në përfundimin e tyre, përveç nëse palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Nënshkruar në Ankara, më 6.1.2021, në 2 (dy) kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

| Për Këshillin e ministrave të Republikës së Shqipërisë | Për qeverinë e Republikës së Turqisë |
|---|---|
| **Belinda Balluku**<br>Ministër i Infrastrukturës dhe Enegjisë | **Murat Kurum**<br>Ministër i Mjedisit dhe Urbanizimit |

## VENDIM
## Nr. 95, datë 17.2.2021

## PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim i referuar si "Palët"),

Duke marrë parasysh dëshirën për të forcuar dhe thelluar marrëdhëniet e vazhdueshme të miqësisë dhe bashkëpunimit midis dy vendeve,

Në mënyrë që të mbështesë dhe përmirësojë shkëmbimin e njohurive, përvojës, shërbimeve dhe teknologjisë midis dy vendeve në kujdesin shëndetësor dhe mjekësinë,

Duke dashur të bëjnë më shumë përpjekje për të forcuar sistemet dhe politikat shëndetësore në vendet e tyre, përmes praktikave të përparuara akademike dhe shkencore,

Duke marrë parasysh që bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomive kombëtare dhe,

Kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
**Objektivi**

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e kujdesit shëndetësor ndërmjet dy shteteve, mbi bazën e barazisë dhe përfitimit reciprok, në përputhje me ligjet kombëtare të shteteve të tyre.

Palët do të promovojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetit dhe mjekësisë, mbi bazën e barazisë, mirëkuptimit reciprok dhe përfitimit të ndërsjellë. Fushat specifike të bashkëpunimit do të përcaktohen me marrëveshje të ndërsjellë duke marrë parasysh interesat e të dyja palëve.

Neni 2
**Fushat e bashkëpunimit**

Palët do të shkëmbejnë eksperiencë dhe do të bashkëpunojnë, me qëllim që të përmirësojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetit dhe mjekësisë, në fushat e mëposhtme:

a) forcimi i sistemeve të kujdesit shëndetësor;

b) shëndeti publik, veçanërisht sëmundjet ngjitëse dhe jongjitëse dhe pandemitë globale dhe praktika e mjekësisë familjare;

c) shkëmbimi i njohurive e përvojave dhe bashkëpunimi i ngushtë mbi barnat, pajisjet mbrojtëse dhe vaksinat, në lidhje me përgjigjen ndaj pandemisë COVID-19;

d) sistemet dhe teknologjitë e informacionit shëndetësor, statistikat shëndetësore, sistemet e menaxhimit të informacionit spitalor, *e-health*, qendra e kontrollit komandues, aplikacionet e telemjekësisë etj.;

e) menaxhimi dhe administrimi i spitalor;

f) shërbimet e akreditimit dhe kontrollit të cilësisë;

g) farmaceutikë, pajisje mjekësore, materiale konsumuese mjekësore, kozmetikë, vaksina, bioteknologji dhe prova klinike;

h) shërbimet e kujdesit shëndetësor në emergjenca dhe fatkeqësi natyrore;

i) trajnimi për ngritjen e kapaciteteve të personelit shëndetësor;

j) trajtimi ndërkombëtar i pacientit;

k) organizimi i përbashkët i javëve shëndetësore dhe forumeve të biznesit shëndetësor;

l) planifikimi i infrastrukturës shëndetësore, prokurimi i shërbimeve dhe investimet, duke përfshirë partneritetin publik privat.

Neni 3
**Metodat e bashkëpunimit**

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e përmendura në nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje, përmes metodave të mëposhtme:

a) shkëmbimi i informacionit në çështje me interes të përbashkët, në fushën e shëndetësisë;

b) vizita reciproke nga delegacionet, ekspertët dhe personeli shëndetësor;

c) zhvillimi i projekteve të përbashkëta të punës;

d) sigurimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse shëndetësore;

e) organizimi i seminareve, *workshops*, simpoziumeve dhe trajnimeve në fushat e mjekësisë me pjesëmarrjen e ekspertëve nga të dy vendet.

Neni 4
**Trajtimi i pacientit**

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë do të vazhdojë të ofrojë trajtim falas, për 100 pacientë në vit, të cilët nuk janë në gjendje të marrin trajtim në klinikat në Shqipëri. Procedurat dhe parimet në lidhje me paraqitjen e informacionit të pacientëve dhe procesin e trajtimit mund të bien dakord nga Palët më vonë.

Neni 5
**Marrëveshjet financiare**

Për vizitat e mundshme të ekspertëve dhe personelit tjetër të të dyja vendeve, sipas kësaj Marrëveshjeje,

- Pala dërguese do të mbulojë koston e transportit vajtje-ardhje për në kryeqytetin e palës pritëse.
- Vendi pritës do të mbulojë shpenzimet e vakteve dhe akomodimit, si edhe shpenzimet e udhëtimit brenda vendit (nëse është e nevojshme). Kohëzgjatja e vizitave të tilla nuk duhet të kalojë 2 (dy) javë.
- Vendi pritës do të bjerë dakord të ofrojë trajtim urgjent mjekësor për ekspertët vizitorë në rast urgjence.

Neni 6
**Autoritetet zbatuese, mbikëqyrja dhe monitorimi**

Zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë. Pala turke mund të delegojë disa nga detyrimet e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje, tek Shërbimet Ndërkombëtare të shëndetësisë Inc. (USHAŞ).

Palët do të krijojnë dhe konsultohen me komitetin e përbashkët të punës, për zbatimin më të shpejtë dhe më efektiv të fushave të bashkëpunimit, të përmendura në nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi, ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore, përmes negociatave, ose konsultimeve nga Palët.

Neni 8
**Konfidencialiteti**

Palët mund të përdorin lirisht çdo informacion të dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse Pala tjetër ka specifikuar ndonjë kufizim, ose rezervë për përdorimin, ose ndarjen e informacionit të dhënë, ose i klasifikon këto informacione si konfidenciale.

Neni 9
**Hyrja në fuqi, kohëzgjatja, ndryshimet dhe dispozitat përfundimtare**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin Palët do të informojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.
2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare). Kjo Marrëveshje do të rinovohet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme prej 1 (një) viti, përveç nëse njëra nga Palët njofton tjetrën me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, për qëllimin e saj për të përfunduar Marrëveshjen 6 (gjashtë) muaj para skadimit të saj. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë efektiv brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të Palës tjetër. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në aktivitetet dhe projektet tashmë të filluara ose në progres.
3. Marrëveshja mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të Palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni.
4. Palët ranë dakord për shfuqizimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin në fushën e shëndetit dhe

mjekësisë, të nënshkruar më 13 nëntor 1999, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen pa paragjykuar detyrimet ndërkombëtare të ndonjë Pale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të të dyja vendeve.

6. Të gjitha llojet e bashkëpunimit të mbuluara nga kjo Marrëveshje duhet të jenë në përputhje dhe të zbatohen në përputhje me ligjin e zbatueshëm në territoret e shteteve të të dyja Palëve.

Bërë në Ankara, më 6 janar 2021, në kopje në gjuhë turke, shqipe dhe angleze, secili version është njësoj autentik. Në rast divergjence, mbizotëron teksti në anglisht.

| Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë | Në emër të Republikës së Turqisë |
|---|---|
| **Znj. Ogerta Manastirliu** | **Dr. Fahrettin Koca** |
| Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | Ministër i Shëndetësisë |

## VENDIM
## Nr. 96, datë 17.2.2021

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 299, DATË 8.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË TREGTIMIT TË BARNAVE E TË KLASIFIKIMIT TË TYRE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14/1, të aktit normativ nr. 5, datë 12.2.2021, "Për disa shtesa në ligjin nr. 105/2014, 'Për barnat dhe shërbimin farmaceutik', të ndryshuar", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 299, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1, të nenit 2, të kapitullit I, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Për autorizimin e kushtëzuar të tregtimit aplikimi mund të kryhet edhe nga institucione publike.".

2. Pas kapitullit III shtohet kapitulli III/1, me këtë përmbajtje:

"KAPITULLI III/1
**Procedura e autorizimit të kushtëzuar të tregtimit**

1. Procedura e autorizimit të kushtëzuar të tregtimit aplikohet për barnat që kanë një autorizim tregtimi me procedurë të centralizuar nga Agjencia Evropiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose nga Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Aplikanti duhet të justifikojë se bari synon të përdoret në situatë emergjente (pandemi, epidemi) si përgjigje ndaj kërcënimeve të shëndetit publik të njohura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

3. Aplikanti duhet të dorëzojë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesë për aplikim, për dhënien e autorizimit, për tregtim të kushtëzuar për barna, që duhet të përmbajë: emrin e barit, lëndën vepruese, dozën dhe formën farmaceutike, grupin farmako-terapeutik, sipas klasifikimit ATC, datën dhe nënshkrimin e personit përgjegjës (me diplomë në mjekësi, farmaci, stomatologji, biologji), të autorizuar nga Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim, listën e dokumentacionit të dorëzuara me aplikimin;

b) certifikatë e produktit farmaceutik, e lëshuar nga autoriteti shëndetësor përkatës, sipas rekomandimit të OBSH-së, në origjinal, ku tregohet se bari është i pajisur me autorizimin për tregtim dhe qarkullon në vendin e origjinës nga Agjencia Evropiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose nga Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

c) certifikatë e praktikës së mirë të prodhimit (GMP) e publikuar në faqen zyrtare: http://eudragmdp.ema.europa.eu (Eudra GMP), e vlefshme në momentin e aplikimit. Në rast se nuk është e disponueshme Eudra GMP, atëherë të pranohet një kopje e GMP-së, e vlefshme në momentin e aplikimit;

ç) autorizim tregtimi/certifikatë/vendim nga EMA ose FDA-ja të autorizimit, të kushtëzuar për tregtim nga EMA ose FDA-ja (kopje e origjinalit).

4. Dosja dorëzohet në formatin e dokumentit të përbashkët teknik (*Common Technical Document CTD*), sipas udhëzimeve përkatëse nga EMA dhe/ose FDA-ja.

5. Për të shqyrtuar aplikimin e autorizimit të tregtimit të kushtëzuar, ngrihet komision i posaçëm i përbërë nga të gjithë punonjësit e sektorit të autorizimit për tregtim dhe çështjeve rregullatore. Të gjitha kriteret e mëposhtme duhet të përmbushen me qëllim dhënien e autorizimit të kushtëzuar të tregtimit:

a) raporti përfitim-risk i barit është pozitiv;

b) aplikanti zotohet se do të dorëzojë të dhëna post-autorizim të barit;

c) bari synon të përdoret në situatë emergjente (pandemi, epidemi) si përgjigje ndaj kërcënimeve të shëndetit publik të njohura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ose nga Komuniteti Evropian.

ç)përfitimi për shëndetin publik si rezultat i disponueshmërisë së menjëhershme të barit është më i madh se rreziku i mundshëm që vjen si rezultat i mungesës së të dhënave shtesë për këtë.

6. Agjencia dhe Komisioni i Përhershëm i Barnave (KPB) konfirmojnë vlefshmërinë e aplikimit të paraqitur për barin, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, brenda 5 (pesë) ditëve pune, dhe lëshojnë autorizimin e kushtëzuar të tregtimit.

7. Agjencia jep autorizimin e kushtëzuar të tregtimit për barin përkatës.

8. Pas miratimit, Agjencia njofton zyrtarisht aplikantin për dhënien e autorizimit për tregtim për barin, si dhe për tarifën përkatëse, nëse është e aplikueshme.

9. Tarifa të paguhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit, nëse është e aplikueshme. Kur personi përgjegjës përfaqëson një institucion shtetëror, kjo tarifë nuk aplikohet.

10. Pas dhënies së autorizimit të kushtëzuar për tregtim, Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim duhet të përmbushë detyrimet e përcaktuara në udhëzimet përkatëse të EMA-s dhe/ose FDA-së.

11. Autorizimi i kushtëzuar i tregtimit mund të kthehet në një autorizim tregtimi standard, me vlefshmëri 5-vjeçare, me kërkesë të mbajtësit të autorizimit për tregtim, bazuar në vendimin përkatës nga Agjencia Evropiane e Vlerësimit të Barnave ose FDA-ja. Autorizimi i kushtëzuar i tregtimit është i rinovueshëm pas periudhës 1-vjeçare.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 97, datë 17.2.2021**

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 729, DATË 16.9.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE ‘QENDËR HISTORIKE’ TË FSHATIT KANINË, ZONËS MBROJTËSE TË SAJ, DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” e “ç”, 62, pika 3, dhe 96, pika 1, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 729, datë 16.9.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) harta dhe koordinatat zëvendësohen me hartën dhe koordinatat që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) në pikën 7, të nenit 5, të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, fjalët “... në aneksin 2 ...” zëvendësohen me “... në aneksin 2/1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKS 2/1
KOORDINATAT E ZONËS MBROJTËSE TË FSHATIT KANINË

| | X | Y |
|---|---|---|
| ZONA I/1 | | |
| 1 | 19°31'10.803"E | 40°26'34.303"N |
| 2 | 19°31'13.343"E | 40°26'33.881"N |
| 3 | 19°31'14.913"E | 40°26'32.619"N |
| 4 | 19°31'14.544"E | 40°26'30.847"N |
| 5 | 19°31'13.635"E | 40°26'28.825"N |
| 6 | 19°31'12.345" | 40°26'27.631"N |
| 7 | 19°31'10.983" | 40°26'21.446"N |
| 8 | 19°31'12.019" | 40°26'17.682" |
| 9 | 19°31'11.270" | 40°26'16.633" |
| 10 | 19°31'11.200" | 40°26'15.696" |
| 11 | 19°31'12.169" | 40°26'14.946" |
| 12 | 19°31'14.593" | 40°26'15.543" |
| 13 | 19°31'17.896" | 40°26'15.203" |
| 14 | 19°31'19.499" | 40°26'14.520" |
| 15 | 19°31'20.393" | 40°26'15.521" |
| 16 | 19°31'20.460" | 40°26'16.255" |
| 17 | 19°31'19.362" | 40°26'17.289" |
| 18 | 19°31'20.105" | 40°26'19.117" |
| 19 | 19°31'25.366" | 40°26'20.841" |
| 20 | 19°31'27.133" | 40°26'22.106" |
| 21 | 19°31'27.783" | 40°26'22.959" |
| 22 | 19°31'27.611" | 40°26'25.059" |
| 23 | 19°31'26.350" | 40°26'25.489" |
| K56 | 19°31'24.785" | 40°26'24.289" |
| K55 | 19°31'26.098" | 40°26'24.326" |
| K54 | 19°31'26.558" | 40°26'23.710" |
| K53 | 19°31'26.330" | 40°26'22.131" |
| K52 | 19°31'24.777" | 40°26'21.048" |
| K51 | 19°31'21.080" | 40°26'20.639" |
| K50 | 19°31'19.787" | 40°26'19.680" |
| K49 | 19°31'17.150" | 40°26'18.884" |
| K48 | 19°31'17.168" | 40°26'19.285" |
| K47 | 19°31'15.807" | 40°26'19.060" |
| K46 | 19°31'13.984" | 40°26'19.992" |
| K45 | 19°31'13.444" | 40°26'20.387" |
| K44 | 19°31'12.324" | 40°26'19.568" |
| K43 | 19°31'11.541" | 40°26'22.283" |
| K42 | 19°31'13.157" | 40°26'26.531" |
| K41 | 19°31'14.166" | 40°26'27.762" |
| K40 | 19°31'14.778" | 40°26'29.098" |
| K39 | 19°31'16.319" | 40°26'32.396" |
| K38 | 19°31'14.808" | 40°26'34.167" |
| K37 | 19°31'12.614" | 40°26'35.130" |
| K36 | 19°31'9.284" | 40°26'35.411" |

| | X | Y |
|---|---|---|
| ZONA I/2 | | |
| 27 | 19°31'20.859" | 40°26'30.452" |
| 28 | 19°31'22.338" | 40°26'31.522" |
| 29 | 19°31'23.359" | 40°26'34.434" |
| 30 | 19°31'24.860" | 40°26'34.485" |
| 31 | 19°31'27.401" | 40°26'32.766" |
| 32 | 19°31'29.003" | 40°26'33.933" |
| 33 | 19°31'29.220" | 40°26'35.465" |
| 34 | 19°31'29.990" | 40°26'36.494" |
| K7 | 19°31'31.312" | 40°26'37.074" |
| K6 | 19°31'27.167" | 40°26'37.291" |
| K5 | 19°31'25.884" | 40°26'37.933" |
| K4 | 19°31'23.328" | 40°26'37.563" |
| K3 | 19°31'22.712" | 40°26'36.450" |
| K2 | 19°31'20.902" | 40°26'36.126" |
| K1 | 19°31'18.996" | 40°26'36.142" |
| K71 | 19°31'19.264" | 40°26'34.317" |
| K70 | 19°31'20.452" | 40°26'32.205" |

| | X | Y |
|---|---|---|
| ZONA I/3 | | |
| 35 | 19°31'30.603" | 40°26'47.673" |
| 36 | 19°31'29.107" | 40°26'47.486" |
| 37 | 19°31'28.176" | 40°26'47.642" |
| 38 | 19°31'26.954" | 40°26'47.054" |
| 39 | 19°31'25.619" | 40°26'47.542" |
| 40 | 19°31'24.615" | 40°26'47.024" |
| 41 | 19°31'23.766" | 40°26'47.485" |
| 42 | 19°31'23.698" | 40°26'48.596" |
| 43 | 19°31'24.298" | 40°26'49.412" |
| 44 | 19°31'24.358" | 40°26'50.693" |
| 45 | 19°31'21.610" | 40°26'51.231" |
| 46 | 19°31'20.003" | 40°26'50.031" |
| 47 | 19°31'18.620" | 40°26'50.721" |
| 48 | 19°31'18.258" | 40°26'49.099" |
| 49 | 19°31'15.621" | 40°26'46.606" |
| 50 | 19°31'10.639" | 40°26'46.373" |
| K27 | 19°31'8.709" | 40°26'45.290" |
| K26 | 19°31'10.512" | 40°26'45.639" |
| K25 | 19°31'14.128" | 40°26'45.058" |
| K24 | 19°31'16.232" | 40°26'45.901" |
| K23 | 19°31'18.691" | 40°26'46.309" |
| K22 | 19°31'19.319" | 40°26'46.167" |
| K21 | 19°31'19.896" | 40°26'46.294" |
| K20 | 19°31'21.790" | 40°26'45.823" |
| K19 | 19°31'24.594" | 40°26'44.400" |
| K18 | 19°31'24.533" | 40°26'43.951" |
| K17 | 19°31'27.599" | 40°26'44.867" |
| K16 | 19°31'31.363" | 40°26'46.334" |
| K15 | 19°31'32.382" | 40°26'46.482" |

| | X | Y |
|---|---|---|
| ZONA II/1 | | |
| 1 | 19°31'10.803" | 40°26'34.303" |
| 2 | 19°31'13.343" | 40°26'33.881" |
| 3 | 19°31'14.913" | 40°26'32.619" |
| 4 | 19°31'14.544" | 40°26'30.847" |
| 5 | 19°31'13.635" | 40°26'28.825" |
| 6 | 19°31'12.345" | 40°26'27.631" |
| 7 | 19°31'10.983" | 40°26'21.446" |
| 8 | 19°31'12.019" | 40°26'17.682" |
| 9 | 19°31'11.270" | 40°26'16.633" |
| 10 | 19°31'11.200" | 40°26'15.696" |
| 11 | 19°31'12.169" | 40°26'14.946" |
| 12 | 19°31'14.593" | 40°26'15.543" |
| 60 | 19°31'10.814" | 40°26'13.121" |
| 59 | 19°31'9.495" | 40°26'14.372" |
| 58 | 19°31'10.172" | 40°26'17.926" |
| 57 | 19°31'9.328" | 40°26'20.214" |
| 56 | 19°31'8.065" | 40°26'22.672" |
| 55 | 19°31'6.831" | 40°26'24.485" |
| 54 | 19°31'6.095" | 40°26'27.556" |
| 53 | 19°31'7.457" | 40°26'30.204" |
| 52 | 19°31'8.776" | 40°26'31.056" |
| 51 | 19°31'10.637" | 40°26'32.855" |

| | X | Y |
|---|---|---|
| ZONA II/2 | | |
| 24 | 19°31'21.358" | 40°26'24.820" |
| 25 | 19°31'20.670" | 40°26'25.735" |
| 26 | 19°31'20.764" | 40°26'29.081" |
| 27 | 19°31'20.859" | 40°26'30.452" |
| K70 | 19°31'20.452" | 40°26'32.205" |
| K69 | 19°31'20.059" | 40°26'31.654" |
| K68 | 19°31'17.684" | 40°26'31.260" |
| K67 | 19°31'16.798" | 40°26'30.640" |
| K66 | 19°31'17.803" | 40°26'29.441" |
| K65 | 19°31'20.001" | 40°26'28.236" |
| K64 | 19°31'19.398" | 40°26'26.752" |
| K63 | 19°31'18.431" | 40°26'26.153" |
| K62 | 19°31'16.094" | 40°26'25.254" |
| K61 | 19°31'15.683" | 40°26'24.655" |
| K60 | 19°31'15.962" | 40°26'23.936" |
| K59 | 19°31'17.661" | 40°26'22.812" |
| K58 | 19°31'19.664" | 40°26'22.920" |
| K57 | 19°31'21.149" | 40°26'23.480" |
| K56 | 19°31'24.785" | 40°26'24.289" |



**VENDIM**
**Nr. 98, datë 17.2.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT, NË BASHKINË DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 55 098 000 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekësh pa TVSH, për financimin e sistemimit të territorit, lirimin e sheshit dhe kthimin e sipërfaqes në kuotë për ndërtimin e 44 (dyzet e katër) njësive individuale të banimit në Njësinë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 99, datë 17.2.2021**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES PËR PROGRAMIN DYPALËSH TË NDIHMËS E TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes për programin dypalësh të ndihmës e të bashkëpunimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**PROTOKOLL NDRYSHUES**
I MARRËVESHJES PËR PROGRAMIN DYPALËSH TË NDIHMËS E TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NËNSHKRUAR NË ATHINË, MË 20 DHJETOR 2001

Qeveria e Republikës së Greqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si "Donatori" dhe "Përfituesi", përkatësisht.

Referuar Marrëveshjes të marrëveshjes për programin dypalësh të ndihmës e të bashkëpunimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Greqisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Athinë, më 20.12.2001, në tekstin e mëposhtëm "Marrëveshja".

Duke marrë parasysh që dispozitat e Marrëveshjes janë ndryshuar në mënyrë integrale

që nga nënshkrimi i saj dhe nuk pasqyrojnë më situatën aktuale dhe vullnetin e Donatorit dhe Përfituesit,

Me synimin për të siguruar zbatimin efektiv të Marrëveshjes.

Kanë rënë dakord për ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes:

Neni 1

**Neni 2 i Marrëveshjes zëvendësohet si më poshtë:**

"Ndihma buxhetore e parashikuar në nenin 1 të Marrëveshjes do të përdoret për të financuar projektin e rindërtimit të një objekti shkollor dhe, në veçanti, ndërtesa nr. 23, me vendndodhje në Njësinë Administrative nr. 4, në Tiranë, pjesë e kantierit të ri të zhvillimit të "5 Maji", që përfshihet në PDyV, të miratuar nga Bashkia e Tiranës dhe Këshilli i Ministrave.

Neni 2

**Neni 3 i Marrëveshjes zëvendësohet si më poshtë:**

"Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Greqisë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin përcaktohen si Autoritetet Kompetente për zbatimin e Marrëveshjes."

Neni 3

**Neni 4 i Marrëveshjes bëhet si më poshtë:**

"Shuma totale e Grantit përkatës për projektin e sipërpërmendur prej 2,5 milionë euro depozitohet në llogarinë e përgjithshme të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në Bankën Qendrore të Shqipërisë IBAN AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E. Një deklaratë e kësaj llogarie sipas datës së nënshkrimit të këtij Protokolli është e bashkangjitur si shtojca A".

Neni 4

Përfituesi do të sigurojë që projektit të lartpërmendur t'i jepet publiciteti i duhur dhe do të informojë publikun e gjerë në lidhje me rolin e luajtur nga Donatori në lidhje me të, duke lëshuar të paktën një njoftim për shtyp në lidhje me dhurimin. Tabelat me informacion mbi dhurimin grek do të instalohen në vendet e ndërtimit dhe pllaka përkujtimore të përhershme dhe të dukshme në gjuhën shqipe, greke dhe angleze do të vendosen në shkollën e objektit të neni 1 të këtij protokolli. Teksti i vendosur në pllakat përkujtimore do të jetë si më poshtë: "Rindërtimi i kësaj shkolle u bë i mundur përmes një donacioni nga Qeveria e Republikës Greqisë".

Përfituesi është, gjithashtu, i detyruar të mbajë një regjistër fotografik të punimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Me tepër shikueshmëria mund të arrihet përmes konferencave për shtyp, gazetave, postimeve në faqet e internetit, prodhimeve audiovizive dhe/ose ekspozitave dhe veprimeve të ndërlidhura që do të ndërmerren nga Përfituesi para, gjatë dhe pas përfundimit të punimeve, sipas gjykimit të këtij të fundit.

Neni 5

Donatori rezervon të drejtën për të verifikuar informacionin e dhënë në raportet narrative dhe financiare dhe për të monitoruar zbatimin e projektit, duke konsultuar ekspertët e tij të jashtëm të monitorimit. Përfituesi do të lejojë organet dhe zyrtarët e Donatorit të inspektojnë regjistrat e kontabilitetit dhe kuponët dhe të vizitojnë ambientet lokale për të kontrolluar nëse Projekti po zbatohet siç duhet dhe se Granti po përdoret për qëllimin e duhur. Në raste të tilla, Donatori do t'i sigurojë Përfituesit një njoftim të arsyeshëm.

Neni 6

Donatori dhe Përfituesi bien dakord që Donatori të rezervojë të drejtën në çdo kohë për të vizituar vendet e lidhura me Projektin, për të kontrolluar zbatimin e tij, për të marrë informacion dhe për të konsultuar të gjithë dokumentacionin përkatës.

Neni 7

Ky protokoll mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Donatorit dhe Përfituesit, përkatësisht. Çdo ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 8 të këtij protokolli.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i Marrëveshjes do të zgjidhet me konsultime midis Donatorit dhe Përfituesit.

Neni 9

Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit me të cilin Donatori dhe Përfituesi informojnë njëri-tjetrin me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të kërkuara për hyrjen në fuqi të tij.

Me hyrjen në fuqi, ky protokoll do të përbëjë një pjesë integrale të Marrëveshjes.

Bërë në Tiranë, më 26.1.2021, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën angleze, të dyja tekstet janë njësoj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Arben Ahmetaj**
MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIM

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË GREQISË
**Sophia Philippidou**
AMBASADOR I REPUBLIKËS SË GREQISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**VENDIM**
**Nr. 100, datë 17.2.2021**

## PËR PËRCAKTIMIN E MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SI AUTORITET KONTRAKTOR PËR ZHVILLIMIN E MUNDSHËM TË PROCEDURËS SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËR PORTIN NË TRIPORT, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/ partneritetit publik privat, për portin në Triport, Vlorë.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**URDHËR**
**Nr. 7, datë 17.2.2021**

## MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT PUBLIK PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si rezultat i mungesës së kapaciteteve në institucionet e varësisë për realizimin me sukses të procedurave,

UDHËZOJ:

1. Realizimin e procedurave, ku impakti i tyre është me një risk të lartë, me vlerë mbi 800,000 (tetë qind mijë) lekë pa TVSH, në mënyrë të përqendruar, për autoritetin kontraktor, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural merr përsipër rolin e Organit Qendror Blerës për zhvillimin e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë

procedurave të prokurimit, sipas pikës 1 të këtij udhëzim, që nga njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të nënshkrimit të kontratës në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dërgon pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, dokumentacionin e plotë, në formë të shkruar, për të vijuar me nënshkrimin e kontratës përkatëse.

5. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e kontratës.

6. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të dërgojë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, jo më vonë se data 1.3.2021, dokumentacionin e plotë (në formë shkresore dhe elektronike), termat e referencës, specifikimet teknike, fondin limit, si dhe afatet e realizimit të kontratave.

7. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë do të jetë përfituesi i mallrave/shërbimeve objekt prokurimi.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Milva Ekonomi**

**VENDIM**
**Nr. 47, datë 11.2.2021**

**PËR MIRATIMIN E "UDHËZUESI 'PËR MBAJTJEN DHE PLOTËSIMIN E TABELAVE ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR EFEKT TË MATJES DHE MONITORIMIT TË PRODUKTIVITETIT DHE EFICIENCËS SË GJYKATAVE'"**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, nenin 61, pika 2, 89 shkronja "b" dhe 94 pika 4 shkronja "dh" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

Miratimin e "Udhëzuesi 'Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave'", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETAR
**Maksim Qoku**

**UDHËZUES**
PËR MBAJTJEN DHE PLOTËSIMIN E TABELAVE ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR EFEKT TË MATJES DHE MONITORIMIT TË PRODUKTIVITETIT DHE EFICIENCËS SË GJYKATAVE

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE
I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME
SEKSIONI I – UDHËZIME PËR GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TABELA 1 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 2 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJE
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 3 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + PENALE)
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA NR.4 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE
A. Treguesit
TABELA 5 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË VENDIMIT
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit

SEKSIONI II - UDHËZIME PËR GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
TABELA 1 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA NR. 2 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE
A. Treguesit
TABELA 3 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
SEKSIONI III - UDHËZIME PËR GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
TABELA 1 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 2 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË TOTAL
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA NR. 3 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE
A. Treguesit
TABELA 4 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 1 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 2 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 3 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + PENALE)
A. Treguesit
TABELA NR. 4 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE
Treguesit
TABELAT 5, 6, 7 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË APEL TË ARDHURA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË
A. Gjykatat
B. Treguesit
TABELA 8 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
SEKSIONI V - UDHËZIME PËR GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT
TABELA 1 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA NR. 2 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE
A. Treguesit
TABELA 3 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT TË ARDHURA NGA GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARE
A. Gjykatat
B. Treguesit
TABELA 4 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË VENDIMIT
A. Lloji i çështjeve
B. Treguesit
SEKSIONI VI - UDHËZIME PËR GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
TABELA 1 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA 2 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË TOTAL
A. Llojet e çështjeve
B. Treguesit
TABELA NR. 3 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

A. Treguesit

TABELA 4 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT

A. Llojet e çështjeve

B. Treguesit

SEKSIONI VII - UDHËZIME PËR GJYKATËN E LARTË

TABELA 1 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

A. Llojet e çështjeve

B. Treguesit

TABELA 2 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE

A. Llojet e çështjeve

B. Treguesit

TABELA 3 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

A. Llojet e çështjeve

B. Treguesit

TABELA 4 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + ADMINISTRATIVE + PENALE)

A. Llojet e çështjeve

B. Treguesit

TABELA NR. 5 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

A. Treguesit

TABELAT 6, 7, 8 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE, ADMINISTRATIVE DHE PENALE NË GJYKATËN E LARTË TË ARDHURA NGA GJYKATAT E APELIT

A. Gjykatat

B. Treguesit

TABELA 9 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT

A. Lloji i çështjeve

B. Treguesit

HYRJE

- Ky udhëzues është përgatitur në përputhje me ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenet 89, shkronja "b" dhe 94, pika 4, shkronja "dh", që kërkon hartimin e një udhëzuesi për mbajtjen e statistikave gjyqësore si pjesë e "Rregullave standarde për eficiencën e drejtësisë".

- Udhëzuesi ka për qëllim të vendosë rregulla standarde për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave me qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e aktivitetit statistikor të gjykatave duke synuar rritjen e performancës dhe të eficiencës së gjykatave. Në këtë kuadër, statistikat gjyqësore kanë për qëllim të shërbejnë si burime të dhënash dhe informacioni që mund të përdoren për menaxhimin eficient, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në aktivitetin e gjykatës.

- Udhëzuesi ofron një tërësi rregullash për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore nëpërmjet tabelave standarde të unifikuara për të gjitha gjykatat. Përveç kësaj, udhëzimi përkufizon termat e përdorur në tabelat e standardizuara, për të garantuar raportim të krahasueshëm mes gjykatave të ndryshme.

- Tabelat standarde janë hartuar duke iu referuar llojit të gjykatës sipas kompetencës lëndore dhe sipas shkallës. Pushteti gjyqësor në Shqipëri ushtrohet përmes: gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit dhe Gjykatës së Lartë (neni 135 i Kushtetutës). Përveç kësaj, juridiksioni i specializuar ushtrohet përmes: gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të apelit; gjykatave të posaçme të shkallës së parë dhe të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar (neni 135/2 i Kushtetutës). Gjykata e Lartë gjykon çështje të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe të specializuar.

- Për secilën gjykatë, tabelat standarde kanë për qëllim mbledhjen e të dhënave për numrin e çështjeve sipas kategorisë së çështjeve, kohëzgjatjes së çështjeve të mbyllura, treguesve të performancës, seancave gjyqësore, statistika për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve, si dhe për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit.

- Udhëzuesi përmban tabela për gjykatat e shkallës së parë, konkretisht për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, gjykatat administrative dhe gjykatën e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar (ish-gjykata e krimeve të

rënda); gjykatat e shkallës së dytë, konkretisht gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, gjykatën administrative të apelit, gjykatën e posaçme të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar (ish-gjykata e apelit për krime të rënda) si dhe për Gjykatën e Lartë.

- Udhëzuesi përbëhet nga shtatë seksione - seksioni 1 përmban disa tabela për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm; seksioni 2 përmban disa tabela për gjykatat administrative të shkallës së parë; seksioni 3 përmban disa tabela për gjykatën e posaçme të shkallës së parë për krimin e organizuar dhe korrupsionin; seksioni 4 përmban disa tabela për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm; seksioni 5 përmban disa tabela për gjykatën administrative të apelit; seksioni 6 përmban disa tabela për gjykatën e posaçme të apelit për krimin e organizuar dhe korrupsionin; seksioni 7: tabela për Gjykatën e Lartë.

- Kategorizimi i çështjeve për qëllime të këtij udhëzimi i referohet kategorive universale të çështjeve (civile, penale, administrative), nënkategorive të përgjithshme dhe llojeve të përzgjedhura të çështjeve. Të gjitha kategoritë e çështjeve, nënkategoritë, llojet e çështjeve dhe treguesit e tyre, përkufizohen sipas mënyrës së përshkrimit në këtë udhëzues, pavarësisht nga përkufizimet e tjera të miratuara për qëllime të tjera raportimi statistikor (si p.sh. për vlerësimin profesional të gjyqtarëve ose për raportimin në organizatat ndërkombëtare).

- Të dhënat statistikore pjesë e tabelave standarde, synojnë të japin informacion gjithëpërfshirës për matjen e treguesve të produktivitetit dhe eficiencës, të tillë si:

- Ngarkesën e punës në secilën gjykatë;
- Gjendjen e *backlog*-ut në gjykatë;
- Prurjet e çështjeve të reja në gjykatë;
- Ngarkesën mesatare të gjyqtarëve (Treguesi ËR);
- Normën e eficiencës (Treguesi ER);
- Raportin e qarkullimit të çështjeve (Treguesi RQC);
- Kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes (Treguesi DT);
- Normën e zgjidhjes së çështjes (Treguesi CR);
- Vjetërsinë (moshën) e çështjes... etj.

I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

**- Sekretaritë gjyqësore** në çdo gjykatë ndihmojnë me mirëmbajtjen e regjistrave dhe regjistrimeve të sakta në regjistra, si dhe në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim, përfshirë saktësinë e të dhënave (neni 44 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë").

**- Kancelari, pas konsultimit me kryetarin e Gjykatës,** mban përgjegjësi, mes të tjerave, edhe për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CMS) në gjykatë. Kancelari mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e saktë të të dhënave si dhe orienton dhe mbikëqyr punën e nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës që përfshihen në regjistrimin e të dhënave dhe në përpilimin e statistikave. Kancelari dërgon raporte periodike në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) për përdorimin dhe funksionimin e CMS, si dhe raporton pa vonesë mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të CMS (neni 39 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë").

- Deri në prodhimin në mënyrë elektronike të të gjitha statistikave të nevojshme, me qëllim lehtësimin e procesit të raportimit dhe të llogaritjes së treguesve relevantë, rekomandohet që të dhënat për çdo çështje të regjistruar në gjykatë gjatë periudhës së raportimit, të regjistrohen në tabela në Excel, një për çdo lloj të përgjithshëm çështjesh (krime, kundërvajtje penale, çështje penale administrative, çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare, çështje administrative të përgjithshme me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare etj.). Ato duhet të përmbajnë të paktën këto informacione: (i) numrin e çështjeve në regjistër, (ii) datën e regjistrimit, (iii) objektin, (iv) numrin e vendimit, (v) datën e vendimit, (vi) datën e zbardhjes së vendimit të arsyetuar, (vii) mënyrën e disponimit të gjykatës.

- Ky udhëzim përmban tabelat standarde dhe shpjegimin për secilën prej tyre. Tabelat standarde mbahen dhe plotësohen vetëm në formën e tabelave në Excel. Në mënyrë më të përgjithshme, deri në funksionimin efikas të CMS-së, për transmetimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, duhet të përdoren tabelat Excel dhe jo ato në formatin Word. Kjo sepse çdo tabelë, veç të dhënës statistikore që duhet të plotësohen,

përmban të integruar në të, formula për përllogaritjen automatike të treguesve të performancës dhe eficiencës.

- Tabelat standarde përbëhen nga kolona me tekst të zi dhe të gjelbër. Kolonat në ngjyrë të zezë përmbajnë të dhënat kryesore, të cilat duhet të plotësohen nga nëpunësit civilë gjyqësorë përkatës të përfshirë në proces. Në rastet kur dihen shifrat relevante, duhet të raportohen vetëm shifrat, pa tekst, pikësime apo hapësira. Në rastet kur shifrat relevante nuk dihen, duhet të shënohet ND (nuk dihet). Shifrat e vendosura duhet të verifikohen (p.sh. numrin e zerove). Kolonat e gjelbra përmbajnë formula, të cilat llogarisin në mënyrë automatike vlerat relevante në momentin që në tabelë futen vlerat kryesore (në kolonat e zeza). Nuk duhet të futet asnjë vlerë në këto kolona.

- Për gjykatat e çdo niveli dhe juridiksioni, tabelat standarde duhet të plotësohen çdo vit dhe të publikohen në faqen zyrtare të gjykatës brenda dy javësh pas përfundimit të çdo periudhe raportuese. Statistikat vjetore duhet t'i dërgohen elektronikisht Sektorit të Statistikave dhe Arkivit Gjyqësor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve në KLGJ.

- Në muajin shkurt të çdo viti, kryetari i gjykatës mbledh dhe kryeson Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve të gjykatës, ku diskutohet raporti vjetor i gjykatës për vitin e mëparshëm. Ky raport përmban prezantimin e të dhënave statistikore për të gjithë vitin në tabela (sipas formatit të tabelave standarde) dhe grafikët, si dhe një analizë të shkurtër të tyre. Kryetari informon KLGJ-në për datën dhe agjendën e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve të gjykatës, të paktën dy javë më parë (neni 29 dhe 40 i ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"). Ky raport miratohet dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të çdo gjykate brenda muajit mars.

- Tabelat standarde të plotësuara për vitin e mëparshëm kalendarik i dërgohen elektronikisht Sektorit të Statistikave dhe Arkivit Gjyqësor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve në KLGJ, sa më shpejt që të jetë e mundur, por sidoqoftë jo më vonë se data 10 mars e vitit pasardhës.

- KLGJ-ja analizon në nivel kombëtar të dhënat statistikore të raportuara nga secila gjykatë. Këto statistika përbëjnë pjesë të raportit vjetor të KLGJ-së, i cili paraqitet në Kuvend jo më vonë se data 1 maj (neni 82 i ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë").

SEKSIONI I – UDHËZIME PËR GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (gjykatat e rretheve gjyqësore), janë hartuar 5 tabela standarde, si më poshtë:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjes;

- Tabela nr. 2 - Statistikat për çështjet penale sipas llojit të çështjes;

- Tabela nr. 3 - Statistikat për çështjet e gjykatës (gjithsej civile + penale);

- Tabela nr. 4 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve;

- Tabela nr. 5 - Statistikat për vjetërsinë e çështjeve në pritje të gjykimit.

TABELA 1 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

- Gjykatat e rrethit janë kompetente për gjykimin e çështjeve civile që ndahen përgjithësisht në dy kategori kryesore: **"Çështje civile me palë kundërshtare"** (rreshti A) dhe "Çështje civile pa palë kundërshtare" (rreshti B). Këto dy kategori kryesore ndahen më tej në disa nënkategori.

**- Rreshti A:** kategoria "Çështje civile me palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë A.1 (civile të përgjithshme me palë kundërshtare), A.2 (familjare me palë kundërshtare), A.3 (tegtare me palë kundërshtare) dhe A.4 (çështje për marrëdhëniet e punësimit)

**- Rreshti A.1:** në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare" përfshin çështjet civile të cilat iniciohen në gjykatë me kërkesëpadi, duke përjashtuar çështjet që përfshihen në kategoritë "Familjare me palë kundërshtare" (rreshti A.2), "Tregtare me palë kundërshtare" (rreshti A.3) dhe "Marrëdhënie pune" (rreshti A.4).

**- Rreshti A.2:** në kategorinë e "Çështjeve civile me palë kundërshtare" nënkategoria "Çështje familjare me palë kundërshtare" përfshin, por pa u kufizuar, çështjet si më poshtë:

- Padi për pavlefshmërinë e martesës (neni 43 i Kodit të Familjes);

- Padi për zgjidhjen e martesës (neni 129 e vijues i K. Familjes);

Padi për njohjen ose kundërshtimin e amësisë ose atësisë (nenet 177,178,179, 181,183,184,185,186,187,188 të Kodit të Familjes);

- Padia për kërkimin e detyrimit për ushqim ndërmjet bashkëshortëve (neni 199 i K. Familjes);

- Padia për përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim ndaj fëmijës;

- Padia për heqjen/kthimin e përgjegjësisë prindërore, përcaktimin e përgjegjësisë prindërore të fëmijës së lindur jashtë martese (neni 227,228 i K. Familjes).

- Padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrit të mbrojtjes.

- Çështje të tjera.

**- Rreshti A.2.1:** në kategorinë e "çështjeve familjare me palë kundërshtare", të dhënat për **"Zgjidhje martese"** duhet të raportohen më vete. Këtu futen çështjet e parashikuara nga Kodi i Familjes, por pa u kufizuar, si më poshtë:

- Zgjidhja e martesës në bazë të neneve 129-131 të Kodit të Familjes.

- Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërës palë, nenet 132-140 të Kodit të Familjes.

- Çështje të tjera.

**Rreshti A.3:** në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategoria **"Çështje tregtare me palë kundërshtare"**, përfshin, por pa u kufizuar, sa më poshtë:

- Anulimin e pretendimeve të kompanisë, neni 3/1 i ligjit nr. 9901, datë. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- Dëmshpërblimi i dëmeve të administratorëve, neni 98 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- Pretendimet për dividendët, neni 129 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- Përgjegjësitë e Organeve Mbikëqyrëse, neni 151 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- Kompetencat e administratorëve, neni 95 dhe 98 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- Shkrirja e kompanive sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

- Çështjet sipas ligjit për Falimentin 110/2016;

- Zhvlerësimi i çeqeve, faturave të shkëmbimit dhe letrave të tjera me vlerë sipas neneve 337-346 të Kodit të Procedurës Civile;

- Çështje të tjera.

**- Rreshti A.4**: Në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategorinë "Marrëdhënie pune", përfshihen të dhënat për konfliktet gjyqësore që burojnë nga marrëdhëniet e punës, të tilla si:

- Paditë për shpërblimin e dëmit që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës;

- Padi për pavlefshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës;

- Padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësi gjatë marrëdhënies së punës;

- Çështje të tjera.

**Rreshti B:** Kategoria "Çështje civile pa palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë B.1 (Çështje të përgjithshme pa palë kundërshtare), B.2 (Çështje familjare pa palë kundërshtare) dhe B.3 (Çështje tregtare pa palë kundërshtare).

**- Rreshti B.1:** Në kategorinë e "Çështje civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje të përgjithshme civile pa palë kundërshtare" përfshihen, por pa u kufizuar, sa më poshtë:

Kërkesa për sigurimin e padisë, kur ajo paraqitet si kërkesë e veçantë para ngritjes së padisë (neni 202 dhe 204 i K.Pr.C.);

- Kërkesa për sigurimin e provës e paraqitur para ngritjes së padisë (neni 293 i K.Pr.C.);

- Kërkesa për ndreqjen e gabimeve, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit (nenet 312,313,314 të K.Pr.C.);

- Kërkesa për shpalljen e zhdukjes ose vdekjes së një personi (neni 375 i K.Pr.C.) dhe kërkesa për ndryshimin ose prishjen e vendimit që ka vendosur shpalljen e zhdukjes ose vdekjes së personit (neni 379);

- Kërkesa për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe kërkesa për kthimin e zotësisë (neni 382 – 387 i K.Pr.C.);

- Kërkesa për vërtetimin gjyqësor të fakteve juridike (neni 388 e vijues i K.Pr.C.);

- Kërkesa për ndihmë juridike në fushën civile;

- Kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit (neni 511 i K.Pr.C.),

- Kërkesa të tjera.

**Rreshti B.2:** Në kategorinë "Çështje civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje familjare

pa palë kundërshtare" përfshin, por pa u kufizuar, sa vijon:

- Kërkesa për adoptimi, nenet 240-262 të Kodit të Familjes;
- Zgjidhja e martesës me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, nenet 125-128 të Kodit të Familjes;
- Kërkesa për dhënien e autorizimit për administrimin e pasurisë së të miturit (neni 234 e vijues i Kodit të Familjes);
- Kërkesa të tjera.

**- Rreshti B.3:** Në kategorinë e "Çështjeve civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje tregtare pa palë kundërshtare" përfshin, por pa u kufizuar, sa më poshtë:

- Falimenti sipas ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 "Për falimentimin";
- Regjistrimi i OJF-ve sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesë për emërimin e një administratori;
- Kërkesë për riemërtimin e shoqërive;
- Kërkesë për ndryshimin e numrit të ortakëve sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesë për ndryshimin e kapitalit bazë sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesë për ndryshimin e selisë së shoqërisë sipas ligjit nr. 8789, datë7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesa të tjera.

**- Rreshti B.3.1**: Në kategorinë e "Çështjeve civile pa palë kundërshtare" dhe në nënkategorinë "Çështje tregtare pa palë kundërshtare", të dhënat për "Falimentin" duhet të raportohen më vete. Këtu përfshihen çështjet për fillimin e procedurës së falimentit sipas ligjit nr. 110/2016 "Për falimentin", neni 13 e vijues.

**- Rreshti C:** "Çështje civile gjithsej" është shuma e shifrave të shënuara në kolonat A dhe B, e cila llogaritet automatikisht në tabelën Excel dhe përfshin numrin total të çështjeve civile me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

**- Kolona 1:** në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fillim të periudhës duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

**- Kolona 2:** çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë, ashtu edhe çështjet e kthyera për rigjykim pas prishjes së vendimit në nga gjykata më e lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

**- Kolona 3:** çështje të gjykuara (mbyllura) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, kthim aktesh, deklarim moskompetence etj.). Numri total i çështjeve të gjykuara duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4 dhe 6.

**- Kolona 4:** numri i çështjeve të mbyllura me vendim për themelin e çështjes tregon numrin e çështjeve të përfunduara pas shqyrtimit të plotë të çështjes, me vendim pranimi ose rrëzimi të padisë.

**- Kolona 5:** përqindja e çështjeve të mbyllura me vendim në themel tregon raportin e çështjeve të përfunduara me vendim themeli dhe totalit të çështjeve të mbyllura.

**- Kolona 6:** numri i çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi tregon numrin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi në themel (si p.sh. me pushim, deklarim moskompetence, kthim aktesh etj.).

**- Kolona 7:** përqindja e çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi tregon raportin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi i themelit krahasuar me totalin e çështjeve të mbyllura.

**- Kolona 8:** në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. Në pritje të gjykimit në fund të periudhës është diferenca mes shifrës në kolonën 9 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

**- Kolona 9:** çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Total i çështjeve të regjistruara është shuma e shifrave në kolonën 1

dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

**- Kolonat 10, 12, 14 dhe 16:** numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 11, 13, 15, 17: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standarde në Excel, si pjesë e totalit të çështjeve të mbyllura në kolonën 3.

**- Kolonat 18, 19, 20:** kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

**- Kolona 21:** norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

**- Kolona 22:** Koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

**- Kolona 23:** Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

**- Kolona 24:** Përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 23) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 8). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

**- Kolona 25:** Numri i seancave përfshin seancat gjyqësore të mbajtura në prani të palëve, duke përjashtuar seancat përgatitore dhe të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

**- Kolona 26:** Numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i numrit të seancave në kolonën 25 me numrin total të çështjeve të mbyllura në Kolonën 3.

TABELA 2 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

Gjykatat e rretheve janë kompetente për gjykimin e çështjeve penale,me përjashtim të atyre që bëjnë pjesë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Të dhënat për çështjet penale raportohen në katër kategori kryesore çështjesh, krime (rreshti A), kundërvajtje penale (rreshti B), çështje penale administrative (rreshti C) dhe çështje të ligjit antimafia (rreshti D), në përputhje me nenet e Kodit Penal dhe me ligje të tjera që parashikojnë veprat penale që përbëjnë krime ose kundërvajtje penale si dhe në përputhje me kategorinë e çështjes, si penale themeli apo çështje penale administrative.

**- Rreshti A:** kategoria "Krime" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë krime sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale krime janë veçuar disa grup veprash penale krime sipas objektit ose subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin A, nuk përbën shumën e nënkategorive A1, A2, A3 dhe A4, por numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë krime.

- Rreshti A.1: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Vrasje me dashje" përfshin çështjet për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83 të Kodit Penal.

- Rreshti A.2: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Vjedhje" përfshin çështjet për veprat penale të parashikuara nga nenet 139, 140, 141 të Kodit Penal.

- Rreshti A.3: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Dhuna në familje" përfshin çështjet sipas nenit 130/a të Kodit Penal.

- Rreshti A.4: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krime të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë krime të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

- Rreshti B: kategoria "Kundërvajtje penale" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë kundërvajtje penale sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale kundërvajtje janë veçuar një grup veprash penale kundërvajtje, sipas subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin B përbën numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë kundërvajtje penale.

- Rreshti B.1: në kategorinë "Kundërvajtje penale", nënkategoria "Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë kundërvajtje penale të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

- Rreshti C: kategoria "Çështje penale administrative" përfshin tërësinë e çështjeve penale administrative, të ndryshme nga çështjet penale të themelit. Në këtë kategori bëjnë pjesë kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak, çështjet penale të seancës paraprake dhe kërkesat penale të fazës së ekzekutimit.

- Në nënkategoritë e çështjeve penale administrative janë veçuar tri nënkategori sipas fazës së procedimit ose objektit të çështjes, përkatësisht: masa sigurimi (C.1), lirim me kusht (C.2) dhe ekstradime (C.3). Numri i çështjeve në rreshtin C, nuk përbën shumën e nënkategorive C.1, C.2 dhe C.3, por numrin total të çështjeve penale administrative, të cilat janë të gjitha çështjet e tjera penale, të ndryshme nga ato të themelit për krime (kategoria A) dhe kundërvajtje penale (kategoria B).

- Rreshti C.1: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Masa sigurimi" përfshin kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak për caktimin, zëvendësimin, revokimin dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ose pasuror.

- Rreshti C.2: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Lirim me kusht" përfshin kërkesat me objekt lirimin para kohe me kusht sipas parashikimeve të neneve 63 dhe 64 të Kodit Penal.

- Rreshti C.3: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Ekstradime" përfshin kërkesat me objekt ekstradimin e personave sipas parashikimeve të nenit 497 e vijues dhe 501 të Kodit të Procedurës Penale.

- Rreshti D: në kategorinë "Çështje të ligjit antimafia" përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (ligji antimafia).

- Rreshti E: "Çështje penale gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtat A, B, C dhe D, që përbën totalin e çështjeve penale dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

i) Administrimi i çështjeve

Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë, ashtu edhe çështjet e kthyera pas prishjes së vendimit në gjykatën më të lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, kthim aktesh, deklarim moskompetence etj.). Numri total i *çështjeve të gjykuara* duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4 dhe 6.

- Kolona 4: numri i çështjeve të mbyllura me vendim në themel tregon numrin e çështjeve të përfunduara pas shqyrtimit të plotë të çështjes, me vendim pafajësie ose dënimi. Në këtë kategori do të

përfshihen edhe çështjet e përfunduara me vendim për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë (neni 406/e i Kodit të Procedurës Penale) dhe çështjet e përfunduara me miratimin urdhrit penal (neni 406/b i KPP-së), pranimin ose rrëzimin kërkesave në çështjet penale administrative të fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake ose fazës së ekzekutimit.

- Kolona 5: përqindja e çështjeve të mbyllura me vendim në themel tregon raportin e çështjeve të përfunduara me vendim themeli dhe totalit të çështjeve të mbyllura.

- Kolona 6: numri i çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi tregon numrin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi për themelin e çështjes raportuar në kolonën 4 (si p.sh., me deklarimin e moskompetencës lëndore ose tokësore, refuzimi i marrëveshjes (neni 406/ë i KPP-së), refuzimi i miratimit të urdhrit penal (neni 406/c i KPP-së), mospranimi ose kthimin për hetime të çështjeve penale administrative të fazës së seancës paraprake ose fazës së ekzekutimit etj.).

- Kolona 7: përqindja e çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi tregon raportin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi i themelit krahasuar me totalin e çështjeve të mbyllura.

- Kolona 8: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 9 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 9: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 10, 12, 14 dhe 16: numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 11, 13, 15, 17: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standarde në Excel, si pjesë e *Totalit të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolonat 18, 19, 20: kohëzgjatja mesatare e çështjeve (në ditë) korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 21: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 22: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 23: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 24: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë më të vjetra se 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 23) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 8). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

Kolona 25: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat e mbajtura në prani të palëve, duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

Kolona 26: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në

kolonën 25 me *numrin total të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 3 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + PENALE)

Tabela nr. 3 është një tabelë përmbledhëse duke përfshirë të dhënat për *administrimin e çështjeve*, *treguesit e eficiencës* dhe *seancat gjyqësore* për të gjitha çështjet e trajtuara nga gjykata.

*a) Llojet e çështjeve*

- Në këtë tabelë, totali i çështjeve gjyqësore përfshin "Çështjet civile" (rreshti A), "Çështjet penale" (rreshti B), dhe çështjet gjithsej (rreshti C).
- Rreshti A: kategoria "Çështje civile" përfshin shumën e çështjeve civile me dhe pa palë kundërshtare nga tabela nr. 1.
- Rreshti B: kategoria "Çështjet penale" përfshin shumën e çështjeve penale (krime, kundërvajtje, çështje penale administrative dhe çështje të ligjit antimafia) nga tabela nr. 2.
- Rreshti C: "Gjithsej"., është shuma e shifrave të vendosura në A dhe B dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B) Treguesit*

i) Administrimi i çështjeve

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit, të pa përfunduara, në fund të periudhës paraardhëse.
- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.
- Kolona 3: Çështje të gjykuara gjithsej tregon numrin e çështjeve të përfunduara brenda periudhës së raportimit.
- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.
- Kolona 5: të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. *Totali i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave të vendosura në kolonat 1 dhe 2. Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Treguesit e eficiencës.*

- Kolona 6: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.
- Kolona 7: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.
- Kolona 8: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 7) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iii) Seancat gjyqësore*

- Kolona 9: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat gjyqësore të mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar seancat përgatitore dhe të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.
- Kolona 10: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave për çështje, sipas kategorisë së çështjes (çështje civile dhe çështje penale). Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *Numrit të seancave* në kolonën 9 me *numrin total të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA NR. 4 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

Tabela nr. 4 paraqet të dhëna për ngarkesën mesatare të çështjeve dhe produktivitetin e gjyqtarëve llogaritur për volumin total të çështjeve në gjykatë (d.m.th. shuma e çështjeve civile dhe çështjeve penale).

*A. Treguesit*

Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE/*full time equivalent*), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë, të tilla si: pezullimet, delegimet,

daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. *Për shembull*, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për gjashtë muaj gjatë vitit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

Kolona 2: numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 3) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve të gjykuara për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të mbyllura për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të mbyllura gjatë periudhës së raportimit (kolona 3 në tabelën 3) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 4: numri total i çështjeve për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit ose ngarkesën mesatare të gjyqtarit brenda kësaj periudhe. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (kolona 5 në tabelën 3) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: numri total i çështjeve të mbartura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të papërfunduara për gjyqtar në gjykatë në fund të periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të pa përfunduara në fund të periudhës së raportimit (kolona 4 në tabelën 3) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 5 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË VENDIMIT

Tabela nr. 5 tregon sasinë e çështjeve civile (me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare) dhe çështjeve penale (krime, kundërvajtje penale, çështje penale administrative dhe çështje të ligjit antimafia) në pritje të gjykimit ose të papërfunduara në fund të periudhës së raportimit, të grupuara sipas afateve të vendosura.

*A) Llojet e çështjeve*

- Përkufizimet e llojeve të çështjeve janë të njëjta me ato në tabelat nr. 1 dhe 2 të këtij seksioni.

- Rreshti C: "Civile gjithsej" është shuma e shifrave të vendosura në A dhe B dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Rreshti D: "Çështje penale" është shuma e shifrave të vendosura në D1,D2, D3 dhe D4 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Rreshti E: "Gjithsej" është shuma e shifrave të vendosura në C dhe D dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B) Treguesit*

Kolona 1: tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit, pra numrin e çështjeve të papërfunduara.

Kolonat 2, 3, 4, 5, 6, 7 përmbajnë numrin e çështjeve në pritje të vendimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës. Mosha e çështjeve në pritje të vendimit tregon periudhën kohore nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit. Mosha e çështjeve duhet të raportohet në kolonat përkatëse: deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vite (361-720 ditë); 2-3 vjet (721-1080 ditë); 3-5 vjet (1081-1800 ditë) dhe më shumë se 5 vjet (më shumë se 1800 ditë).

Kolonat 8, 9, 10, 11, 12, 13: përqindja e çështjeve në pritje të vendimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës është raporti i numrit të çështjeve në pritje të vendimit sipas moshës me numrin total të çështjeve në pritje të vendimit në periudhën e raportimit (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

SEKSIONI II - UDHËZIME PËR GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Për gjykatat administrative të shkallës së parë, janë hartuar 3 tabela standarde, si vijon:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet administrative sipas llojit të çështjes
- Tabela nr. 2 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve
- Tabela nr. 3 - Statistikat për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit

TABELA 1 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE

*A) Llojet e çështjeve*

- Gjykatat administrative janë gjykata me juridiksion të specializuar. Çështjet administrative ndahen në dy kategori të mëdha: "Çështje administrative me palë kundërshtare" (rreshti A) dhe "Çështje administrative pa palë kundërshtare" (rreshti B).

- Rreshti A: kategoria "Çështje administrative me palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë A.1 (administrative të përgjithshme) dhe A.2 (marrëdhënie pune).

- Rreshti A.1: në kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare", nënkategoria "Administrative të përgjithshme" përfshin paditë e parashikuara nga neni 7 dhe 17 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, dhe ligje të tjera, përveç padive që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në kompetencë të kësaj gjykate, pa u kufizuar si më poshtë:

- Mosmarrëveshjet nga aktet administrative, aktet nënligjore dhe kontratat administrative publike, neni 7/a i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Ndërhyrje e paligjshme ose mosveprim nga organi publik, neni 7/b i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Mosmarrëveshjet e kompetencave midis organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 7/c i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Çështje të tjera.

- Rreshti A.2: në kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare", nënkategoria "Marrëdhënie pune" përfshihen pa u kufizuar këto çështje:

- Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe punonjësve shtetërorë, marrëdhëniet e të cilëve/ rregullohen me akte të posaçme, të cilat janë në kompetencën lëndore të gjykatës administrative sipas nenit 7/ç të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

- Rreshti B: kategoria e "Çështjeve administrative pa palë kundërshtare", përbëhet pa u kufizuar, si më poshtë:

- Kërkesat me natyrë administrative të parashikuara nga neni 7 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe kërkesa të tjera të parashikuara nga ky ligj ose ligje të tjera;

- Kërkesat e paraqitura nga shkelësit për zëvendësimin e dënimit administrativ, neni 7/dh i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Kërkesa për ndreqjen e gabimeve, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit;

- Kërkesa për sigurimin e padisë, kur ajo paraqitet para ngritjes së padisë sipas nenit 28 pika 2 të ligjit nr. 49/2012;

- Kërkesa të tjera.

- Rreshti C: "Çështje administrative gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtin A dhe B dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B) Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë, ashtu edhe çështjet e kthyera për rigjykim pas prishjes së vendimit nga

gjykata më e lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

- Kolona 3: çështje të gjykuara gjithsej (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, kthim aktesh, deklarim moskompetence etj.). Numri total i *çështjeve të gjykuara gjithsej* duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4 dhe 6.

- Kolona 4: numri i çështjeve të mbyllura me vendim për themelin e çështjes tregon numrin e çështjeve të përfunduara pas shqyrtimit të plotë të çështjes, me vendim pranimi ose rrëzimi të padisë.

- Kolona 5: përqindja e çështjeve të mbyllura me vendim në themel tregon raportin e çështjeve të përfunduara me vendim themeli dhe totalit të çështjeve të mbyllura.

- Kolona 6: numri i çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi tregon numrin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi në themel (si p.sh. me pushim, deklarim moskompetence, kthim aktesh).

- Kolona 7: përqindja e çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi tregon raportin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi i themelit krahasuar me totalin e çështjeve të mbyllura.

- Kolona 8: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 9 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 9: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Total *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 10, 12, 14 dhe 16: numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 11, 13, 15, 17: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *totalit të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolonat 18, 19, 20: kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 21: Norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 22: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 23: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 24: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 23) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund.

(Kolona 8). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*v) Seancat gjyqësore*

- Kolona 25: Numri i seancave gjyqësore përfshin seancat gjyqësore të mbajtura në prani të palëve, duke përjashtuar seancat përgatitore dhe të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 26: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në

Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 25 me *numrin total të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA NR. 2 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

Tabela nr. 2 paraqet evidenca lidhur me ngarkesën mesatare të çështjeve dhe produktivitetin e gjyqtarëve, llogaritur për totalin e çështjeve administrative në gjykatë.

*A. Treguesit*

- Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. *Për shembull*, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

- Kolona 2: numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 1) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve të gjykuara për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të mbyllura për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të mbyllura gjatë periudhës së raportimit (kolona 3 në tabelën 1) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 4: numri total i çështjeve për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit ose ngarkesën mesatare të gjyqtarit brenda kësaj periudhe. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (kolona 5 në tabelën 1) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: numri total i çështjeve të mbartura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të papërfunduara për gjyqtar në gjykatë në fund të periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të pa përfunduara në fund të periudhës së raportimit (kolona 4 në tabelën 1) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 3 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË VENDIMIT

- Tabela nr. 3 tregon sasinë e çështjeve administrative në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit, të grupuara sipas afateve të vendosura.

*A. Llojet e çështjeve*

Përkufizimet e llojeve të çështjeve janë të njëjta me ato në tabelën nr. 1 të këtij seksioni.

*B. Treguesit*

- Kolona 1: tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit.

- Në këto kolona, kolonat 2, 3, 4, 5, 6, 7 vendoset numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës. Mosha e çështjeve në pritje të vendimit tregon periudhën kohore nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit. Mosha e çështjeve duhet të raportohet në kolonat përkatëse: deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vite (361-720 ditë); 2-3 vjet (721-1080 ditë); 3-5 vjet (1081-1800 ditë) dhe më shumë se 5 vjet (më shumë se 1800 ditë).

- Kolonat 8, 9, 10, 11, 12, 13: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës është raporti i numrit të çështjeve në pritje të vendimit sipas moshës me numrin total të çështjeve në pritje të vendimit në

periudhën e raportimit (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

SEKSIONI III - UDHËZIME PËR GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

- Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë hartuar 4 tabela standarde, si vijon:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet penale sipas llojit të çështjes;

- Tabela nr. 2 - Statistika për çështjet gjyqësore (totali i çështjeve penale krime, kundërvajtje, çështje penale administrative dhe çështje të ligjit antimafia);

- Tabela nr. 3 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve;

- Tabela nr. 4 - Statistikat për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit.

TABELA 1 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

- Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është një gjykatë e juridiksionit të posaçëm, e cila gjykon çështje sipas kategorisë dhe sipas subjekteve, të cilat janë në kompetencën lëndore të saj. Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale përcakton të gjitha çështjet që i takojnë kompetencës lëndore të kësaj gjykate. Të dhënat për Çështjet në total raportohen në katër kategori kryesore çështjesh, krime (rreshti A), kundërvajtje penale (rreshti B), çështje penale administrative (rreshti C) dhe çështje të ligjit antimafia (rreshti D) në përputhje me nenet e Kodit Penal dhe me ligjet e tjera që parashikojnë çështje që janë në kompetencën lëndore të kësaj gjykate.

- Rreshti A: kategoria e "Krime" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë krime sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale krime janë veçuar disa grup veprash penale krime sipas objektit ose subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin A, nuk përbën shumën e nënkategorive A1, A2 dhe A3, por numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë krime.

- Rreshti A.1: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Korrupsioni" përfshin çështjet për veprat penale si më poshtë:

- Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 244 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 244/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, neni 245 i Kodit Penal;

- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, neni 245/1 i Kodit Penal;

- Përfitim i paligjshëm i interesave, neni 257 i Kodit Penal;

- Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike, neni 258 i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 259/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, neni 260 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit, neni 312 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, neni 319 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/b i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/c i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, neni 319/ç i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/d i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/dh i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/e i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv në zgjedhje, neni 328 i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv në zgjedhje, neni 328/b i Kodit Penal;

- Çështje të tjera;

- Rreshti A.2: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krimi i organizuar" përfshin çështjet për veprat krime të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal[1], të tilla si:

- Organizatat terroriste, neni 234/a i Kodit Penal;

- Banda e armatosur, neni 234/b i Kodit Penal;

- Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale, neni 284/a i Kodit Penal;

- Organizatat kriminale, neni 333 i Kodit Penal;

- Grupi i strukturuar kriminal, neni 333/a i Kodit Penal;

- Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, neni 334 i Kodit Penal;

- Çështje të tjera.

**- Rreshti A.3**: në kategorinë "Krime", nënkategoria "**Krime të kryera nga ose ndaj të miturve**" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë krime të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

**- Rreshti B**: kategoria "**Kundërvajtje penale"** përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë kundërvajtje penale sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale kundërvajtje janë veçuar një grup veprash penale kundërvajtje, sipas subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin B përbën numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë kundërvajtje penale.

**- Rreshti B.1**: në kategorinë "**Kundërvajtje penale**", nënkategoria "**Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve**" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë kundërvajtje penale të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

**- Rreshti C**: kategoria "**Çështje penale administrative"** përfshin tërësinë e çështjeve penale administrative, të ndryshme nga çështjet penale të themelit. Në këtë kategori bëjnë pjesë kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak, çështjet penale të seancës paraprake dhe kërkesat penale të fazës së ekzekutimit.

- Në kategorinë e çështjeve penale administrative është veçuar një nënkategori sipas fazës së procedimit, përkatësisht: Masa sigurimi (C.1). Numri i çështjeve në rreshtin C, përbën numrin total të çështjeve penale administrative, të cilat janë të gjitha çështjet e tjera penale, të ndryshme nga ato të themelit për krime (kategoria A) dhe kundërvajtje penale (kategoria B).

**- Rreshti C.1**: në kategorinë "**Çështje penale administrative**", nënkategoria "**Masa sigurimi**" përfshin kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak për caktimin, zëvendësimin, revokimin dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ose pasuror.

**- Rreshti D**: në kategorinë "**Çështje të ligjit antimafia**" përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (ligji antimafia).

**- Rreshti E: "Çështje penale gjithsej"** është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtin A, B, C dhe D dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

i) Administrimi i çështjeve

**- Kolona 1**: **në pritje të gjykimit në fillim të periudhës** tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

**- Kolona 2**: **çështje të reja të paraqitura në gjykatë** tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë, ashtu edhe çështjet e kthyera për rigjykim pas prishjes së vendimit në gjykatat më të larta dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

**- Kolona 3**: **çështje të gjykuara** (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj

[1]Këtu është konsideruar kompetenca lëndore e gjykatës sipas përcaktimeve te nenit 75/a te K.Pr.P

vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, kthim aktesh, deklarim moskompetence etj.). Numri total i ***çështjeve të gjykuara*** duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4 dhe 6.

**- Kolona 4: numri i çështjeve të mbyllura me vendim për themelin e çështjes** tregon numrin e çështjeve të përfunduara pas shqyrtimit të plotë të çështjes, me vendim pafajësie ose dënimi. Në këtë kategori do të përfshihen edhe çështjet e përfunduara me vendim për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë[2] (neni 406/e i Kodit të Procedurës Penale) dhe çështjet e përfunduara me miratimin e urdhrit penal (neni 406/b i KPP), pranimin ose rrëzimin kërkesave në çështjet penale administrative të fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake ose fazës së ekzekutimit.

**- Kolona 5**: **përqindja e çështjeve të mbyllura me vendim në themel** tregon raportin e çështjeve të përfunduara me vendim themeli dhe totalit të çështjeve të mbyllura.

**- Kolona 6: numri i çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi** tregon numrin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi për themelin e çështjes raportuar në kolonën 4 (si p.sh. me deklarimin e moskompetencës lëndore ose tokësore, refuzimi i marrëveshjes (neni 406/ë i K.Pr.P.), refuzimi i miratimit të urdhrit penal (neni 406/c i K.Pr.P.), mospranimi ose kthimin për hetime të çështjeve penale administrative të fazës së seancës paraprake ose fazës së ekzekutimit etj.).

**- Kolona 7: përqindja e çështjeve të mbyllura me lloje të tjera disponimi** tregon raportin e çështjeve të përfunduara me çfarëdolloj vendimi të ndryshëm nga vendimi i themelit krahasuar me totalin e çështjeve të mbyllura.

**- Kolona 8: në pritje të gjykimit në fund të periudhës** tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 9 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

**- Kolona 9: çështje të regjistruara gjithsej** tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, **kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara** llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

**- Kolonat 10, 12, 14 dhe 16**: **numri** i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

**- Kolonat 11, 13, 15, 17**: **përqindja** e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standarde në Excel, si pjesë e *totalit të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

**- Kolonat 18, 19, 20**: **kohëzgjatja mesatare e çështjeve (në ditë)** korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës.*

**- Kolona 21**: **norma e likuidimit të çështjeve (%)** është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

**- Kolona 22**: **koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë)** është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të

[2]Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në referim të kompetencës lëndore të saj sipas nenit 75/a të K.Pr.P., të ndryshuar me ligjet nr. 35/2017 dhe nr. 147/2020, shkronja "c" dhe "ç", ka në kompetencë të saj edhe vepra penale për të cilat ligji parashikon dënimin me burgim deri në 7 vjet dhe për të cilat, në referim të nenit 406/d pika 1 të K.Pr.P. lejohet zgjidhja e çështjes më marrëveshje e cila miratohet nga Gjykata. Gjithashtu, një pjesë e veprave në kompetencë të kësaj gjykate në referim të nenit 75/a shkronja "a" parashikojnë dënim deri në shtatë vjet burgim, të tilla si vepra penale e parashikuar nga neni 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c të Kodit Penal. Gjithashtu, neni 406/d, pika 2 i K.Pr.P. parashikon se "*…Arritja e marrëveshjes lejohet për veprat penale për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim. Ky kufizim nuk gjen zbatim në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë."*

periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

**- Kolona 23: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës** përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

**- Kolona 24**: **përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë më të vjetra se 2 vjet** tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 23) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 8). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

**- Kolona 25: numri i seancave** përfshin seancat e mbajtura në prani të palëve, duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

**- Kolona 26: numri i seancave gjyqësore për çështje** është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 25 me *numrin total të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 2 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË TOTAL

**Tabela nr. 2** është një tabelë përmbledhëse duke përfshirë të dhënat për administrimin e çështjeve, treguesit e eficiencës dhe seancat gjyqësore për të gjitha çështjet e trajtuara nga gjykata.

*A. Llojet e çështjeve*

- Në këtë tabelë, totali i çështjeve gjyqësore përfshin kategoritë "Krime" (rreshti A), "Kundërvajtje penale" (rreshti B), "Çështje penale administrative" (rreshti C) dhe "Çështje të ligjit antimafia" (rreshti D).

**- Rreshti A:** kategoria "Krime" përfshin totalin e çështjeve penale të themelit për vepra penale krime nga tabela 1 në këtë seksion.

**Rreshti B:** kategoria "**Kundërvajtje penale**" përfshin totalin e çështjeve penale të themelit për vepra penale kundërvajtje nga tabela 1 në këtë seksion.

**Rreshti C:** kategoria "**Çështje penale administrative**" përfshin totalin e çështjeve penale, të ndryshme nga çështjet penale të themelit të përfshira në rreshtin A dhe B të përfshira në rreshtin C, nga tabela 1 në këtë seksion.

**Rreshti D:** kategoria "**Çështje të ligjit antimafia**" përfshin totalin e çështjeve me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të Ligjit Antimafia, të përfshira në rreshtin D, nga tabela 1 në këtë seksion.

**Rreshti E:** "**Çështje gjithsej**" përfshin numrin e përgjithshëm të çështjeve penale dhe është shuma e shifrave të vendosura në rreshtat A, B, C dhe D, e cila llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit, të pa përfunduara, në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara gjithsej tregon numrin e çështjeve të përfunduara brenda periudhës së raportimit.

Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. Në pritje në fund të periudhës është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali i çështjeve të regjistruara është shuma e shifrave të vendosura në kolonat 1 dhe 2. Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 6: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 7: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 8: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 7) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

- Kolona 9: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat gjyqësore të mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 10: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i numrit të seancave në kolonën 9 me numrin total të çështjeve të mbyllura në kolonën 3.

TABELA NR. 3 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

- Tabela nr. 3 paraqet të dhëna për ngarkesën mesatare të çështjeve dhe produktivitetin e gjyqtarëve llogaritur për volumin total të çështjeve në gjykatë.

*A. Treguesit*

- Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

- Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. Për shembull, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

- Kolona 2: numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin mesatar të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 2) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve të gjykuara për gjyqtar tregon numrin mesatar të çështjeve të mbyllura për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të mbyllura gjatë periudhës së raportimit (kolona 3 në tabelën 2) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 4: numri total i çështjeve për gjyqtar tregon numrin mesatar të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit ose ngarkesën mesatare të gjyqtarit brenda kësaj periudhe. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (kolona 5 në tabelën 2) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: numri total i çështjeve të mbartura për gjyqtar tregon numrin mesatar të çështjeve të papërfunduara për gjyqtar në gjykatë në fund të periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të pa përfunduara në fund të periudhës së raportimit (kolona 4 në tabelën 2) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 4 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT

- Tabela nr. 4 tregon sasinë e çështjeve në pritje të vendimit ose të papërfunduara në fund të periudhës së raportimit, të grupuara sipas afateve të vendosura.

*A) Llojet e çështjeve*

- Përkufizimet e llojeve të çështjeve janë të njëjta me ato në tabelën nr. 1 të këtij seksioni.

*B) Treguesit*

- Kolona 1: tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit, pra numrin e çështjeve të papërfunduara.

- Kolonat 2, 3, 4, 5, 6, 7 përmbajnë numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës. Mosha e çështjeve në pritje të vendimit tregon periudhën kohore nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit. Mosha e çështjeve duhet të raportohet në kolonat përkatëse: deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vite (361-720 ditë); 2-3 vjet (721-1080 ditë); 3-5 vjet (1081-1800 ditë) dhe më shumë se 5 vjet (më shumë se 1800 ditë).

- Kolonat 8, 9, 10, 11, 12, 13: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës është raporti i numrit të çështjeve në pritje të vendimit sipas moshës me numrin total të çështjeve në pritje të vendimit në periudhën e raportimit (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

SEKSIONI IV - UDHËZIME PËR GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

- Për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, janë hartuar 8 tabela standarde, si vijon:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjes;

- Tabela nr. 2 - Statistikat për çështjet penale sipas llojit të çështjes;

- Tabela nr. 3 - Statistikat për çështjet e gjykatës (totali civile + penale);

- Tabela nr. 4 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve;

- Tabela nr. 5 - Statistikat për çështjet civile të apelit sipas ardhjes nga gjykatat e shkallës së parë;

- Tabela nr. 6 - Statistikat për çështjet penale të apelit sipas ardhjes nga gjykatat e shkallës së parë;

- Tabela nr. 7 - Statistikat për çështjet e apelit të ardhura në tërësi gjykata e shkallës së parë (totali i çështjeve penale dhe civile);

- Tabela nr. 8 - Statistikat për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit.

TABELA 1 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A) Llojet e çështjeve*

- Rreshti A: kategoria "Çështje civile me palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë A.1 (Civile të përgjithshme me palë kundërshtare), A.2 (Familjare me palë kundërshtare), A.3 (Tregtare me palë kundërshtare) dhe A.4 (Marrëdhënie pune). Në çdo kategori dhe nënkategori përfshihen çështjet e apeluara dhe çështjet e juridiksionit fillestar.

- Rreshti A.1: në kategorinë "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare" përfshin çështjet civile të cilat iniciohen në gjykatë me kërkesëpadi, duke përjashtuar çështjet që përfshihen në kategoritë "Familjare me palë kundërshtare" (rreshti A.2), "Tregtare me palë kundërshtare" (rreshti A.3) dhe "Marrëdhënie pune" (rreshti A.4).

- Rreshti A.2: në kategorinë e "Çështjeve civile me palë kundërshtare" nënkategoria "Çështje familjare me palë kundërshtare" përfshin pa u kufizuar, si më poshtë:

- Padi për pavlefshmërinë e martesës (neni 43 i Kodit të Familjes);

- Padi për zgjidhjen e martesës (neni 129 e vijues i K. Familjes);

- Padi për njohjen ose kundërshtimin e amësisë ose atësisë (nenet 177,178,179, 181,183,184,185,186,187,188 të Kodit të Familjes);

- Padia për kërkimin e detyrimit për ushqim ndërmjet bashkëshortëve (neni 199 i K. Familjes);

- Padia për përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim ndaj fëmijës;

- Padia për heqjen/kthimin e përgjegjësisë prindërore, përcaktimin e përgjegjësisë prindërore të fëmijës së lindur jashtë martese (neni 227,228 i K. Familjes).

- Padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrit të mbrojtjes.

- Çështje të tjera.

- Rreshti A.2.1: në nënkategorinë e "Çështjeve familjare me palë kundërshtare", të dhënat për "Zgjidhje martese" duhet të raportohen me vete. Këtu futen çështjet e parashikuara nga Kodi i Familjes, pa u kufizuar, si më poshtë:

- Zgjidhja e martesës në bazë të neneve 129-131 të Kodit të Familjes.

- Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërës palë, nenet 132-140 të Kodit të Familjes.

- Çështje të tjera.

- Rreshti A.3: në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje tregtare

me palë kundërshtare", përfshin pa u kufizuar si më poshtë:

- Anulimin e pretendimeve të kompanisë, neni 3/1 i ligjit nr. 9901, datë. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Dëmshpërblimi i dëmeve të administratorëve, neni 98 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Pretendimet për dividendët, neni 129 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Përgjegjësitë e organeve mbikëqyrëse, neni 151 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Kompetencat e administratorëve, neni 95 dhe 98 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Shkrirja e kompanive sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Çështjet sipas ligjit për falimentin 110/2016;
- Zhvlerësimi i çeqeve, faturave të shkëmbimit dhe letrave të tjera me vlerë sipas neneve 337-346 të Kodit të Procedurës Civile;
- Çështje të tjera.

Rreshti A.4: në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategorinë "Marrëdhënie pune", përfshihen të dhënat për konfliktet gjyqësore që burojnë nga marrëdhëniet e punës, të tilla si:

- Paditë për shpërblimin e dëmit që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës;
- Padi për pavlefshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës;
- Padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësi gjatë marrëdhënies së punës;
- Çështje të tjera.
- Rreshti B: kategoria "Çështje civile pa palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë B.1 (Çështje të përgjithshme civile pa palë kundërshtare), B.2 (Çështje familjare pa palë kundërshtare) dhe B.3 (Çështje tregtare pa palë kundërshtare). Në çdo kategori dhe nënkategori përfshihen çështjet e apeluara dhe çështjet e juridiksionit fillestar.
- Rreshti B.1: në kategorinë e "Çështje civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje të përgjithshme civile pa palë kundërshtare" përfshihen pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Kërkesa për sigurimin e padisë, kur ajo paraqitet si kërkesë e veçantë para ngritjes së padisë (neni 202 dhe 204 i K.Pr.C.);
- Kërkesa për sigurimin e provës e paraqitur para ngritjes së padisë (neni 293 i K.Pr.C.);
- Kërkesa për ndreqjen e gabimeve, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit (nenet 312,313,314 të K.Pr.C.);
- Kërkesa për shpalljen e zhdukjes ose vdekjes së një personi (neni 375 i K.Pr.C.) dhe kërkesa për ndryshimin ose prishjen e vendimit që ka vendosur shpalljen e zhdukjes ose vdekjes së personit (neni 379);
- Kërkesa për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe kërkesa për kthimin e zotësisë (neni 382 – 387 i K.Pr.C.);
- Kërkesa për vërtetimin gjyqësor të fakteve juridike (neni 388 e vijues i K.Pr.C.);
- Kërkesa për ndihmë juridike në fushën civile;
- Kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit (neni 511 i K.Pr.C.),
- Kërkesa të tjera.
- Rreshti B.2: në kategorinë "Çështje civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje familjare pa palë kundërshtare" përfshin pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Kërkesa për adoptim, nenet 240-262 të Kodit të Familjes;
- Zgjidhja e martesës me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, nenet 125-128 të Kodit të Familjes;
- Kërkesa për dhënien e autorizimit për administrimin e pasurisë së të miturit (neni 234 e vijues i Kodit të Familjes);
- Kërkesa të tjera.
- Rreshti B.3: në kategorinë e "Çështjeve civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje tregtare pa palë kundërshtare" përfshin pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Falimenti sipas ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 "Për falimentimin";
- Regjistrimi i OJF-ve sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesë për emërimin e një administratori;
- Kërkesë për riemërtimin e shoqërive;
- Kërkesë për ndryshimin e numrit të ortakëve sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesë për ndryshimin e kapitalit bazë sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

- Kërkesë për ndryshimin e selisë së shoqërisë sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

- Kërkesa të tjera.

- Rreshti B.3.1: në kategorinë e "Çështjeve civile pa palë kundërshtare" dhe në nënkategorinë "Çështje tregtare pa palë kundërshtare", të dhënat për "Falimentin" duhet të raportohen. Këtu përfshihen çështjet për fillimin e procedurës së falimentit sipas ligjit nr. 110/2016 "Për falimentin", neni 13 e vijues.

- Rreshti C: "Çështje civile gjithsej" është shuma e shifrave të shënuara në kolonat A dhe B, e cila llogaritet automatikisht në tabelën Excel dhe përfshin numrin total të çështjeve civile me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë (të apeluara dhe të juridiksionit fillestar), ashtu edhe çështjet e kthyera për rigjykim pas prishjes së vendimit nga gjykata më e lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, mospranim ankimi, kthim aktesh, deklarim moskompetence etj.). Numri total i *çështjeve të gjykuara* duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4 dhe 6.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 6, 8, 10 dhe 12: numri i çështjeve të gjykuara sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 7, 9, 11, 13: përqindja e çështjeve të gjykuara sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolona 14: kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet <u>në ditë</u>.

*iii) Treguesit e eficiencës*

Kolona 15: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 16: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 17: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 18: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 17) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4).

Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

- Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat e mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 20: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 19 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 2 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

- Gjykatat e apelit janë kompetente për gjykimin e çështjeve penale, me përjashtim të atyre që bëjnë pjesë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Të dhënat për çështjet penale raportohen në katër kategori kryesore çështjesh, krime (rreshti A), kundërvajtje penale (rreshti B), çështje penale administrative (rreshti C) dhe çështje të ligjit antimafia (rreshti D), në përputhje me nenet e Kodit Penal dhe me ligje të tjera që parashikojnë veprat penale që përbëjnë krime ose kundërvajtje penale, si dhe në përputhje me kategorinë e çështjes, si penale themeli apo çështje penale administrative.

- Rreshti A: kategoria "Krime" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë krime sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale krime janë veçuar disa grup veprash penale krime sipas objektit ose subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin A, nuk përbën shumën e nënkategorive A1, A2, A3 dhe A4, por numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë krime.

- Rreshti A.1: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Vrasje me dashje" përfshin çështjet për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83 të Kodit Penal.

- Rreshti A.2: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Vjedhje" përfshin çështjet për veprat penale të parashikuara nga nenet 139, 140, 141, të Kodit Penal.

- Rreshti A.3: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Dhuna në familje" përfshin çështjet sipas nenit 130/a të Kodit Penal.

- Rreshti A.4: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krime të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë krime të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

- Rreshti B: kategoria "Kundërvajtje penale" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë kundërvajtje penale sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale kundërvajtje janë veçuar një grup veprash penale kundërvajtje, sipas subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin B përbën numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë kundërvajtje penale.

- Rreshti B.1: në kategorinë "Kundërvajtje penale", nënkategoria "Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë kundërvajtje penale të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

- Rreshti C: kategoria "Çështje penale administrative" përfshin tërësinë e çështjeve penale administrative, të ndryshme nga çështjet penale të themelit. Në këtë kategori bëjnë pjesë kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak, çështjet penale të seancës paraprake dhe kërkesat penale të fazës së ekzekutimit.

- Në nënkategoritë e çështjeve penale administrative janë veçuar tri nënkategori sipas fazës së procedimit ose objektit të çështjes, përkatësisht: masa sigurimi (C.1), lirim me kusht (C.2) dhe ekstradime (C.3). Numri i çështjeve në rreshtin C, nuk përbën shumën e nënkategorive C.1, C.2 dhe C.3, por numrin total të çështjeve penale administrative, të cilat janë të gjitha çështjet e tjera penale, të ndryshme nga ato të themelit për krime (kategoria A) dhe kundërvajtje penale (kategoria B).

- Rreshti C.1: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Masa sigurimi" përfshin kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak për caktimin, zëvendësimin, revokimin

dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ose pasuror.

- Rreshti C.2: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Lirim me kusht" përfshin kërkesat me objekt lirimin para kohe me kusht sipas parashikimeve të neneve 63 dhe 64 të Kodit Penal.

- Rreshti C.3: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Ekstradime" përfshin kërkesat me objekt ekstradimin e personave sipas parashikimeve të nenit 497 e vijues dhe 501 të Kodit të Procedurës Penale.

- Rreshti D: në kategorinë "Çështje të ligjit antimafia" përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (ligji antimafia).

- Rreshti E: "Çështje penale gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtat A, B, C dhe D, që përbën totalin e çështjeve penale dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë (nëpërmjet ankimit ose si çështje të cilat regjistrohen për herë të parë në gjykatën e apelit), ashtu edhe çështjet e kthyera pas prishjes së vendimit nga gjykata më e lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (mospranim ankimi, deklarim moskompetence etj.).

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së arsyetimit të vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 6, 8, 10 dhe 12: numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 7, 9, 11, 13: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *totalit të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolona 14: kohëzgjatja mesatare e çështjeve (në ditë) korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 15: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 16: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 17: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në

gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 18: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë më të vjetra se 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 17) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

- Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat e mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 20: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 19 me *numrin* e çështjeve të *mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 3 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + PENALE)

- Tabela nr. 3 është një tabelë përmbledhëse duke përfshirë të dhënat për *administrimin e çështjeve*, *treguesit e eficiencës* dhe *seancat gjyqësore* për të gjitha çështjet e trajtuara nga gjykata.

*Llojet e çështjeve*

- Në këtë tabelë, totali i çështjeve gjyqësore përfshin "Çështjet civile" (rreshti A), "Çështjet penale" (rreshti B), dhe çështjet gjithsej (rreshti C).

- Rreshti A: kategoria "Çështje civile" përfshin shumën e çështjeve me dhe pa palë kundërshtare nga tabela nr. 1.

- Rreshti B: kategoria "Çështjet penale" përfshin shumën e çështjeve penale (krime, kundërvajtje, çështje penale administrative dhe çështje të ligjit antimafia) nga tabela nr. 2.

- Rreshti C: "Gjithsej", është shuma e shifrave të vendosura në A dhe B dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*A. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit, të pa përfunduara, në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, nëpërmjet apelimit dhe çështjet ë paraqitura për herë të parë në gjykatën e apelit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara tregon numrin e çështjeve të përfunduara brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. *Totali i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave të vendosura në kolonat 1 dhe 2. Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 6: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 7: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 8: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë më të vjetra se 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 7) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iii) Seancat gjyqësore*

- Kolona 9: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat gjyqësore të mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 10: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave për çështje, sipas kategorisë së çështjes (çështje civile dhe çështje penale). Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport

i *numrit të seancave* në kolonën 9 me *numrin total të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA NR. 4 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

- Tabela nr. 4 paraqet të dhëna për ngarkesën mesatare të çështjeve dhe produktivitetin e gjyqtarëve llogaritur për volumin total të çështjeve në gjykatë (d.m.th. shuma e çështjeve civile dhe çështjeve penale).

*Treguesit*

- Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

- Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. *Për shembull*, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

- Kolona 2: numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 3) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve të gjykuara për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të mbyllura për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të mbyllura gjatë periudhës së raportimit (kolona 3 në tabelën 3) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 4: numri total i çështjeve për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit ose ngarkesën mesatare të gjyqtarit brenda kësaj periudhe. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (kolona 5 në tabelën 3) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: numri total i çështjeve të mbartura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të papërfunduara për gjyqtar në gjykatë në fund të periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të pa përfunduara në fund të periudhës së raportimit (kolona 4 në tabelën 3) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

TABELAT 5, 6, 7 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË APEL TË ARDHURA NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË

Tabelat nr. 5, 6 dhe 7 regjistrojnë të dhënat mbi administrimin e çështjeve dhe mënyrën e disponimit në gjykatën e apelit, nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e apeluar. Veçanërisht, tabela nr. 5 raporton të dhënat për çështjet civile, tabela nr. 6 raporton të dhënat për çështjet penale dhe tabela nr. 7 raporton të dhënat për numrin total të çështjeve (civile + penale).

*A. Gjykatat*

- Çdo gjykatë apeli duhet të plotësojë rreshtat, duke shënuar gjykatat e rretheve sipas rendit alfabetik.

- Rreshti i fundit në çdo tabelë është shuma e shifrave të shënuara në rreshtat A, B etj.

*B. Treguesit*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, nëpërmjet apelimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara është numri i çështjeve të përfunduara brenda periudhës së

raportimit dhe duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4, 6, 8 dhe 10.

- Kolonat nr. 4/5, vendime të lëna në fuqi tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me një vendim lënie në fuqi nga gjykata e apelit sipas parashikimeve të nenit 466 shkronja "a" të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 428, pika 1, shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolonat nr. 6/7, dërguar për rigjykim, tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me vendim prishje vendimi dhe dërgimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim sipas parashikimeve të nenit 466, shkronja "ç" dhe 467 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 428, pika 1, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Penale (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolonat Nr. 8/9, Ndryshuar tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me një ndryshim të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë sipas parashikimeve të nenit 466 shkronja "b" të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 428, pika 1, shkronja "b" të Kodit të Procedurës Penale (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e rasteve të mbyllura).

- Kolonat nr. 10/11, të tjera tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura ndryshe, p.sh, për mungesë kompetence, mospranim në apel, prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes etj. (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolona 12: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 13 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 13: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 8 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT

Tabela nr. 8 tregon sasinë e çështjeve civile dhe çështjeve penale në pritje të vendimit në fund të periudhës së raportimit, të grupuara sipas afateve të vendosura.

*A. Llojet e çështjeve*

- Përkufizimet e llojeve të çështjeve janë të njëjta me ato në tabelat nr. 1 dhe 2 të këtij seksioni.

*B. Treguesit*

- Kolona 1: tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit, pra numrin e çështjeve të papërfunduara.

- Në këto kolona, kolonat 2, 3, 4, 5, 6, 7 vendoset numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës. Mosha e çështjeve në pritje të vendimit tregon periudhën kohore nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit. Mosha e çështjeve duhet të raportohet në kolonat përkatëse: deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vite (361-720 ditë); 2-3 vjet (721-1080 ditë); 3-5 vjet (1081-1800 ditë) dhe më shumë se 5 vjet (më shumë se 1800 ditë).

- Kolonat 8, 9, 10, 11, 12, 13: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës është raporti i numrit të çështjeve në pritje të vendimit sipas moshës me numrin total të çështjeve në pritje të vendimit në periudhën e raportimit (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

SEKSIONI V - UDHËZIME PËR GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT

Për gjykatën administrative të apelit, janë hartuar 4 tabela standarde, si vijon:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet administrative në apel sipas llojit të çështjes;

- Tabela nr. 2 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve;

- Tabela nr. 3 - Statistikat për çështjet administrative të apelit të ardhura nga gjykatat administrative të shkallës së parë;

- Tabela nr. 4 - Statistikat për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit.

TABELA 1 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE

*A. Llojet e çështjeve*

- Gjykatat administrative konsiderohen gjykata me juridiksion të specializuar. Çështjet administrative ndahen në dy kategori të mëdha: "Çështje administrative me palë kundërshtare"

(rreshti A) dhe "Çështje administrative pa palë kundërshtare" (rreshti B).

- Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështje të ardhura me ankim ndaj vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe çështje administrative që janë në juridiksionin fillestar të saj.

- Rreshti A: kategoria "Çështje administrative me palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë A.1 (Administrative të përgjithshme) dhe A. 2 (Marrëdhënie pune).

- Rreshti A.1: në kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare", nënkategoria "Administrative të përgjithshme" përfshin çështjet e apeluara dhe ato të juridiksionit fillestar, duke mos u kufizuar, si më poshtë:

- Mosmarrëveshjet nga aktet administrative, aktet nënligjore dhe kontratat administrative publike, neni 7/a i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Ndërhyrje e paligjshme ose mosveprim nga organi publik, neni 7/b i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

Mosmarrëveshjet e kompetencave midis organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 7/c, i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Çështje të tjera.

- Rreshti A.2: në kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare", nënkategoria "Marrëdhënie pune" përfshihen:

- Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe punonjësve shtetërorë, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me akte të posaçme, të cilat janë në kompetencën lëndore të gjykatës administrative sipas nenit 7/ç të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

- Rreshti B: kategoria e "Çështjeve administrative pa palë kundërshtare", përbëhet nga çështjet e apeluara dhe ato të juridiksionit fillestar, por pa u kufizuar, si më poshtë:

- Kërkesat me natyrë administrative të parashikuara nga neni 7 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe kërkesa të tjera të parashikuara nga ky ligj ose ligje të tjera;

- Kërkesat e paraqitura nga shkelësit për zëvendësimin e dënimit administrativ, neni 7/dh i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Kërkesa për ndreqjen e gabimeve, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit;

- Kërkesa për sigurimin e padisë, kur ajo paraqitet para ngritjes së padisë sipas nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 49/2012;

- Kërkesa të tjera.

- Rreshti C: "Çështje administrative gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtat A dhe B dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë (nëpërmjet apelimit ose çështje të juridiksionit fillestar të gjykatës së apelit), ashtu edhe çështjet e kthyera për rigjykim pas prishjes së vendimit nga gjykata më e lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, kthim aktesh, deklarim moskompetence, mospranim ankimi etj.).

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë

periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 6, 8, 10 dhe 12: numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 7, 9, 11, 13: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *totalit të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

-Kolona 14: kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës raportuese. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 15: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 16: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 17: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 18: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 17) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

- Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin <u>seancat gjyqësore</u> të mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 20: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 19 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA NR. 2 – STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

*A. Treguesit*

- Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

- Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. *<u>Për shembull</u>*, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

- Kolona 2: numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 1) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve të gjykuara për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të mbyllura për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të mbyllura gjatë periudhës së raportimit (kolona 3 në tabelën 1) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 4: numri total i çështjeve për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit ose ngarkesën mesatare të gjyqtarit brenda kësaj periudhe. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (kolona 5 në tabelën 1) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: numri total i çështjeve të mbartura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të papërfunduara për gjyqtar në gjykatë në fund të periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të pa përfunduara në fund të periudhës së raportimit (kolona 4 në tabelën 1) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 3 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT TË ARDHURA NGA GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Tabela nr. 3 regjistron të dhënat për administrimin e çështjeve dhe mënyrën e disponimit në gjykatën administrative të apelit sipas gjykatës së shkallës së parë nga e cila vijnë çështjet nëpërmjet apelimit.

*A. Gjykatat*

- Shumica e çështjeve që shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Apelit janë çështje që vijnë nëpërmjet apelimit të vendimeve të gjykatave administrative të shkallës së parë, që ndahen si vijon: "Durrës" (rreshti A), "Gjirokastër" (rreshti B), "Korçë" (rreshti C), "Shkodër" (rreshti D), "Tiranë" (rreshti E) dhe "Vlorë" (rreshti F).

- Rreshti G në tabelë është shuma e shifrave të treguara në rreshtat A, B, C, D, E Dhe F. dhe llogaritet automatikisht në fletën Excel.

*B. Treguesit*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, sipas gjykatave të shkallës së parë nga të cilat kanë ardhur çështjet nëpërmjet apelimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara gjithsej është numri i çështjeve të përfunduara brenda periudhës së raportimit dhe duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 4, 6, 8 dhe 10.

- Kolonat nr. 4/5, "Vendime të lëna në fuqi" tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me një vendim lënie në fuqi sipas parashikimeve të nenit 53 shkronja "a" të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolonat nr. 6/7, dërguar për rigjykim, tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me vendim dërgimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim sipas parashikimeve të neneve 53 shkronja "ç" dhe 54 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolonat nr. 8/9, ndryshuar tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me një ndryshim të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë sipas parashikimeve të nenit 53, shkronja "b", të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e rasteve të mbyllura).

- Kolonat nr. 10/11, të tjera tregojnë numrin/ përqindjen e çështjeve të mbyllura ndryshe, p.sh., për mungesë kompetence, mospranim në apel, prishje vendimi dhe pushimin e çështjes etj. (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

Kolona 12: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje*

*të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 13 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 13: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali i çështjeve të regjistruara është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 4 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË VENDIMIT

- Tabela nr. 4 tregon sasinë e çështjeve administrative në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit, të grupuara sipas afateve të vendosura.

*A. Lloji i çështjeve*

Përkufizimet e llojeve të çështjeve janë të njëjta me ato në tabelën nr. 1 të këtij seksioni.

*B. Treguesit*

- Kolona 1: tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit.

- Në këto kolona, kolonat 2, 3, 4, 5, 6, 7 vendoset numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës. Mosha e çështjeve në pritje të vendimit tregon periudhën kohore nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit. Mosha e çështjeve duhet të raportohet në kolonat përkatëse: deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vite (361-720 ditë); 2-3 vjet (721-1080 ditë); 3-5 vjet (1081-1800 ditë) dhe më shumë se 5 vjet (më shumë se 1800 ditë).

- Kolonat 8, 9, 10, 11, 12, 13: Përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës është raporti i numrit të çështjeve në pritje të vendimit sipas moshës me numrin total të çështjeve në pritje të vendimit në periudhën e raportimit (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

SEKSIONI VI- UDHËZIME PËR GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

- Për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë hartuar 4 tabela standarde, si vijon:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet penale sipas llojit të çështjes

- Tabela nr. 2 - Statistika për çështjet gjyqësore (totali i çështjeve penale krime, kundërvajtje, çështje penale administrative dhe çështje të ligjit antimafia)

- Tabela nr. 3 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve

- Tabela nr. 4 - Statistikat për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit

TABELA 1 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është gjykatë e juridiksionit të specializuar, e cila gjykon çështje sipas kategorisë dhe sipas subjekteve, të cilat janë në kompetencën lëndore të saj. Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale përcakton të gjitha çështjet që i takojnë kompetencës lëndore të kësaj gjykate. Të dhënat për Çështjet në total raportohen në katër kategori kryesore çështjesh, krime (rreshti A), kundërvajtje penale (rreshti B), çështje penale administrative (rreshti C) dhe çështje të ligjit antimafia (rreshti D) në përputhje me nenet e Kodit Penal dhe me ligjet e tjera që parashikojnë çështje që janë në kompetencën lëndore të kësaj gjykate.

- Rreshti A: kategoria e "Krime" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë krime sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale krime janë veçuar disa grup veprash penale krime sipas objektit ose subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin A, nuk përbën shumën e nënkategorive A1, A2 dhe A3, por numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë krime.

- Rreshti A.1: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Korrupsioni" përfshin çështjet për veprat penale si më poshtë:

- Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 244 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 244/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, neni 245 i Kodit Penal;

- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, neni 245/1 i Kodit Penal;

- Përfitim i paligjshëm i interesave, neni 257 i Kodit Penal;
- Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike, neni 258 i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 259/a i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, neni 260 i Kodit Penal;
- Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit, neni 312 i Kodit Penal;
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, neni 319 i Kodit Penal;
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/a i Kodit Penal;
- Korrupsioni aktiv i arbitrit vendës dhe të huaj, neni 319/b i Kodit Penal
- Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/c i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, neni 319/ç i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/d i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/dh i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/e i Kodit Penal;
- Korrupsioni aktiv në zgjedhje, neni 328 i Kodit Penal;
- Korrupsioni pasiv në zgjedhje, neni 328/b i Kodit Penal;
- Çështje të tjera;
- Rreshti A.2: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krimi i organizuar" përfshin çështjet për veprat krime të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal, të tilla si:
- Organizatat terroriste, neni 234/a i Kodit Penal;
- Banda e armatosur, neni 234/b i Kodit Penal;
- Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale, neni 284/a i Kodit Penal;
- Organizatat kriminale, neni 333 i Kodit Penal;
- Grupi i strukturuar kriminal, neni 333/a i Kodit Penal;
- Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, neni 334 i Kodit Penal;
- Çështje të tjera;
- Rreshti A.3: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krime të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë krime të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.
- Rreshti B: kategoria "Kundërvajtje penale" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë kundërvajtje penale sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale kundërvajtje janë veçuar një grup veprash penale kundërvajtje, sipas subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin B përbën numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë kundërvajtje penale.
- Rreshti B.1: në kategorinë " Kundërvajtje penale ", nënkategoria "Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë kundërvajtje penale të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.
- Rreshti C: kategoria "Çështje penale administrative" përfshin tërësinë e çështjeve penale administrative, të ndryshme nga çështjet penale të themelit. Në këtë kategori bëjnë pjesë kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak, çështjet penale të seancës paraprake dhe kërkesat penale të fazës së ekzekutimit.
- Në kategorinë e çështjeve penale administrative është veçuar një nënkategori sipas fazës së procedimit, përkatësisht: masa sigurimi (C.1). Numri i çështjeve në rreshtin C, përbën numrin total të çështjeve penale administrative, të cilat janë të gjitha çështjet e tjera penale, të ndryshme nga ato të themelit për krime (kategoria A) dhe kundërvajtje penale (kategoria B).
- Rreshti C.1: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Masa sigurimi" përfshin kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak për caktimin, zëvendësimin, revokimin dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ose pasuror.

- Rreshti D: në kategorinë "Çështje të ligjit antimafia" përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (ligji antimafia).

- Rreshti E: "Çështje penale gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtat A, B, C dhe D dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit, duke përfshirë si çështjet e regjistruara për herë të parë, ashtu edhe çështjet e kthyera për rigjykim pas prishjes së vendimit në gjykatën më të lartë dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, përmes një vendimi për themelin e çështjes ose përmes çfarëdolloj vendimi tjetër që mbyll procedurën (vendim pushimi, kthim aktesh, deklarim moskompetencë etj.). Numri total i *çështjeve të gjykuara* duhet të jetë i barabartë me shumën e shifrave në kolonat 6, 8, 10 dhe 12.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Mënyra e zgjidhjes*

- Kolonat nr. 6/7, vendime të lëna në fuqi tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me një vendim lënie në fuqi nga gjykata e apelit sipas parashikimeve të nenit 428, pika 1, shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolonat nr. 8/9, dërguar për rigjykim, tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me vendim dërgimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim sipas parashikimeve të nenit 428, pika 1, shkronja "ç" të Kodit të Procedurës Penale (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

- Kolonat nr. 10/11, ndryshuar tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura me një ndryshim të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë sipas parashikimeve të nenit 428, pika 1, shkronja "b" të Kodit të Procedurës Penale (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e rasteve të mbyllura).

- Kolonat nr. 12/13,Të tjera tregojnë numrin/përqindjen e çështjeve të mbyllura ndryshe, p.sh, për mungesë kompetence, mospranim në apel, prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes etj, (përqindja llogaritet automatikisht në totalin e çështjeve të mbyllura).

*iii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 14, 16, 18 dhe 20: numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 15, 17, 19 dhe 21: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *totalit të çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolona 22: Kohëzgjatja mesatare e çështjeve (në ditë) korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës

raportuese. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iv) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 23: norma e likuidimit të çështjeve (%)është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 24: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

Kolona 25: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 26: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë më të vjetra se 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 25) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*v) Seancat gjyqësore*

- Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat e mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 28: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 27 me numrin total të *çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 2 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET NË TOTAL

Tabela nr. 2 është një tabelë përmbledhëse duke përfshirë të dhënat për *administrimin e çështjeve*, *treguesit e eficiencës* dhe *seancat gjyqësore* për të gjitha çështjet e trajtuara nga gjykata.

*A. Llojet e çështjeve*

- Në këtë tabelë, totali i çështjeve gjyqësore përfshin kategoritë "Krime" (rreshti A), "Kundërvajtje penale" (rreshti B), "Çështje penale administrative" (rreshti C) dhe "Çështje të ligjit antimafia" (rreshti D).

- Rreshti A: kategoria "Krime" përfshin totalin e çështjeve penale të themelit për vepra penale krime nga tabela 1 në këtë seksion.

- Rreshti B: kategoria "Kundërvajtje penale" përfshin totalin e çështjeve penale të themelit për vepra penale kundërvajtje nga tabela 1 në këtë seksion.

- Rreshti C: kategoria "Çështje penale administrative" përfshin totalin e çështjeve penale, të ndryshme nga çështjet penale të themelit të përfshira në rreshtin A dhe B të përfshira në rreshtin C, nga tabela 1 në këtë seksion.

- Rreshti D: kategoria "Çështje të ligjit antimafia" përfshin totalin e çështjeve me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të ligjit antimafia, të përfshira në rreshtin D, nga tabela 1 në këtë seksion.

- Rreshti E: "Çështje penale gjithsej" përfshin numrin e përgjithshëm të çështjeve dhe është shuma e shifrave të vendosura në rreshtat A, B, C dhe D, e cila llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B) Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit, të pa përfunduara, në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara gjithsej tregon numrin e çështjeve të përfunduara brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. *Totali i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave të vendosura në kolonat 1

dhe 2. Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 6: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 7: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 8: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 7) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Seancat gjyqësore*

- Kolona 9: numri i seancave gjyqësore përfshin seancat gjyqësore të mbajtura në prani të palëve duke përjashtuar të dhënat për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, kur ligji e parashikon shqyrtimin e çështjes në këtë mënyrë.

- Kolona 10: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 9 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA NR. 3 - STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

- Tabela nr. 3 paraqet të dhëna për ngarkesën mesatare të çështjeve dhe produktivitetin e gjyqtarëve llogaritur për volumin total të çështjeve në gjykatë.

*A. Treguesit*

- Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

- Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. *<u>Për shembull</u>*, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

- Kolona 2: numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 2) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit ose ngarkesën mesatare të gjyqtarit brenda kësaj periudhe. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (çështje të mbartura nga viti paraardhës + çështje të regjistruara të reja) (kolona 3 në tabelën 2) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 4: numri total i regjistruar për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve për të cilat duhet të vendosë çdo gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit (kolona 5 në tabelën 2) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: numri total i çështjeve të mbartura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të papërfunduara për gjyqtar në gjykatë në fund të periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit total të çështjeve të pa përfunduara në fund të periudhës së raportimit (kolona 4 në tabelën 2) për numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1).

Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

TABELA 4 - STATISTIKAT PËR MOSHËN E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT

Tabela nr. 4 tregon sasinë e çështjeve në pritje të vendimit në fund të periudhës së raportimit, të grupuara sipas afateve të vendosura.

*A. Llojet e çështjeve*

- Përkufizimet e llojeve të çështjeve janë të njëjta me ato në tabelën nr. 1 të këtij seksioni.

*B. Treguesit*

- Kolona 1: tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit, pra numrin e çështjeve të papërfunduara.

- Në këto kolona, kolonat 2, 3, 4, 5, 6, 7 vendoset numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës. Mosha e çështjeve në pritje të vendimit tregon periudhën kohore nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit. Mosha e çështjeve duhet të raportohet në kolonat përkatëse: deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vite (361-720 ditë); 2-3 vjet (721-1080 ditë); 3-5 vjet (1081-1800 ditë) dhe më shumë se 5 vjet (më shumë se 1800 ditë).

- Kolonat 8, 9, 10, 11, 12, 13: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës së raportimit sipas moshës është raporti i numrit të çështjeve në pritje të vendimit sipas moshës me numrin total të çështjeve në pritje të vendimit në periudhën e raportimit (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

SEKSIONI VII - UDHËZIME PËR GJYKATËN E LARTË

Për Gjykatën e Lartë, janë hartuar 9 tabela standarde, si vijon:

- Tabela nr. 1 - Statistikat për çështjet civile sipas llojit të çështjes;
- Tabela nr. 2 - Statistikat për çështjet administrative sipas llojit të çështjes;
- Tabela nr. 3 - Statistikat për çështjet penale sipas llojit të çështjes;
- Tabela nr. 4 - Statistikat për çështjet e gjykatës (totali civile + administrative + penale);
- Tabela nr. 5 - Statistikat për ngarkesën dhe produktivitetin e gjyqtarëve;
- Tabela nr. 6 - Statistikat për çështjet civile dhe administrative nga gjykatat e apelit;
- Tabela nr. 7 - Statistikat për çështjet penale nga gjykatat e apelit;
- Tabela nr. 8 - Statistikat për çështjet civile dhe penale nga gjykata e apelit;
- Tabela nr. 9 - Statistikat për moshën e çështjeve në pritje të gjykimit.

TABELA 1 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

- Të dhënat për çështjet civile do të raportohen në dy kategori të mëdha, të cilat janë: “Çështje civile me palë kundërshtare” (rreshti A) dhe “Çështje civile pa palë kundërshtare” (rreshti B).

- Rreshti A: në kategorinë “Çështje civile me palë kundërshtare” përfshihet nënkategoria A.1 (Civile të përgjithshme me palë kundërshtare), A.2 (Familjare me palë kundërshtare), A.3 (Tregtare me palë kundërshtare) dhe A.4 (Marrëdhënie pune).

- Rreshti A.1: në kategorinë e “Çështje civile me palë kundërshtare”, nënkategoria “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” përfshin çështjet civile të cilat iniciohen në gjykatë me kërkesëpadi, duke përjashtuar çështjet që përfshihen në kategoritë “Familjare me palë kundërshtare” (rreshti A.2), “Tregtare me palë kundërshtare” (rreshti A.3) dhe “Marrëdhënie pune” (rreshti A.4).

- Rreshti A.2: në kategorinë e “Çështjeve civile me palë kundërshtare” nënkategoria “Çështje familjare me palë kundërshtare” përfshin, por pa u kufizuar, si më poshtë:

- Padi për pavlefshmërinë e martesës (neni 43 i Kodit të Familjes);
- Padi për zgjidhjen e martesës (neni 129 e vijues i K. Familjes);
- Padi për njohjen ose kundërshtimin e amësisë ose atësisë (nenet 177, 178, 179, 181, 183, 184, 185, 186, 187, 188 të Kodit të Familjes);
- Padia për kërkimin e detyrimit për ushqim ndërmjet bashkëshortëve (neni 199 i K. Familjes);
- Padia për përcaktimin ose ndryshimin e detyrimit për ushqim ndaj fëmijës;
- Padia për heqjen/kthimin e përgjegjësisë prindërore, përcaktimin e përgjegjësisë prindërore të fëmijës së lindur jashtë martese (neni 227, 228 i K. Familjes);
- Padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrit të mbrojtjes;
- Çështje të tjera.

- Rreshti A.2.1: në nënkategorinë e "Çështjeve familjare me palë kundërshtare", të dhënat për "Zgjidhje martese" duhet të raportohen më vete. Këtu futen çështjet e parashikuara nga Kodi i Familjes, por pa u kufizuar, si më poshtë:
- Zgjidhja e martesës në bazë të neneve 129-131 të Kodit të Familjes.
- Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërës palë, nenet 132-140 të Kodit të Familjes.
- Çështje të tjera.
- Rreshti A.3: në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje tregtare me palë kundërshtare", përfshin, por pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Anulimin e pretendimeve të kompanisë, neni 3/1 i ligjit nr. 9901, datë. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Dëmshpërblimi i dëmeve të administratorëve, neni 98 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Pretendimet për dividendët, neni 129 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Përgjegjësitë e organeve mbikëqyrëse, neni 151 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Kompetencat e administratorëve, neni 95 dhe 98 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Shkrirja e kompanive sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Çështjet sipas ligjit për falimentin 110/2016;
- Zhvlerësimi i çeqeve, faturave të shkëmbimit dhe letrave të tjera me vlerë sipas neneve 337-346 të Kodit të Procedurës Civile;
- Çështje të tjera.
- Rreshti A.4: në kategorinë e "Çështje civile me palë kundërshtare", nënkategorinë "Marrëdhënie pune", përfshihen të dhënat për konfliktet gjyqësore që burojnë nga marrëdhëniet e punës.
- Rreshti B: kategoria "Çështje civile pa palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë B.1 (Çështje të përgjithshme pa palë kundërshtare), B.2 (Çështje familjare pa palë kundërshtare) dhe B.3 (Çështje tregtare pa palë kundërshtare).
- Rreshti B.1: në kategorinë e "Çështje civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje të përgjithshme civile pa palë kundërshtare" përfshihen, por pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Kërkesa për sigurimin e padisë, kur ajo paraqitet si kërkesë e veçantë para ngritjes së padisë (neni 202 dhe 204 i K.Pr.C.);
- Kërkesa për sigurimin e provës e paraqitur para ngritjes së padisë (neni 293 i K.Pr.C.);
- Kërkesa për ndreqjen e gabimeve, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit (nenet 312,313,314 të K.Pr.C.);
- Kërkesa për shpalljen e zhdukjes ose vdekjes së një personi (neni 375 i K.Pr.C.) dhe kërkesa për ndryshimin ose prishjen e vendimit që ka vendosur shpalljen e zhdukjes ose vdekjes së personit (neni 379);
- Kërkesa për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe kërkesa për kthimin e zotësisë (neni 382–387 i K.Pr.C.);
- Kërkesa për vërtetimin gjyqësor të fakteve juridike (neni 388 e vijues i K.Pr.C.);
- Kërkesa për ndihmë juridike në fushën civile;
- Kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit (neni 511 i K.Pr.C.),
- Kërkesa të tjera.
- Rreshti B.2: në kategorinë "Çështje civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje familjare pa palë kundërshtare" përfshin, por pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Kërkesa për adoptimi, nenet 240-262 të Kodit të Familjes;

Zgjidhja e martesës me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, nenet 125-128 të Kodit të Familjes;

Kërkesa për dhënien e autorizimit për administrimin e pasurisë së të miturit (neni 234 e vijues i Kodit të Familjes);

Kërkesa të tjera.

- Rreshti B.3: në kategorinë e "Çështjeve civile pa palë kundërshtare", nënkategoria "Çështje tregtare pa palë kundërshtare" përfshin, por pa u kufizuar, sa më poshtë:
- Falimenti sipas ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 "Për falimentimin";
- Regjistrimi i OJF-ve sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";
- Kërkesë për emërimin e një administratori;
- Kërkesë për riemërtimin e shoqërive;
- Kërkesë për ndryshimin e numrit të ortakëve sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

- Kërkesë për ndryshimin e kapitalit bazë sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

- Kërkesë për ndryshimin e selisë së shoqërisë sipas ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

- Kërkesa të tjera.

- Rreshti B.3.1: Në kategorinë e "Çështjeve civile pa palë kundërshtare" dhe në nënkategorinë "Çështje tregtare pa palë kundërshtare", të dhënat për "Falimentin" duhet të raportohen më vete. Këtu përfshihen çështjet për fillimin e procedurës së falimentit sipas ligjit nr. 110/2016 "Për falimentin", neni 13 e vijues.

- Rreshti C: "Çështje civile gjithsej" është shuma e shifrave të shënuara në kolonat A dhe B, e cila llogaritet automatikisht në tabelën Excel dhe përfshin numrin total të çështjeve civile me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportues.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, pavarësisht llojit të vendimit.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 6, 8, 10 dhe 12: numri i çështjeve të gjykuara sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur më pak se 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 7, 9, 11, 13: përqindja e çështjeve të gjykuara sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolona 14:Kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës së raportimit, për totalin e çështjeve dhe sipas llojit të disponimit. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet <u>në ditë</u>.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 15: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 16: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 17: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 18: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 17) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

- Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin vetëm seancat gjyqësore dhe jo dhomat e këshillimit.

- Kolona 20: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 19 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 2 – STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET ADMINISTRATIVE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJEVE

*A. Llojet e çështjeve*

- Ka dy kategori të mëdha në tabelën 2: "Çështje administrative me palë kundërshtare" (rreshti A) dhe "Çështje administrative pa palë kundërshtare" (rreshti B).

- Rreshti A: kategoria "Çështje administrative me palë kundërshtare" përfshin nënkategorinë A. 1 (Çështje administrative të përgjithshme) dhe A. 2 (Marrëdhënie pune).

- Rreshti A.1: kë kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare", nënkategoria "Administrative të përgjithshme" përfshin administrative të cilat iniciohen me padi, por pa u kufizuar, si më poshtë:

- Mosmarrëveshjet nga aktet administrative, aktet nënligjore dhe kontratat administrative publike, neni 7/a i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Ndërhyrje e paligjshme ose mosveprim nga organi publik, neni 7/b i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Mosmarrëveshjet e kompetencave midis organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 7/c, i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Çështje të tjera.

- Rreshti A.2: në kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare", nënkategoria "Marrëdhënie pune" përfshihen:

- Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe punonjësve shtetërorë, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me akte të posaçme, të cilat janë në kompetencën lëndore të gjykatës administrative sipas nenit 7/ç të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

- Rreshti B: kategoria e "Çështjeve administrative pa palë kundërshtare", përbëhet nga çështjet, por pa u kufizuar, si më poshtë:

- Kërkesat me natyrë administrative të parashikuara nga neni 7 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe kërkesa të tjera të parashikuara nga ky ligj ose ligje të tjera;

- Kërkesat e paraqitura nga shkelësit për zëvendësimin e dënimit administrativ, neni 7/dh i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";

- Kërkesa për ndreqjen e gabimeve, plotësimin e vendimit, sqarimin dhe interpretimin e vendimit;

- Kërkesa për sigurimin e padisë, kur ajo paraqitet para ngritjes së padisë sipas nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 49/2012;

- Kërkesa të tjera.

- Rreshti C: "Çështje administrative gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtin A dhe B dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, pavarësisht llojit të vendimit.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në

kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii. Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 6, 8, 10 dhe 12: numri i çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur më pak se 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 7, 9, 11, 13: përqindja e çështjeve të mbyllura sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolona 14: kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës raportuese. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 15: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 16:Koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 17: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 18: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 17) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

- Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin vetëm seancat gjyqësore dhe jo dhomat e këshillimit.

- Kolona 20: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 19 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 3 - STATISTIKAT E ÇËSHTJEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES

*A. Llojet e çështjeve*

Gjykata e Lartë ka në kompetencë çështjet penale të cilat vijnë nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim "Gjykatat e posaçme"). Çështjet penale të cilat shqyrtohen në Gjykatën e Lartë, janë ndarë në katër kategori kryesore: krime (rreshti A), kundërvajtje (rreshti B) dhe çështje penale administrative (rreshti C), çështje të ligjit antimafia (rreshti D), në përputhje me nenet e Kodit Penal dhe me ligje të tjera që parashikojnë veprat penale që përbëjnë krime ose kundërvajtje penale, si dhe në përputhje me kategorinë e çështjeve, si penale themeli apo çështje penale administrative sipas Kodit të Procedurës Penale ose ligjeve të tjera.

- Rreshti A: kategoria "Krime" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë krime sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale, të ardhura nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e posaçme. Në nënkategoritë e çështjeve penale krime janë veçuar disa grup veprash penale krime sipas objektit ose subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin A, nuk përbën shumën e nënkategorive A1, A2, A3, A4, A5 dhe A6, por numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë krime.

- Rreshti A.1: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Vrasje me dashje" përfshin çështjet për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83 të Kodit Penal.

- Rreshti A.2: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Vjedhje" përfshin çështjet për veprat penale të parashikuara nga nenet 139, 140, 141, të Kodit Penal.

- Rreshti A.3: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Dhuna në familje" përfshin çështjet sipas nenit 130/a të Kodit Penal.

- Rreshti A.4: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krime të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë krime të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

- Rreshti A.5: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Korrupsioni" përfshin çështjet për veprat penale si më poshtë:

- Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 244 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 244/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, neni 245 i Kodit Penal;

- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, neni 245/1 i Kodit Penal;

- Përfitim i paligjshëm i interesave, neni 257 i Kodit Penal;

- Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankandepublike, neni 258 i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 259/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, neni 260 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit, neni 312 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, neni 319 i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/a i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/b i Kodit Penal

- Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/c i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, neni 319/ç i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/d i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/dh i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/e i Kodit Penal;

- Korrupsioni aktiv në zgjedhje, neni 328 i Kodit Penal;

- Korrupsioni pasiv në zgjedhje, neni 328/b i Kodit Penal;

- Çështje të tjera;

- Rreshti A.6: në kategorinë "Krime", nënkategoria "Krimi i organizuar" përfshin çështjet për veprat krime të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal, të tilla si:

- Organizatat terroriste, neni 234/a i Kodit Penal;

- Banda e armatosur, neni 234/b i Kodit Penal;

- Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale, neni 284/a i Kodit Penal;

- Organizatat kriminale, neni 333 i Kodit Penal;

- Grupi i strukturuar kriminal, neni 333/a i Kodit Penal;

- Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, neni 334 i Kodit Penal;

- Çështje të tjera;

- Rreshti B: kategoria "Kundërvajtje penale" përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë kundërvajtje penale sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale kundërvajtje janë veçuar një grup veprash penale kundërvajtje, sipas subjekteve të procedimit penal. Numri i çështjeve në rreshtin B përbën numrin total të çështjeve penale të themelit për kategorinë kundërvajtje penale.

- Rreshti B.1: në kategorinë "Kundërvajtje penale", nënkategoria "Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve" përfshin çështjet penale të themelit për vepra penale të kategorisë kundërvajtje penale të cilat janë kryer nga të mitur ose në dëm të të miturve.

- Rreshti C: kategoria "Çështje penale administrative" përfshin tërësinë e çështjeve penale administrative, të ndryshme nga çështjet penale të themelit. Në këtë kategori bëjnë pjesë kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak, çështjet penale

të seancës paraprake dhe kërkesat penale të fazës së ekzekutimit.

- Në nënkategoritë e çështjeve penale administrative janë veçuar tri nënkategori sipas fazës së procedimit ose objektit të çështjes, përkatësisht: masa sigurimi(C.1), Lirim me kusht (C.2) dhe Ekstradime (C.3). Numri i çështjeve në rreshtin C, nuk përbën shumën e nënkategorive C.1, C.2 dhe C.3, por numrin total të çështjeve penale administrative, të cilat janë të gjitha çështjet e tjera penale, të ndryshme nga ato të themelit për krime (kategoria A) dhe kundërvajtje penale (kategoria B).

- Rreshti C.1: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Masa sigurimi" përfshin kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak për caktimin, zëvendësimin, revokimin dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ose pasuror.

- Rreshti C.2: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Lirim me kusht" përfshin kërkesat me objekt lirimin para kohe me kusht sipas parashikimeve të neneve 63 dhe 64 të Kodit Penal.

- Rreshti C.3: në kategorinë "Çështje penale administrative", nënkategoria "Ekstradime" përfshin kërkesat me objekt ekstradimin e personave sipas parashikimeve të nenit 497 e vijues dhe 501 të Kodit të Procedurës Penale.

- Rreshti D: kategoria "Çështje të ligjit antimafia" përfshin çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (ligji antimafia).

Rreshti E: "Çështje penale gjithsej" është shuma e shifrave të paraqitura në rreshtin A, B, C dhe D, që përbën totalin e çështjeve penale dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese ose të mbartura nga viti paraardhës. Numri i çështjeve *në pritje të gjykimit në fillim të periudhës* duhet të jetë i barabartë me numrin e çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës paraardhëse raportuese.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara/regjistruara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara (*mbyllura*) tregon numrin total të çështjeve të përfunduara brenda periudhës raportuese, pavarësisht llojit të vendimit.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje të gjykimit në fund të periudhës* është diferenca mes shifrës në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 5: çështje të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. Totali *i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave në kolonën 1 dhe në kolonën 2 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara*

- Për qëllime të statistikave për performancën dhe eficiencën e gjykatës, kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara llogaritet që nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë, deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse për lloje specifike çështjesh, ligji parashikon apo jo një afat ligjor për mbylljen e procedimit.

- Kolonat 6, 8, 10 dhe 12: numri i çështjeve të gjykuara sipas kohëzgjatjes raportohet në këto kolona, përkatësisht, për çështje që kanë zgjatur deri në 6 muaj (1-180 ditë); 6-12 muaj (181-360 ditë), 1-2 vjet (361-720 ditë) dhe më shumë se 2 vjet (më shumë se 720 ditë).

- Kolonat 7, 9, 11, 13: përqindja e çështjeve të gjykuara sipas kohëzgjatjes llogaritet automatikisht në këto kolona në tabelat standardë në Excel, si pjesë e *çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

- Kolona 14: kohëzgjatja mesatare e çështjeve korrespondon me kohëzgjatjen mesatare të çështjeve të mbyllura brenda periudhës raportuese. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve duhet të raportohet në ditë.

*iii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 15: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 16: koha deri në zgjidhjen e çështjes/ koha e disponimit (në ditë) është raporti i çështjeve në pritje të gjykimit në fund të periudhës raportuese me numrin e çështjeve të mbyllura brenda asaj periudhe, shprehur në ditë. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të kohës së disponimit.

- Kolona 17: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 18: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 17) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iv) Seancat gjyqësore*

Kolona 19: numri i seancave gjyqësore përfshin vetëm seancat gjyqësore dhe jo dhomat e këshillimit.

Kolona 20: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje, sipas kategorisë së çështjes. Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 19 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA 4 - STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + ADMINISTRATIVE + PENALE)

*A. Llojet e çështjeve*

- Në këtë tabelë, totali i çështjeve gjyqësore përfshin "Çështjet civile" (rreshti A), "Çështjet administrative" (rreshti B) dhe "Çështjet penale" (rreshti C).

- Rreshti A: kategoria "Çështje civile" përfshin shumën e çështjeve civile, me dhe pa palë kundërshtare, nga tabela nr. 1.

- Rreshti B: kategoria "Çështje administrative" përfshin shumën e totalit të çështjeve administrative me dhe pa palë kundërshtare, nga tabela nr. 2.

- Rreshti C: kategoria "Çështjet penale" përfshin shumën e veprave dhe kundërvajtjeve penale nga tabela nr. 3.

- Rreshti D: "Gjithsej", paraqet shumën e shifrave të paraqitura në rreshtat A, B dhe C dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

*B. Treguesit*

*i) Administrimi i çështjeve*

- Kolona 1: në pritje të gjykimit në fillim të periudhës tregon numrin e çështjeve të pambyllura në fillim të periudhës raportuese. *Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit* duhet të jetë një numër i barabartë me çështjet në pritje të gjykimit, të pa përfunduara, në fund të periudhës paraardhëse.

- Kolona 2: çështje të reja të paraqitura në gjykatë tregon numrin e çështjeve të depozituara në gjykatë brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 3: çështje të gjykuara tregon numrin e çështjeve të përfunduara brenda periudhës së raportimit.

- Kolona 4: në pritje të gjykimit në fund të periudhës tregon numrin e çështjeve që nuk janë mbyllur në fund të periudhës së raportimit. *Në pritje në fund të periudhës* është diferenca mes shifrave në kolonën 5 dhe në kolonën 3 dhe llogaritet automatikisht në tabelën në Excel.

Kolona 5: të regjistruara gjithsej tregon numrin total të çështjeve në pritje të gjykimit gjatë periudhës raportuese. *Totali i çështjeve të regjistruara* është shuma e shifrave të vendosura në kolonat 1 dhe 2. Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*ii) Treguesit e eficiencës*

- Kolona 6: norma e likuidimit të çështjeve (%) është raporti i përftuar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të mbyllura me numrin e çështjeve të reja në periudhën raportuese, shprehur në përqindje. Fleta në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të normës së likuidimit.

- Kolona 7: çështje më të vjetra se 2 vjet në fund të periudhës përfshin çështjet e regjistruara në gjykatë më shumë se dy vjet para fundit të periudhës raportuese dhe që nuk janë mbyllur.

- Kolona 8: përqindja e çështjeve në pritje të gjykimit që janë më të vjetra se 2 vjet tregon raportin mes numrit të këtyre çështjeve (kolona 7) me totalin e numrit të çështjeve në pritje të gjykimit në fund (kolona 4). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

*iii) Seancat gjyqësore*

- Kolona 9: numri i seancave gjyqësore përfshin vetëm seancat gjyqësore dhe jo dhomat e këshillimit.

- Kolona 10: numri i seancave gjyqësore për çështje është numri mesatar i seancave për çështje,

sipas kategorisë së çështjes (çështje civile dhe çështje penale). Tabela në Excel përmban formulën për llogaritjen automatike të këtij treguesi, si raport i *numrit të seancave* në kolonën 9 me *numrin e çështjeve të mbyllura* në kolonën 3.

TABELA NR. 5 – STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

- Tabela nr. 4 paraqet të dhëna për ngarkesën mesatare të çështjeve dhe produktivitetin e gjyqtarëve llogaritur për volumin total të çështjeve në gjykatë (d.m.th. shuma e çështjeve civile, çështjeve penale dhe çështjeve administrative).

*A. Treguesit*

- Kolona 1: numri i gjyqtarëve në gjykatë, për qëllime të kësaj tabele, ky është numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë (d.m.th. pozicionet aktualisht të plotësuara dhe jo numri në organikën e gjykatës). Ky numër duhet të jepet sipas ekuivalentit me kohë të plotë (FTE), që do të thotë se duhet të merren parasysh të gjitha vendimet ose shkaqet që ndikojnë në prezencën efektive të gjyqtarit në detyrë të tilla si pezullimet, delegimet, daljet në pension, lejet me raport të mjekut, lejet e lindjes etj.

- Kjo do të thotë se numri i gjyqtarëve që punojnë me kohë të pjesshme ose gjyqtarëve që kanë punuar vetëm për një pjesë të periudhës së raportimit duhet të konvertohet në FTE. *Për shembull*, për qëllime të statistikave vjetore, për secilin gjyqtar, FTE llogaritet si raporti i numrit të ditëve "të punës" në gjykatë me numrin total të ditëve të punës në vitin kalendarik. Një gjyqtar që punon për gjysmën e kohës duhet të llogaritet si 0.5 FTE; po kështu, një gjyqtar që ka punuar për tre muaj gjatë gjashtëmujorit të raportimit, duhet gjithashtu të llogaritet për 0.5 FTE.

- Kolona 2: Numri total i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të reja për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të reja gjatë periudhës së raportimit (kolona 2 në tabelën 4) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Kolona 3: numri total i çështjeve të gjykuara për gjyqtar tregon numrin *mesatar* të çështjeve të mbyllura për gjyqtar në gjykatë brenda periudhës së raportimit. Kjo llogaritet si raporti i numrit të çështjeve të mbyllura gjatë periudhës së raportimit (kolona 3 në tabelën 4) me numrin e gjyqtarëve në gjykatë (kolona 1). Vlerat e kësaj kolone llogariten automatikisht në tabelën në Excel.

- Për dokumentacionin e konstatuar si më sipër, duke marrë parasysh dhe rrethanat dhe kufizimet e krijuara për shkak të pandemisë *COVID-19*, siç edhe është bërë me dije nga shoqëria, se për shkak të pamundësisë së lëvizjes dhe depozitimit të çdo dokumenti të munguar, vlerësojmë që t'i lihet si kusht shoqërisë që ta plotësojë atë përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1 Të rinovojë licencën e shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., me nr. 115/310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 5, data 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE:

a) vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë;

b) dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë, që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë "Energy Supply – AL" sh.p.k., apo strukturën e financimit;

c) sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi;

d) dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria, sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 15, datë 20.1.2021

## MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT NR. 140, DATË 24.9.2019, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'IRARBA ENERGJI' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'SHËNGJUN', ME KAPACITET TË INSTALUAR 2040 kw"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave ERE-s", të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/7 prot., datë 15.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Irarba Energji' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Shëngjun', me kapacitet të instaluar 2040 kw'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 140, datë 24.9.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Irarba Energji' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali 'Shëngjun' me kapacitet të instaluar 2040 kw", vendosi:

"1. Të licencojë shoqërinë "Irarba Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shëngjun" me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj, me kusht që, të depozitojë në ERE përpara fillimit të veprimtarisë së prodhimit, lejen mjedisore me parametrat teknike të përditësuar, sipas ndryshimeve të Kontratës Shtesë të Koncesionit

nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol., datë 5.4.2016, "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e HEC "Shëngjun", të ndryshuar".

2. Të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto leje.

3. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.".

- Në zbatim të kësaj vendimmarrjeje, shoqëria duhet të përcillte në ERE, përpara fillimit të operimit, lejen mjedisore, të rinovuar, në zbatim të ndryshimeve që solli Kontrata Shtesë e Koncesionit nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol., datë 5.4.2016.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje dhe në kuadër të plotësimit të kushtit të vendosur në vendimin e licencimit nr. 140/2019, shoqëria "Irarba Energji", ka përcjellë në ERE konfirmimin e lejes nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të cilën përcaktohet se, bazuar në faktet e mëposhtme:

- Aktiviteti pas marrjes së lejeve/licencave përkatëse është pajisur me leje ndërtimi që është leja përfundimtare për zbatimin e një projekti;

- Punimet e zbatimit kanë filluar, bazuar në lejet/licencat përkatëse;

- Për nga pikëpamja mjedisore, nuk kemi shtrirje në zona të tjera, ndryshim kuote, prekje të sipërfaqeve, zgjerime etj.

Në bazë të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet sërish procedurave të VNM-së.

- Sa më sipër, shoqëria "Irarba Energji" sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Irarba Energji' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC 'Shëngjun' me kapacitet të instaluar 2040 kw".

- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument që ka të dhëna se duhet t'i nënshtrohet procedurës së rinovimit. Kjo referuar edhe konstatimeve të vendimit përkatës të licencimit nr. 140/2019. Për rrjedhojë, aktualisht, shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e shfuqizimit të tërësishëm apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, ndryshon, si vijon:

*Ishte:*

1. Të licencojë shoqërinë "Irarba Energji" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shëngjun" me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj, me kusht që, të depozitojë në ERE, përpara fillimit të veprimtarisë së prodhimit, lejen mjedisore me parametrat teknike të përditësuar, sipas ndryshimeve të Kontratës Shtesë të Koncesionit nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol., datë 5.4.2016, "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e HEC 'Shëngjun', të ndryshuar".

*Bëhet:*

1. Të licencojë shoqërinë "Irarba Energji" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shëngjun" me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj.

2. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 16, datë 20.1.2021**

## MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", dhe vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 687, datë 22.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", i ndryshuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi'", si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/11 prot., datë 16.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021,

KONSTATOI SE:

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 270, datë 28.12.2020, la në fuqi vendimin nr. 94, datë 8.6.2020, "Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020", deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR.
- Meqenëse raporti vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të Bursës Hungareze të Energjisë, si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR janë të publikuara në faqet e tyre zyrtare, në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 270, datë 28.12.2020, paraqiten llogaritjet për çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021.
- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) është marrë çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2020 i cili rezulton në vlerën 39.00 euro/MWh.
- Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit lekë/EUR, për çdo muaj të vitit 2020 rezulton se kursi mesatar i këmbimit për vitin 2020 të jetë 123.77 euro/lekë.
- Nisur nga elementët e përcaktuar më sipër dhe në zbatim të formulës përllogaritëse të pikës 3, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, në lidhje me metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, llogaritjet reflektohen si më poshtë:
- Pu= 39.00/1000 * 1.2 * 123.77 = 5.7924 lekë/kWh.
- Ndërkohë, në germat "ç" dhe "d", të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, përcaktohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, të cilët janë përkatësisht: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.

Meqenëse nga llogaritjet e kryera, çmimi i llogaritur sipas formulës së cituar në metodologji rezulton me i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016, sipas parashikimeve të germës "ç", të pikës 2, të VKM-së së sipërpërmendur, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 rezulton ai prej 7.448 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 të jetë 7.448 lekë/kWh.
2. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020, në rast se kursi i

këmbimit lekë/EUR do të rezultojë i ndryshëm nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2021.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 19, datë 20.1.2021

## MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 225, DATË 15.12.2020 "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 202, SERIA PV13K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "HEC TRESKA" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 80, DATË 27.4.2013

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 95, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 8 dhe 9 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenit 16 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/4 prot., datë 15.1.2021, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 225, datë 15.12.2020 'Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'HEC Treska' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 27.4.2013'",

KONSTATOI SE:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 225, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC TRESKA" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 27.4.2013.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 225, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë "HEC Treska" sh.p.k., nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/1-3 prot., datë 23.12.2020.

- Në vijim të këtij njoftimi, më datë 13.1.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE rezultoi dhe u bë me dije se janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni subjektit, rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 225/2020.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria "HEC TRESKA" sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE-s për pagesat e prapambetura të rregullimit.

- Në nenin 8 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për

të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast, "qëllimi" i procedurës lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundërdrejtohet masa administrative duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.

- Në nenin 9, germa "a" të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 225, datë 15.12.2020 "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC TRESKA" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 27.4.2013.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 225, datë 15.12.2020 "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC TRESKA" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 27.4.2013.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 1/3, datë 15.1.2021

## BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", e ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", kreu II, neni 4, pika "a" dhe "c"; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017, 'Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror''", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror', i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", si më poshtë:

**a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

1. Dosje personale nr. 360, në ngarkim të A. M., me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963–1973. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

2. Dosje formulare nr. 1099, në ngarkim të Xh. K., me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1977–1979. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

3. Dosje formulare nr. 1363, në ngarkim të Xh. K., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1967–1979. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

4. Kartelë model 2 nr. 519, në ngarkim të N. B., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është "Tepër sekret". Kartela daton në vitin 1967. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

5. Kartelë model 2, në ngarkim të F. N., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është "Tepër sekret". Kartela daton në vitin 1952. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

6. Dosje e problemit të centralizuar "Gorilla" nr. 978, me 6 vëllime, me 1776 (njëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet në dosje datojnë deri në vitet 1981–1986. Dosja i përket Fondit ish-Dega IV.

7. Fashikulli "Renegati" nr. 295, me 398 (treqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1974–1987. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

8. Lista e veçimit nr. 1, datë 16.12.1990, dhe vendimi për heqjen nga kontrolli operativ 2/B dhe asgjësimi i dosjes formulare nr. 8585, në ngarkim të H. C., me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1989–1990. Dokumentet i përkasin Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

9. Dosje fashikullore nr. 21, me procese të të arratisurve shqiptarë dhe të dërguar nga shteti armik, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1962–1966. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.

10. Kartelë model 2 nr. 516,692, në ngarkim të Sh. S., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është "Tepër sekret". Kartela daton në vitin 1958. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

11. Dosje formulare nr. 105, në ngarkim të Sh. S., me 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1962–1987. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

12. Dosje formulare nr. 7937, në ngarkim të Ll. K., me 81 (tetëdhjetë e një) fletë dhe 6 (gjashtë) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963–1989. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

13. Dosja nr. 347, "Për disa komente e propagandën armiqësore që bëhen në ushtri lidhur me situatën aktuale dhe ngjarjet në Evropën Lindore", me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria e I.

14. Dosja nr. 558, "Mbi hyrjet e paligjshme në ambasada në Tiranë", me 4 (katër) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria e I.

**I. Deklasifikimin pjesërisht të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" që gjendet në:**

1. Fondin Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, fletë regjistri, i Regjistrit të Agjenturës, nr. 2, konkretisht rreshti me nr. rendor 1396, në ngarkim të F. F., me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Tepër sekret".

KRYETAR
**Gentiana Sula**

**VENDIM**
**Nr. 7, datë 29.1.2021**

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b"; në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", kreu II, neni 4, pika "a", "c", dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit, "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar në AIDSSH, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 2, datë 29.1.2021, si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtëm:**

1. Dosje personale dhe pune nr. 10546, në ngarkim të A. T., respektivisht me 34 (tridhjetë e katër) fletë dhe 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978–1990. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

2. Libër evidencë agjenturale-operative e punëtorit operativ nr. 66, me 114 (njëqind e

katërmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1970–1978. Dokumenti i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

3. Kartelë model 2, nr. 8574/20692, në ngarkim të A. H. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1975–1980. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

4. Kartelë model 2, nr. 2146, në ngarkim të I. A. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1977–1980. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

5. Kartelë model 2, nr. 4071, në ngarkim të J. Z. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1978–1981. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

6. Kartelë model 2, nr. 6646, në ngarkim të P. M. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1973–1986. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

7. Kartelë model 2, nr. 1854, në ngarkim të S. L. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1969–1979. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

8. Kartelë model 2, nr. 2404, në ngarkim të K. Q. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1970–1975. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

9. Kartelë model 2, nr. 1851, në ngarkim të Xh. E. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1969–1977. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

10. Kartelë model 2, nr. 2111, në ngarkim të H. M. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1972–1974. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

11. Kartelë model 2, nr. 8000, në ngarkim të M. M. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Kartela daton në vitet 1985–1987. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

12. Dosje personale nr. 6207, në ngarkim të Dh. S., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1974–1990. Dosja i përket fondit ish-Degës së Punëve të Brendshme Fier.

13. Fashikull mbi emigracionin ekonomik shqiptar në vende të ndryshme të botës, me 81 (tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1965–1968. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e II.

14. Fashikull i veçantë për të arratisurit në shtator të vitit 1990, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet e datojnë në vitin 1990. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e II.

15. Fashikull i veçantë nr. 173 për të arratisurit, 2 volume përkatësisht me 261 (dyqind e gjashtëdhjetë e një) fletë + 2 fotografi dhe 356 (treqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë + 21 fotografi. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1987–1990. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e II.

16. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1990, dosja nr. 110, "Mbi refugjatët shqiptarë", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitin 1990.

17. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1990, dosja nr. 139, "Disa të dhëna dhe informacione të Drejtorisë III mbi refugjatët shqiptarë", me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dokumentet datojnë nga vitin 1990–1991.

18. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1990, dosja nr. 118, "Mbi përmbajtjen e letrave të dërguara nga persona të larguar nga vendi ynë nëpërmjet futjes në ambasadave të huaja", me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitin 1990.

19. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1989, dosja nr. 268, "Disa përfundime për punën e bërë dhe masat e marra për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e tendencës së arratisjes jashtë shtetit në Degët e Punëve të Brendshme Pogradec, Fier, Shkodër, Krujë dhe Elbasan", me 34 (tridhjetë e katër) fletë.

20. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1981, dosja nr. 90, "Raport mbi disa konkluzione që dalin nga ngjarje në liqenin e Pogradecit dhe arratisjet e ndodhura kohët e fundit", me 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitin 1981.

21. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1985, dosja nr. 119, "Listat dhe relacionet përkatëse për të arratisurit gjatë viteve 1944–1950 ardhur nga degët e rretheve Ersekë, Tepelenë, Pogradec, Skrapar e Pukë për Degën e I, të Drejtorisë së I", me 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitin 1985.

22. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, viti 1976, dosja nr. 44, "Informacione dërguar KQPPSh-së mbi arratisjen në Jugosllavi të familjes së Kimet Kojtorit", me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i

klasifikimit është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitin 1976.

23. Indeksi i të arratisurve nr. 3, grupi II-13, me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë dhe 41 fletë, me listën emërore të të arratisurve, fëmijë të tërhequr në arrati, atyre të lindur jashtë shtetit, si dhe grave me kombësi shqiptare e të huaj të martuara me të arratisurit jashtë shtetit. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Indeksi i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.

KRYETAR I KOMISIONIT TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
**Gentiana Sula**

**VENDIM**
**Nr. 12, datë 5.2.2021**

## BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", kreu II, neni 4, pika "a" dhe "c", dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017, 'Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror', në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar në AIDSSH, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 3, datë 5.2.2021, si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

1. Dosje kërkimi dhe dosje formulare nr. 301, në ngarkim të E. L., përkatësisht me 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) fletë dhe 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë + zarf me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1944–1958. Dosja i përket fondit ish-Të Arratisur.

2. Dosje formulare nr. 3559, në ngarkim të G. H., me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1979–1987. Dosja i përket ish-Fondit Operativ.

3. Dosje hetimore-gjyqësore nr. 40, në ngarkim të G. H., përkatësisht me 70 (shtatëdhjetë) fletë dhe 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1981–1982. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Durrës.

4. Dosje nr. 37, fashikull i përgjithshëm i bandës së diversantit T. T., me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1951–1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.

5. Dosje nr. 27, aktiviteti i Heroi të Popullit P. M., me 5 volume, në total 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1949–1950. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.

6. Dosja nr. 76, "Pasqyra statistikore mbi hyrjet e diversantëve jugosllavë e grekë gjatë viteve 1952–1953", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

7. Dosja nr. 72, "Raporti vjetor mbi gjendjen dhe veprimtarinë e bandave, diversantëve, pasqyra mbi hyrjet dhe daljet e diversantëve, dështimet me bandat dhe pasqyra statistikore", me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

8. Dosja nr. 84, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të D. P. nga Kukësi", me 24 (njëzetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952–1954. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

9. Dosja nr. 83, "Fashikull i përgjithshëm informatash për bandën e diversantit G. D. Shkodër", me 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1953–1959. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

10. Dosja nr. 70, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës së S. K. nga Fieri", me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1945–1952. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

11. Dosja nr. 87, "Fashikull i kërkimit për bandën diversante të S. S. nga rrethi i Shkodrës", me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952–1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 195.

12. Dosja nr. 86, "Fashikull i materialeve për kërkimin e bandës diversante të Q. Xh. nga rrethi i Tropojës", me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1949–1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

13. Dosja nr. 85, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të A. N. nga rrethi i Kukësit", me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1950–1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

14. Dosja nr. 69, "Fashikull i përgjithshëm i banditit L. P. nga rrethi Shkodër", me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1955–1955. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

15. Dosja nr. 67, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të M. K. nga rrethi i Shkodrës", me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

16. Dosja nr. 65, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të M. Z. nga rrethi i Fierit", me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952–1954. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

17. Dosja nr. 60, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të K. Gj. nga rrethi i Kukësit", me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952–1957. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

18. Dosja nr. 57, "Procesverbale hetimore mbi deponimet e të arratisurve V. V. dhe N. B., diversantë të kapur nga organet tona", me 49 (dyzetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

19. Dosja nr. 56, "Fashikull i përgjithshëm informatash i bandës së diversantit M. M. nga rrethi i Shkodrës", me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1952–1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

20. Dosja nr. 52, "Fashikull me dokumentet operative për diversantin Th. A. nga Tragjasi i Vlorës", me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1951–1953. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

21. Dosja nr. 44, "Fashikull i dosjes të arratisurit Ll. K. nga Rrësheni", me 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.

22. Dosja nr. 45, "Fashikull i përgjithshëm i bandës K. Z. nga rrethi i Korçës", me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1951–1952. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.

23. Dosja nr. 43, "Fashikull i përgjithësimit të grupit antikomunist L. P., në Kukës", me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1951–1957. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.

24. Dosja nr. 41, "Fashikull informatash i bandës P. Q. nga Puka", me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1951–1955. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.

25. Dosja nr. 95, "Fashikull i bandës së diversantit R. B. nga Pogradeci", me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1951–1954. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.

26. Dosja nr. 92, "Raporti vjetor, si dhe raportet 3-mujore mbi veprimtarinë e bandave të armatosura, pasqyra statistikore mbi hyrjet e bandave dhe përpunimeve të agjenturës", me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1954. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.

27. Dosja nr. 91, "Fashikull i përgjithshëm i informatave të bandës Xh. T. e shokë nga rrethi i Korçë", me 31 (tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1953–1959. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.

28. Dosja nr. 96, "Relacion mbi punën që ka zhvilluar UDB Jugosllave kundra punëtorëve operativë të Sigurimit të Shtetit", me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1954. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.

29. Dosja nr. 97, "Relacion i bandës së diversantit C. D. nga Dukati Vlorë", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1954. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.

30. Dosja nr. 98, "Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të A. T. nga rrethi i Skraparit", me 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.

31. Dosja nr. 99, "Raporti vjetor dhe tremujor, si dhe statistikat përkatëse mbi gjendjen e bandave dhe diversantëve e rezultatet e luftës kundër tyre gjatë vitit 1955", me 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1950–1963. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1955.

32. Dosja nr. 88, "Fashikull i kërkimit për bandën e rrëzuar nga diversanti D. N. nga rrethi i Kukësit dhe e përbërë nga H. Xh., E. Ç., S. D., L. Ç., G. S. e R. H.", me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1950–1957. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

33. Dosja nr. 105, "Relacion mbi arratisjet janari deri në shtator dhe pasqyrat statistikore", me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1950–1957. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

34. Dosja nr. 106, "Fashikull i diversantit R. B. nga rrethi i Tropojës", me 23 (njëzetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1956–1961. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1956.

35. Dosja nr. 107, "Fashikull të dhënash dhe plane e relacione për të arratisurin F. B., Vllah", me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1956–1957. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1956.

36. Dosja nr. 108 "Raporti vjetor dhe statistikat përkatëse mbi punën e kryer nga dega IX në drejtim të bandave dhe diversantëve", me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret". Dokumentet datojnë në vitet 1957. Dosja i përket fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1957.

**II. Deklasifikoi pjesërisht informacionin e mëposhtëm:**

1. Fondi ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, regjistër i agjenturës nr. 1, fleta me rreshtin ku gjendet numri rendor 8937, në ngarkim të V. P. me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret". Dokumenti daton në vitin 1961.

KRYETAR I KOMISIONIT TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
**Gentiana Sula**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 27
Datë: 2021/02/19 14:50:52
c98f3905-ad69-424a-b002-bf13085c05e6

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 496 lekë